



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 680 Akti

Nr. 728 Vendimi  
Tiranë, më 28.12.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

**Genta Tafa (Bungo)** Kryesuese  
**Roland Ilia** Relator  
**Suela Zhegu** Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në datën 27.12.2023, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Dorjan Tafilaj**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

**OBJEKTI:** Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, komisionerin Roland Ilia, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Dorjan Tafilaj, i cili në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë,

## V Ë R E N:

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Dorjan Tafilaj, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).

2. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK); Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni ka hedhur shortin në muajin dhjetor të vitit 2020, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Dorjan Tafilaj do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues, i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Roland Ilia dhe Suela Zhegu. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioner Roland Ilia, ndërsa kryesuese e trupit gjykues u caktua me mirëkuptim komisionere Genta Tafa (Bungo). Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit. Më pas u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Dorjan Tafilaj, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve e rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit.

4. Subjektit të rivlerësimit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti i rivlerësimit, sipas kërkesës së Komisionit, ka deklaruar mungesën e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

5. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm për të tria kriteret e vlerësimit: të pasurisë, të kontrollit të figurës, si dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.

6. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pas përfundimit të hetimit të thelluar administrativ për të tria kriteret e vlerësimit – vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale, në datën 4.12.2023, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit Dorjan Tafilaj; (ii) njoftimin e subjektit për t’u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

7. Subjekti i rivlerësimit, pas njoftimit mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni, ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja, të cilat i paraqiti në rrugë zyrtare pranë Komisionit në datën 18.12.2023.

8. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim dhe i analizoi shpjegimet e paraqitura dhe provat mbështetëse mbi rezultatet e hetimit, vendosi të ftojë z. Dorjan Tafilaj në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

### II. SEANCA DËGJIMORE

9. Subjekti i rivlerësimit Dorjan Tafilaj u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht me *email*, në datën 19.12.2023. Në datën 20.12.2023, subjekti u njoftua se

seanca publike dëgjimore e përcaktuar për t'u mbajtur në datën 27.12.2023, ora 10:00, për arsye objektive do të zhvillohet në po të njëjtën datë, ora 13:00, në të njëjtën adresë.

**10.** Seanca dëgjimore me subjektin u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", në datën 27.12.2023, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar.

**11.** Subjekti i rivlerësimit mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe për të parashtruar shpjegimet dhe opinionet e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit Dorjan Tafilaj kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

### **III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

**12.** Z. Dorjan Tafilaj ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur i janë kërkuar. Subjekti ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

### **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI**

**13.** Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

**14.** Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

**14.1** Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

**14.2** Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

**14.3** Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohet objekti i rivlerësimit të aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

**15.** Referuar vendimit nr. 2/2017<sup>1</sup> të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të

---

<sup>1</sup>"41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: "Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit". Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: "Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë". Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në

mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

**16.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike vjetore të dorëzuara ndër vite, nga subjekti në ILDKPKI;
- ç) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- d) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga AKSIK-ja;
- dh) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja;
- e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

## **A. VLERËSIMI I PASURISË**

### **A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

**17.** Bazuar në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja përfundoi kontrollin e plotë të deklaratës së pasurisë dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, konstatohet se për subjektin Dorjan Tafilaj:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

**18.** Z. Dorjan Tafilaj është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar dhe të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ka dorëzuar, ndër vite, deklaratat e interesave privatë: para fillimit të detyrës 2003; periodike/vjetore 2003 – 2017 dhe deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*.

### **A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

**19.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; deklaratimet e subjektit me anë të komunikimit elektronik dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit.

---

*kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.*

**20.** Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni nisi shqyrtimin e deklaratimeve të interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë te ky institucion, duke i krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit Dorjan Tafilaj, pas:

- a) shqyrtimit të të dhënave të deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, me nr. indeksi \*\*\*, datë 26.1.2017, për subjektin e rivlerësimit;
- b) krahasimit të deklaratave të pasurive të dorëzuara në ILDKPKI për periudhën 2004 – 2017, në raport me të dhënat në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*;
- c) shqyrtimit të të dhënave nga të gjitha bankat e nivelit të dytë, institucionet financiare dhe jofinanciare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditetet – gjendje *cash*;
- ç) hetimit të kryer lidhur me të dhënat e vetëdeklaruara nga subjekti gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni.

**21.** Në deklaratën e pasurisë *Vetting*, të dorëzuar në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit Dorjan Tafilaj ka deklaruar pasuritë si vijojnë:

### **1. Apartament banimi me sip. 86 m<sup>2</sup> në Vlorë**

**1.1** Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar apartament me sip. 86 m<sup>2</sup>, me adresë: lagjja “\*\*\*\*”, pallati “\*\*\*\*”, Vlorë, blerë në datën 19.11.2007, në vlerën 4,000,000 lekë. Pjesa takuese: 50%.

**1.2** Burimi i krijimit të pasurisë apartament: (i) paga e subjektit si oficer i policisë gjyqësore dhe prokuror; (ii) paga e bashkëshortes si punonjëse e Bashkisë Vlorë; (iii) shuma 9,000 USD e dhuruar<sup>2</sup> nga vëllai E. T.

**1.3** ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga ZVRPP-ja Vlorë.

### **Hetimi i Komisionit**

**1.4** Nga hetimi administrativ rezultoi se subjekti i rivlerësimit në DPV-në e vitit 2007 ka deklaruar: “*Blerje apartamenti datë 19.11.2007, sip. 86 m<sup>2</sup>, në lagjen “\*\*\*\*”, Vlorë, në vlerën 4,000,000 lekë. Burimi: pakësuar gjendja cash në shumën 2.8 milionë lekë + 9,000 USD huamarrje nga vëllai me banim në SHBA + kursimet vjetore*”.

**1.5** Në deklaratën *Vetting* si burim të blerjes së apartamentit subjekti ka deklaruar *pagat e tij e të bashkëshortes së tij, si dhe një shumë prej 9,000 USD, dhuruar nga vëllai i tij.*

**1.6** Rezultoi se me anë të kontratës së shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 19.11.2007, Dorian e K.T kanë blerë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. pasurinë apartament me sip. 86 m<sup>2</sup>, në Vlorë, në vlerën 4,000,000 lekë. Kjo vlerë sipas kontratës është likuiduar tërësisht jashtë zyrës noteriale.

**1.7** Për këtë pasuri apartament me sip. 86 m<sup>2</sup>, ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, Vlorë, është lëshuar certifikata e pronësisë nr. \*\*\*, datë 10.12.2007, dhe kartelë pasurie në emër të bashkëpronarëve Dorian e K.T.

**1.8** ZVRPP-ja Vlorë ka konfirmuar pasurinë e llojit “apartament”, me sip. 86 m<sup>2</sup>, ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, Vlorë.

**1.9** Si burime të blerjes së apartamentit subjekti ka deklaruar: kursimet nga gjendja *cash* (me burim pagat e tij e të bashkëshortes së tij) në vlerën 2,800,000 lekë, të krijuara që nga fillimi i

<sup>2</sup> Shihni deklaratë dhuratë (jonoteriale) datë 29.12.2016, nënshkruar nga shtetasi E.T, i cili deklaroi se në vitin 2007 i ka dërguar vëllait të tij Dorian Tafilaj shumën 9,000 USD, në formë dhurate, për t'i përdorur për pagesë blerjeje të banesës që banon edhe sot; fondet janë dërguar nëpërmjet babait të tyre.

marrëdhëniet të punës si oficer i policisë gjyqësore dhe deri në vitin 2007; huamarrje/dhurim nga vëllai i tij emigrant në vlerën 9,000 USD, sipas deklaratës<sup>3</sup> nga vëllai i tij.

### **Analiza e mundësisë së blerjes së apartamentit në vlerën 4,000,000 lekë**

**1.10** Në lidhje me burimet e blerjes së apartamentit, Komisioni analizoi mundësinë e blerjes së apartamentit duke filluar me burimin e deklaruar prej 2,8 milionë lekësh në DPV-në e vitit 2007. Për këtë, Komisioni analizoi mundësinë e krijimit të vlerës *cash* 2,8 milionë lekë deri në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes me datë 19.11.2007, nga ku rezultoi se:

- Në DPV-në e vitit 2004, subjekti deklaroi për herë të parë: “*Gjendje cash (kursime familjare) -1,000,000 lekë -100%. Data e krijimit 1 Janar - 31 Dhjetor 2004*”.
- Në DPV-në e vitit 2005, subjekti deklaroi: “*Dorian dhe K.T, kursime familjare – 1,000,000 lekë*”.
- Në DPV-në e vitit 2006, subjekti deklaroi: “*Kursime familjare – 800,000 lekë*”.
- Gjendja progresive e kursimeve *cash* sipas deklaramentit të subjektit në fund të vitit 2006 është 2,800,000 lekë.
- Në DPV-në e vitit 2007, subjekti deklaroi: “*Pakësimin e gjendjes cash për blerjen e apartamentit të lartpërmendur – 2,800,000 lekë. Gjendja deri më 31.12.2007 është 0 (zero)*”.

**1.11** Sipas *statement-it* bankar (ISP Bank, Raiffeisen Bank dhe ProCredit Bank), në vitin 2003, subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë gjendje likuiditetesh bankare (depozita) në vlerat 2,145,844 lekë dhe 4,200 USD (afërsisht 456,498 lekë), që në total arrijnë vlerën 2,602,342 lekë.

**1.12** Subjekti është pyetur lidhur me burimin e krijimit të depozitave në vitin 2003, si dhe për përdorimin e likuiditeteve pas mbylljes së depozitave që dispononte bashkë me bashkëshorten e tij dhe, në përgjigje, ka deklaruar<sup>4</sup>: “*...ju sqaroj se burimi i krijimit të llogarive depozitë pranë Intesa Sanpaolo Bank kanë qenë kursimet familjare ndër vite, deri në vitin 2003 dhe 2004 të siguruara nga të ardhurat e ligjshme dhe të deklaruara rregullisht nga ana ime në deklaratat periodike vjetore.*

*Ju sqaroj se burimi i krijimit të llogarisë depozitë pranë ProCredit Bank kanë qenë kursimet familjare ndër vite deri në vitin 2003, të siguruara nga të ardhurat e ligjshme dhe të deklaruara rregullisht nga ana ime në deklaratat periodike vjetore.*

*Lidhur me burimin e krijimit të llogarisë së kursimit të deklaruar në vitin 2003, ju sqaroj se kanë shërbyer si burim kursimet familjare me të ardhurat e mia nga paga si oficer i policisë gjyqësore Vlorë prej vitit 1998 deri në vitin 2000, si dhe të ardhurat nga paga si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë prej datës 1.2.2000 dhe në vazhdim”.*

**1.13** Komisioni ka analizuar nga mundësinë e krijimit të kursimeve *cash* në shumën 1,000,000 lekë në vitin 2004, sipas deklaramentit të subjektit në DPV.

**1.14** Sipas analizës financiare të periudhës 1998 – 2003<sup>5</sup>, rezultoi një pamundësi financiare prej 1,470,318 lekësh e subjektit dhe bashkëshortes për të krijuar këto pasuri likuiditete në bankë dhe për të mbuluar shpenzimet e periudhës.

**1.15** Vlera e tërhequr nga depozitat në vitin 2004 është konsideruar si shpenzim për këtë vit, meqë subjekti nuk e deklaroi si burim për shtim pasurie (likuiditet tjetër apo pasuri të

<sup>3</sup> Shihni kontratë blerjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 19.11.2007, para noteres S. H., Dhoma e Noterisë, Vlorë.

<sup>4</sup> Shihni përgjigjen e pyetësorit nr. \*\*\*.

<sup>5</sup> Shihni analizën financiare në pikën 9 të këtij vendimi.

luajtshme/paluajtshme). Si rrjedhim, këto tërheqje nuk konsiderohen si burim për krijimin e kursimeve *cash* në vitin 2004 në vlerën 1,000,000 lekë.

**1.16** Është analizuar mundësia e kursimit të shumës 1,000,000 lekë në vitin 2004 me të ardhurat e subjektit dhe familjarëve të tij si më poshtë:

**Analiza e mundësisë së krijimit të kursimeve *cash* për vitin 2004**

Përshkrimi	Vlera
Të ardhura totale 2004	1,199,735
Shpenzime jetese, qira, arsimi 2004	371,892
Shtim <i>cash</i> 2004	1,000,000
<b>Mundësia e kursimit <i>cash</i> - 1,000,000 lekë</b>	<b>-172,157</b>
Deklaruar kursime <i>cash</i> në DPV-në e vitit 2004	1,000,000
<b>Mundësia reale për kursime <i>cash</i></b>	<b>827,843</b>

**1.17** Nga analiza financiare rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kishin mundësi reale financiare për krijimin e kursimeve *cash* në vlerën 827,843 lekë nga 1,000,000 lekë të deklaruara në DPV-në e vitit 2004.

**1.18** Sa më sipër, vërtetohet burimi i ligjshëm i shtimit të kursimeve *cash* në vitin 2004 në vlerën 827,843 lekë, të cilat do të shërbejnë më vonë për blerjen e apartamentit në vitin 2007.

**1.19** Komisioni ka analizuar nga mundësinë e krijimit të kursimeve *cash* në shumën 1,000,000 lekë në vitin 2005, sipas deklaramit të subjektit në DPV.

**1.20** Sipas përgjigjes së subjektit<sup>6</sup>, burimi i gjendjes prej 2,000,000 lekësh *cash* në vitin 2005 është mbyllja e depozitës në Intesa Sanpaolo Bank në vlerën 1,000,000 lekë dhe kursimet familjare për këtë vit kalendarik. Nga informacioni bankar rezulton se subjekti e mbyll depozitën në vlerën 1,148,849 lekë në gusht të vitit 2005. Nga analiza financiare e periudhës 1998 – 2003 duket se subjekti dhe bashkëshortja e tij rezultuan me një pamundësi financiare prej 1,470,318 lekësh për krijimin e likuiditeteve bankare në vlerën totale 2,602,342 lekë, ndërsa subjekti kishte burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e pjesës tjetër të këtyre depozitave në vlerën 1,132,024 lekë (2,602,342 – 1,470,318 = 1,132,024). Si rrjedhim, mbyllja e depozitës në Intesa Sanpaolo Bank në vitin 2005 mund të konsiderohet si burim i ligjshëm për shtimin e kursimeve *cash* në shumën 1,000,000 lekë të dekluar nga subjekti.

**1.21** Është analizuar edhe mundësia e kursimit të shumës 1,000,000 lekë në vitin 2005 me të ardhurat e subjektit dhe familjarëve të tij si më poshtë:

**Analiza e mundësisë së krijimit të kursimeve *cash* për vitin 2005**

Përshkrimi	Vlera
Të ardhura totale 2005	1,330,443
Shpenzime totale 2005	500,814
Ndryshim likuiditeti 2004 – 2005	-137,728
<b>Mundësia e kursimit <i>cash</i> - 1,000,000 lekë</b>	<b>967,357</b>

**1.22** Nga analiza financiare rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kishin mundësi financiare për krijimin e kursimeve *cash* dhe mbulimin e shpenzimeve të vitit 2005 me të ardhura të ligjshme.

<sup>6</sup> Shihni përgjigjen e pyetësorit nr. \*\*\*.

**1.23** Sa më sipër, vërtetohet burimi i ligjshëm i shtimit të deklaruar të kursimeve *cash* në vitin 2005, të cilat do të shërbejnë më vonë për blerjen e apartamentit në vitin 2007.

**1.24** Është analizuar nga Komisioni edhe mundësia e krijimit të kursimeve *cash* në shumën 800,000 lekë në vitin 2006, sipas deklarimit të subjektit në DPV si më poshtë:

**Analiza e mundësisë së krijimit të kursimeve *cash* për vitin 2006**

Përshkrimi	Vlera
Të ardhura totale viti 2006	1,302,346
Shpenzime totale viti 2006	561,413
Ndryshim likuiditeti 2005 – 2006	832,139
<b>Mundësia e kursimit <i>cash</i> – 800,000 lekë</b>	<b>-91,206</b>
Deklaruar kursime <i>cash</i> në DPV-në e vitit 2006	800,000
<b>Mundësia reale për kursime <i>cash</i></b>	<b>708,794</b>

**1.25** Nga analiza financiare rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kishin mundësi reale financiare për krijimin e kursimeve *cash* në vlerën 708,794 lekë nga 800,000 lekë të deklaruara në DPV-në e vitit 2006.

**1.26** Sa më sipër, vërtetohet burimi i ligjshëm i shtimit të kursimeve *cash* në vitin 2006 në vlerën 708,794 lekë, të cilat do të shërbejnë më vonë për blerjen e apartamentit në vitin 2007.

**1.27** Nga analizimi i mundësisë së shtimit të kursimeve *cash* në vitet 2004 – 2006 si më poshtë, duket se subjekti dhe bashkëshortja e tij kishin të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e gjendjes *cash* në vlerën 2,536,637 lekë deri në fund të vitit 2006. Këto kursime konsiderohen si burim i ligjshëm për blerjen e apartamentit në vitin 2007.

**Analiza e mundësisë së krijimit të kursimeve *cash* për vitet 2004 – 2006**

Përshkrimi	Vlera
Kursime <i>cash</i> 2004	827,843
Kursime <i>cash</i> 2005	1,000,000
Kursime <i>cash</i> 2006	708,794
<b>Mundësi kursimi <i>cash</i> 2004 – 2006</b>	<b>2,536,637</b>

**1.28** Ndërsa për burimin 9,000 USD të blerjes së apartamentit, në DPV-në e vitit 2007 subjekti ka deklaruar huamarrje nga vëllai i tij E.T, kurse në deklaratën *Vetting* dhe në përgjigje të pyetësorit standard subjekti ka deklaruar se kjo shumë është dhuruar nga vëllai i tij. Bashkëlidhur kontratës së shitblerjes së apartamentit, ai ka sjellë një dokument “Deklaratë dhurate” (jonoteriale), të datës 29.12.2016, ku thuhet se vëllai E. T në vitin 2007 i ka dërguar vëllait të tij (subjektit) shumën 9,000 USD, të cilën e ka përdorur për të paguar një kësht të banesës së tij “*Këto para janë dhuratë dhe nuk pres parapagim*”, ndërsa e mbyll deklaratën e tij duke thënë se “*Këto para janë dërguar nëpërmjet babait tonë në një prej udhëtimeve të tij nga SHBA-ja në Shqipëri*”.

**1.29** Për të provuar mundësinë e vëllait për dërgimin e këtyre parave (9,000 USD), subjekti ka vënë në dispozicion një letër referencë<sup>7</sup>, lëshuar nga B.A.P.S.C në shkurt të vitit 2011, ku theksohet se *E.T është punonjës i B.A, në pozicionin e menaxherit të Qendrës Bankare III, duke filluar nga data 10.10.2006 me vendndodhje në A, Virginia, me një pagë bazë vjetore në vlerën 68,355 USD.*

<sup>7</sup> Shihni letër referencë të datës 24.2.2011, të cilën subjekti e ka sjellë bashkëlidhur përgjigjes së pyetësorit standard.



**1.30** Subjektit iu kërkua të provojë me dokumentacion ligjor mundësitë e huadhënësit/dhuruesit E.T, vëllait të tij, për dhënien e shumës 9,000 USD në vitin 2007.

**1.31** Në përgjigje të pyetësorit nr. \*\*\*, subjekti ka deklaruar se: *“Vëllai im E.T ka qenë në marrëdhënie pune me kohë të plotë pranë B.A, me vendndodhje në A, Virxhinia, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, prej datës 10.10.2006. Paga vjetore bazë në pozicionin e punës menaxher i Qendrës Bankare ka qenë 68,355 USD për vit. Të dhënat e mësipërme për punësimin dhe të ardhurat e vëllait tim E.T provohen nëpërmjet shkresës së datës 11.2.2011, lëshuar nga B.A, Qendra për Shërbimin e Personelit. Në vlerësim të të dhënave financiare lidhur me datën e fillimit të marrëdhënieve të punës dhe pagën vjetore bazë të vëllait tim E.T është ligjërisht e vërtetueshme se ai ka qenë në mundësi të mjaftueshme financiare për të më dhënë shumën 9,000 USD, në vitin 2007.*

*Në fillim kjo shumë më është dhënë nga vëllai im E.T në formën e ndihmës financiare për blerjen e pasurisë së paluajtshme apartament në qytetin e Vlorës, pasqyruar në deklarinin periodik vjetor të vitit 2007. Në vijim, kjo shumë më është bërë dhuratë dhe nuk më është kërkuar kthimi i saj si detyrim financiar. Për këtë fakt është depozituar pranë ILDKPKI-së në vitin 2010 deklarata e dhurimit, e dërguar nga vëllai im E.T”.*

**1.32** Në përgjigje të pyetësorit nr. \*\*\*, subjekti deklaron: *“Deklaroj se vëllai im E.T prej vitit 2011 është larguar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe është kthyer në Shqipëri për t’u kujdesur për nënën tonë, e cila gjatë kohës vuante nga një sëmundje autoimune dhe që më pas ndërroi jetë. E.T jeton prej vitit 2011 pa ndërprerje në Shqipëri, ai nuk është shtetas amerikan dhe nuk zotëron leje qëndrimi për në SHBA prej vitit 2011.*

*Nga komunikimi me vëllain tim E.T rezulton se ai nuk disponon dokumentacion tjetër vërtetues mbi të ardhurat e tij apo për pagesën e detyrimeve tatimore gjatë periudhës së punësimit në B.A. Si punëmarrës në një institucion financiar me reputacion ndërkombëtar, siç është B.A, të gjitha detyrimet tatimore që kanë rrjedhur nga marrëdhënia e punës e vëllait tim E.T janë paguar rregullisht nga vetë punëdhënësi sipas parashikimeve të legjislacionit amerikan. Pagesa e këtyre detyrimeve tatimore ka qenë detyrim ligjor për punëdhënësin dhe është ndjekur si procedurë e standardizuar nga vetë B.A. Në kushtet kur vëllai im E.T nuk jeton në SHBA dhe nuk zotëron leje qëndrimi për këtë vend prej më tepër se 10 vitesh, ai më ka komunikuar se nuk e ka të mundur të sigurojë dokumentacion shtesë për pagesën e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat e tij në periudhën e kërkuar...”.*

**1.33** Komisioni vlerësoi se dokumenti i paraqitur nga subjekti lidhur me punësimin e vëllait të tij E.T është i mjaftueshëm për të vërtetuar marrëdhënien e tij të punës dhe të ardhurat e tij nga punësimi në një institucion të rëndësishëm financiar siç është B.A.

**1.34** Gjithashtu, duke mos vënë në dyshim vlefshmërinë ligjore të këtij dokumenti, vërtetim i lëshuar nga B.A, Komisioni analizoi mundësitë financiare të vëllait të subjektit të rivlerësimit për huadhënien/dhurimin e vlerës 9,000 USD në vitin 2007.

**1.35** Bazuar në vërtetimin e lëshuar nga B.A për vëllain e subjektit E.T, paga bazë e tij pranë kësaj banke ka qenë 68,355 USD/vit dhe ai ka filluar punën atje që në datën 10.10.2006.

**1.36** Komisionit, referuar verifikimit të sistemit TIMS, si dhe pas përgjigjes<sup>8</sup> së pyetësorit nr. \*\*\*, i rezultoi se babai i subjektit ka udhëtuar në vitin 2007 nga SHBA-ja në Shqipëri, kur është dërguar edhe shuma e parave prej 9,000 USD nga vëllai i subjektit E. T.<sup>9</sup>

**1.37** Është analizuar mundësia financiare e vëllait të subjektit, që me të ardhurat nga paga e tij të përballojë shpenzimet e tij të jetesës<sup>10</sup> dhe t'i japë subjektit shumën 9,000 USD përmes babait në vitin 2007 (kur është blerë apartamenti nga subjekti). Periudha e llogaritur në analizën financiare fillon nga data 10.10.2006 (fillimi i punës së E.T pranë B.A) dhe përfundon në datën 21.1.2007 (data e kthimit në Shqipëri të babait). Pagës bazë të vëllait të subjektit tek B.A i është zbritur taksa mbi të ardhurat<sup>11</sup> në mungesë të një informacioni më të detajuar mbi shtesat e tjera mbi pagën bazë dhe pagën neto të vëllait të subjektit.

**Analiza e mundësisë së dhurimit 9,000 USD nga vëllai E.T**

Përshkrimi	Vlera në USD
Të ardhura nga paga tek B.A 10.10.2006 – dhjetor 2006	14,241
Shpenzime jetese 10.10.2006 – 20.1.2007	2,697
Taksa mbi të ardhurat - 5.75%	819
Dhënë subjektit 9,000 USD	9,000
<b>Mundësia financiare</b>	<b>1,725</b>

**1.38** Nga analiza financiare rezultoi se vëllai i subjektit kishte të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për dhënien e shumës 9,000 USD subjektit dhe përbalimin e shpenzimeve të jetesës.

**1.39** Ngaqë burimi i deklaruar për blerjen e pasurisë apartament ishin kursimet *cash* 2,800,000 lekë, huaja/dhurimi i vëllait 9,000 USD, si dhe kursimet vjetore, këto të fundit llogariten të jenë në vlerën 452,730 lekë (4,000,000 - 2,800,000 - 747,270<sup>12</sup> = 452,730). Komisioni analizoi mundësinë që subjekti dhe bashkëshortja kishin për të kursyer shumën e mësipërme me të ardhurat e tyre nga puna si më poshtë:

**Analiza e mundësisë së krijimit të kursimeve për blerje apartamenti në vitin 2007**

Përshkrimi	Vlera
Të ardhura subjekti 1.1.2007 – 19.11.2007	851,108
Të ardhura bashkëshortja e subjektit 1.1.2007 – 19.11.2007	251,233
Të ardhurat e djalit nga KEMP 1.1.2007 – 19.11.2007	95,700
<b>Të ardhurat totale 1.1.2007 – 19.11.2007</b>	<b>1,198,041</b>
Shpenzime jetese 1.1.2007 – 19.11.2007	478,170
Shpenzime qiraje 1.1.2007 – 19.11.2007	66,000
Shpenzime arsimimi fëmijët 1.1.2007 – 19.11.2007	40,500
<b>Shpenzime totale 1.1.2007 – 19.11.2007</b>	<b>584,670</b>
Kursime për blerjen e apartamentit	452,730
Ndryshim likuiditeti 31.12.2006 – 19.11.2007	8,765
<b>Mundësia financiare</b>	<b>151,876</b>

<sup>8</sup> Shihni përgjigjen e pyetësorit nr. \*\*\*, ku subjekti ka deklaruar se sipas raportit të lëshuar nga sistemi TIMS verifikohet ligjërisht se babai im D.T ka hyrë në pikën kufitare Rinas, Shqipëri në datën 21.1.2007.

<sup>9</sup> Bashkëlidhur subjekti ka sjellë raportin e lëshuar nga sistemi TIMS për babain D.T, si dhe fotokopje të dokumentit Leje Qëndrimi e Përhershme për babain D.T dhe për nënën D.T.

<sup>10</sup> [Historical Poverty Tables: People and Families - 1959 to 2021 \(census.gov\)](https://www.census.gov/historical-data/tables/people-and-families/)

<sup>11</sup> <https://www.tax.virginia.gov/sites/default/files/inline-files/ANNUALREPORTFY2006.pdf>

<sup>12</sup> 9,000 USD x 83.03 lekë/USD = 747,270 lekë.

**1.40** Nga analiza financiare rezultoi se subjekti dhe bashkëshortja e tij kishin të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve të periudhës dhe krijimin e kursimeve në shumën 452,730 lekë për pagesën e një pjese të vlerës së apartamentit.

**1.41** Pas analizimit të të gjitha burimeve të deklaruara nga subjekti për blerjen e pasurisë apartament, Komisioni hartoi analizën përfundimtare të mundësisë së blerjes së pasurisë si më poshtë:

**Analiza e mundësisë së blerjes së apartamentit me vlerë 4,000,000 lekë**

Përshkrimi	Vlera
Mundësi e krijimit të kursimeve <i>cash</i> 2004 – 2008	2,536,637
Të ardhura nga dhurimi i vëllait - 9,000 USD	747,270
Kursime vjetore 2007	452,730
<b>Të ardhura totale</b>	<b>3,736,637</b>
Blerje apartamenti datë 19.11.2007	4,000,000
<b>Pamundësia financiare</b>	<b>-263,363</b>

**1.42** Nga analiza financiare dukej se subjekti dhe bashkëshortja kishin pamjaftueshmëri financiare totale në vlerën -263,363 lekë për blerjen e pasurisë apartament me sip. 86 m<sup>2</sup>, në Vlorë, me datë 19.11.2007.

**1.43** Komisioni hetoi edhe lidhur me çmimin e blerjes së kësaj pasurie në raport me çmimet e përcaktuara për ndërtimet në qytetin e Vlorës, duke u bazuar në Udhëzimin nr. 2, datë 4.4.2007, të Këshillit të Ministrave, nga ku rezultoi se vlera e tregut të lirë të apartamenteve në qytetin e Vlorës është në vlerën 49,335 lekë/m<sup>2</sup>. Sipërfaqja e ndërtimit të blerë nga subjekti i rivlerësimit është 86 m<sup>2</sup> dhe kostoja llogaritet në vlerën (86 x 49,335lekë/m<sup>2</sup>) 4,242,810 lekë. Subjekti e ka blerë këtë pasuri në vlerën 4,000,000 lekë (afërsisht 4,242,810 lekë), pra me një çmim të përafërt me mesataren e çmimeve të tregut për periudhën.

**1.44** Komisioni i kërkoi subjektit të provojë me dokumentacion provues (vërtetim nga Prokuroria) mospasjen e konfliktit të interesit duke vërtetuar se nuk ka pasur në ndjekje dhe shqyrtim ndonjë çështje me palë shoqërinë ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k., përfaqësuar nga administrator Th. D., tek i cili subjekti ka blerë apartamentin e banimit në Vlorë, në vitin 2007. Në përgjigje të pyetësorit nr. \*\*\*, subjekti ka deklaruar<sup>13</sup> me përgjegjësi të plotë se gjatë ushtrimit të detyrës si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë nuk ka pasur asnjë çështje në hetim me palë shoqërinë ndërtuese “D...” sh.p.k., përfaqësuar nga administrator Th. D.

**1.45** Në përfundim të hetimit, Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti dhe bashkëshortja kishin pamjaftueshmëri totale burimesh të ligjshme për blerjen e pasurisë apartament në vitin 2007 dhe mbulimin e shpenzimeve të periudhës në vlerën -263,363 lekë.

**1.46** Sa më sipër, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat e tij për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

**1.47** Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti ka paraqitur një analizë financiare për periudhën 1998 – 2003, ku ka marrë në analizë, sipas dokumentacionit bankar, krijimin e katër llogarive në emër të tij dhe bashkëshortes së tij, duke shpjeguar ndër të tjera edhe depozitimin

<sup>13</sup> Shihni përgjigjen e pyetësorit nr. \*\*\* dhe shkresën bashkëlidhur me lëndë “Kthim përgjigje”, nr. \*\*\* prot., datë 7.6.2023, dërguar nga Prokuroria e Juridiksionit të Përgjithshëm pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në vijim të kërkesës për verifikim, drejtuar kësaj Prokurorie.

e të ardhurave të prindërve të tij në vlerën 1,500,000 lekë, në emrin e tij, para të cilat ua ka kthyer atyre përsëri<sup>14</sup>.

**1.48** Ky qëndrim i subjektit u paraqit vetëm në përgjigje të rezultateve të hetimit pasi nuk ishte pretenduar asnjëherë tjetër gjatë hetimit administrativ. Marrëdhënia e vetme e interesit e deklaruar nga subjekti gjatë hetimit lidhur me prindërit e tij është se ata kanë jetuar së bashku për disa periudha dhe se subjekti me bashkëshorten kanë paguar një pjesë të qirasë së banesës ku jetonin.

**1.49** Gjithashtu, në përgjigje të pyetësorit lidhur me burimin e krijimit të depozitave subjekti është përgjigjur se *si burim kanë shërbyer kursimet familjare ndër vite deri në vitet 2003 – 2004, të siguruara nga të ardhurat e ligjshme dhe të deklaruara rregullisht nga ai në deklaratat periodike vjetore ose kursimet familjare me të ardhurat e tij nga paga si oficer i policisë gjyqësore Vlorë, prej vitit 1998 e deri në vitin 200,0 si dhe të ardhurat nga paga si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë prej datës 1.2.2000 dhe në vazhdim*. Pra, në asnjë rast nuk i është referuar të ardhurave të prindërve si burim për krijimin e këtyre depozitave, duke ndryshuar kështu qëndrimin e tij të mëparshëm.

**1.50** Gjithsesi, Komisioni analizoi mundësinë e prindërve të tij që me të ardhurat nga pagat dhe pensionet të kursejnë shumën 1,500,000 lekë deri në fund të vitit 2003 dhe nga analiza financiare rezultoi se ato kishin një pamjaftueshmëri financiare në vlerën 578,136 lekë.

**1.51** Sa më sipër, Komisioni vlerësoi se gjeti të pabazuar pretendimin e subjektit për përfshirjen si burim të krijimit të depozitave deri në vitin 2003 edhe të kursimeve të prindërve të tij.

**1.52** Komisioni hartoi edhe një herë analizën financiare pas rishikimit të të ardhurave totale të periudhës 1998 – 2003<sup>15</sup>. Sipas analizës financiare rezultoi një pamundësi totale në vlerën 1,547,118 lekë për këtë periudhë<sup>16</sup>.

**1.53** Rezultoi se subjekti ka ndryshuar qëndrimin e tij për gjendjen e kursimeve *cash* të vitit 2004 (nga përgjigjet e pyetësorit tek përgjigjet mbi rezultatet e hetimit). Ai ka sjellë në shpjegimet përfundimtare një analizë financiare për vitin 2004, duke argumentuar mundësinë e krijimit të kursimeve *cash* prej 1,000,000 lekësh në atë vit. Këtu, ai përfshin si burim edhe vlerën nga mbyllja e depozitës prej 660,000 lekësh në Raiffeisen Bank në këtë vit. Sipas subjektit, vetëm depozita e krijuar në Raiffeisen Bank në vlerën 660,000 lekë ka qenë e krijuar me të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes, ndaj edhe duhet marrë si burim për krijimin e gjendjes *cash* në vitin 2004. Gjithashtu, subjekti pretendoi se depozita e krijuar tek Intesa Sanpaolo Bank është mbyllur në gusht të vitit 2004 dhe jo në vitin 2005 duke rënë në kundërshtim me deklaratimet e tij në përgjigje të pyetësorit për faktin se ai e mohonte ekzistencën e kursimeve *cash* në vitin 2004.

**1.54** Sipas përgjigjes së tij në pyetësorit<sup>17</sup>, subjekti pretendonte se gjendja *cash* me datë 31.12.2004 ka qenë 0 (zero), pasi shuma 1,000,000 lekë, e deklaruar si kursime *cash* në vitin 2004 është depozituar tërësisht në llogarinë bankare – depozitë pranë Intesa Sanpaolo Bank dhe, sipas tij, kjo depozitë është tërhequr në vitin 2005 dhe ka shërbyer si burim për shtimin e kursimeve *cash* në vitin 2005. Edhe nëse do të merrej parasysh pretendimi i subjektit se mbyllja e depozitës tek Intesa Sanpaolo Bank është bërë në vitin 2004 dhe jo në vitin 2005, situata financiare do të përkeqësohej sepse nga kjo do të shkaktonte një rritje në likuiditet nga data 31.12.2004 deri më 31.12.2005, me rreth 1,000,000 lekë. Të ardhurat totale të vitit 2005 nuk do të ishin të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve të vitit dhe shtimin e kursimeve *cash*

<sup>14</sup> Shihni parashtrimet e subjektit në përgjigje të rezultateve të hetimit.

<sup>15</sup> Shihni trajtimin e çështjes së të ardhurave nga KEMP në pikën 9 të këtij vendimi.

<sup>16</sup> Shihni analizën financiare në pikën 9 të këtij vendimi.

<sup>17</sup> Shihni përgjigjen e subjektit në pyetësorin nr. \*\*\*.

në këtë vlerë. Nga ana tjetër, nëse depozita supozohet e mbyllur në vitin 2004, vlera e tërhequr e depozitës nuk do të shërbente si burim për shtimin e kursimeve *cash* në vitin 2005.

**1.55** Për më tepër, u konstatua se subjekti nuk ka pretenduar asnjëherë që kursimet *cash* të vitit 2004 të jenë krijuar nga mbyllja e depozitave të mëparshme, madje ai nuk kishte pranuar fare ekzistencën e këtyre kursimeve në këtë vit.

**1.56** Sa më sipër, Komisioni vlerësoi se e gjeti të pabazuar pretendimin e subjektit se depozita tek Intesa Sanpaolo Bank të jetë mbyllur tërësisht në vitin 2004 dhe, si e tillë, të ketë shërbyer si burim për shtimin e kursimeve *cash* në këtë vit.

**1.57** Subjekti, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ka pretenduar zbritje të shpenzimeve të jetesës për vitet 2005 – 2007 për zërin e *ushqimeve* dhe *pijeve* për shkak se gjatë bashkëjetesës me prindërit e tij këto shpenzime ia kanë mbuluar ata.

**1.58** Rezulton se gjatë gjithë hetimit subjekti nuk ka deklaruar kurrë që prindërit i kanë mbuluar ndonjë shpenzim atij dhe familjes së tij. Përkundrazi, ai ka deklaruar se gjatë periudhës së bashkëjetesës ka kontribuar me pagesën e qirasë në vlerën 6,000 lekë/muaj. Ky pretendim, në përgjigje të rezultateve të hetimit, u gjet i pabazuar nga Komisioni dhe, si rrjedhim, nuk u bë një ndryshim i shpenzimeve të jetesës në analizën financiare.

**1.59** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti pretendoi edhe uljen e shpenzimeve të udhëtimit në periudhën 2005 – 2009, të cilat, sipas tij, janë mbuluar nga organizatorët, por nuk solli dokumentacion vërtetues. Këto shpenzime në analizën financiare nuk janë zbritur për sa kohë nuk u vërtetua me dokumentacion mbulimi i shpenzimeve të udhëtimit/qëndrimit nga të tretë.

**1.60** Subjekti ka paraqitur në përgjigje të rezultateve një analizë financiare për vitet 2005 dhe 2006, sipas së cilës, nëse do të merreshin parasysh pretendimet e mësipërme të sjella në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti rezultonte në mundësi të plotë për kursimin e shumës 2,800,000 lekë *cash* deri në vitin 2006.

**1.61** Sipas subjektit, duke marrë për burim kursimet *cash* në vlerën 2,800,000 lekë, të ardhurat e vitit 2007 në vlerën 452,730 lekë dhe dhurimin e vëllait në vlerën 9,000 USD, rezulton se ai dhe bashkëshortja kishin mundësi financiare për blerjen e pasurisë apartament në vlerën 4,000,000 lekë, në vitin 2007.

**1.62** Komisioni hartoi edhe një herë analizën financiare pas rishikimit të të ardhurave totale të periudhës 2005 – 2006<sup>18</sup> për të parë mundësinë e subjektit për krijimin e kursimeve *cash* në këtë periudhë, si dhe analizën e mundësisë së blerjes së apartamentit në vitin 2007.

#### **Analiza e mundësisë së krijimit të kursimeve *cash* në vitet 2004 – 2006**

<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera</b>
Kursime <i>cash</i> 2004	746,243
Kursime <i>cash</i> 2005	1,000,000
Kursime <i>cash</i> 2006	612,794
<b>Mundësi kursimi <i>cash</i> 2004 – 2006</b>	<b>2,359,037</b>

**1.63** Nga analizimi i mundësisë së shtimit të kursimeve *cash* në vitet 2004 – 2006 si më poshtë, rezultoi se subjekti dhe bashkëshortja kishin të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e gjendjes *cash* në vlerën 2,359,037 lekë deri në fund të vitit 2006. Këto kursime konsiderohen për Komisionin si burim i ligjshëm për blerjen e apartamentit në vitin 2007.

<sup>18</sup> Shihni trajtimin e çështjes së të ardhurave nga KEMP në pikën 9 të këtij vendimi.

**Analiza e mundësisë së blerjes së apartamentit me vlerë 4,000,000 lekë**

<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera</b>
Mundësi e krijimit të kursimeve <i>cash</i> 2004 – 2006	2,359,037
Të ardhura nga dhurimi i vëllait - 9,000 USD	747,270
Kursime vjetore 2007	452,730
<b>Të ardhura totale</b>	<b>3,559,037</b>
Blerje apartamenti datë 19.11.2007	4,000,000
<b>Pamundësia financiare</b>	<b>-440,963</b>

**1.64** Nga analiza financiare përfundimtare rezultoi se subjekti dhe bashkëshortja kishin pamjaftueshmëri financiare totale në vlerën -440,963 lekë për blerjen e pasurisë apartament me sip. 86 m<sup>2</sup>, në Vlorë, me datë 19.11.2007.

**1.65** Në përfundim, Komisioni vlerësoi se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë, të pamjaftueshëm dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurisë apartament në vlerën 4,000,000 lekë, sipas përcaktimeve të shkronjave “a” dhe “b” të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

## **2. Automjet tip “\*\*\*\*”, blerë në vitin 2013**

**2.1** Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar automjetin tip “\*\*\*\*”, vit prodhimi 2000, me targë AA \*\*\*, ngjyrë gri, blerë më 17.11.2013, në vlerën 6,000 euro.

**2.2** Si burim të blerjes së këtij automjeti subjekti ka deklaruar kredi në shumën 840,000 lekë, në BKT, dega Vlorë.

**2.3** Në DPV-në e vitit 2013 subjekti ka deklaruar blerje automjeti në shumën 6,000 euro dhe në seksionin “Detyrime financiare” ka deklaruar: “*Kredi pranë bankës 840,000 lekë me këst 25,000 lekë/muaj, për një afat 3 vite e 6 muaj*”.

**2.4** Subjekti ka paraqitur kontratë shitblerjeje automjeti tip “\*\*\*\*”, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 17.11.2013, me targë AA \*\*\*, vit prodhimi 2000, nënshkruar ndërmjet palës shitëse D. S. dhe palës blerëse D. Tafilaj, kundrejt vlerës 6,000 euro, shumë e cila është shlyer tërësisht jashtë zyrës noteriale.

**2.5** Në lidhje me burimin e blerjes, BKT-ja vërtetoi<sup>19</sup> se znj. K.T ka kredi bankare konsumatore të siguruar me bllokim shume lekë përmes kontratës së kredisë datë 18.11.2013 në vlerën 840,000 lekë.

**2.6** DPSHTRR-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.2.2019, informon se automjeti me targë AA \*\*\* nuk është në pronësi të z. Dorjan Tafilaj.

**2.7** Subjekti në DPV-në e vitit 2015 ka deklaruar se automjeti tip “\*\*\*\*”, me targë AA \*\*\* është grabitur në datën 18.11.2014.

**2.8** Subjekti është pyetur në lidhje me mospërputhjen e evidentuar të datës (17.11.2013) së kontratës së shitblerjes së automjetit tip “\*\*\*\*” me datën e disbursimit të kredisë me qëllim pagesën e vlerës së automjetit në datën 18.11.2013, ku ka sqaruar<sup>20</sup> se: “*Kontrata e shitblerjes së automjetit tip “\*\*\*\*” nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., është lidhur rregullisht me znj. D. S., në cilësinë e palës shitëse, në datën 17.11.2013. Paraprakisht kemi dakordësuar me znj. D. S. shumën 6,000 euro për blerjen e automjetit në momentin e disbursimit të kredisë në shumën 840,000 lekë nga BKT-ja, dega Vlorë. Gjithashtu, ishim njoftuar paraprakisht nga BKT-ja se shuma objekt kredie do të disbursohet rregullisht në datën 17.11.2013. Mbështetur në njoftimin*

<sup>19</sup> Shihni dokumentacionin bashkëlidhur deklaratës *Vetting* dhe vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 24.1.2017, të BKT-së, dega Vlorë.

<sup>20</sup> Shihni përgjigjen e pyetësorit nr. \*\*\*.

*paraparak të BKT-së kemi hartuar edhe kontratën e shitblerjes së automjetit. Në datën 17.11.2013, BKT-ja na bëri me dije se për shkak të një vonese të paparashikuar në procedurat bankare, nuk do të ishte i mundur disbursimi i kredisë në këtë datë, duke e shtyrë këtë procedurë për ditën tjetër në vijim. Të gjendur në këto rrethana objektive kemi dakordësuar në marrëveshje të plotë me znj. D. S. realizimin e pagesës së shumës sipas kontratës përkatëse ditën tjetër në vijim. Në datën 18.11.2013 është disbursuar kredia nga BKT-ja, dega Vlorë, dhe pasi është konvertuar shuma në valutën euro sipas kursit të këmbimit të kohës, është kryer pagesa për blerjen e automjetit tip “\*\*\*\*” tek znj. D. S”.*

**2.9** Nga dokumentacioni i disponuar Komisioni konstatoi se burimi i blerjes së automjetit në shumën 6,000 euro (= 840,000 lekë) është përmes kredisë bankare në BKT të marrë në emër të bashkëshortes së subjektit.

**2.10** Komisioni i kërkoi subjektit të provojë me dokumentacion provues (vërtetim nga Prokuroria) mospasjen e konfliktit të interesit duke vërtetuar se nuk ka pasur në ndjekje dhe shqyrtim ndonjë çështje me palë shtetasen D.S, në cilësinë e shitëses së automjetit tip “\*\*\*\*”, blerë nga subjekti në vitin 2013. Në përgjigje të pyetësorit nr. \*\*\*, subjekti ka deklaruar<sup>21</sup> se gjatë ushtrimit të detyrës si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë nuk ka pasur asnjë çështje në hetim me këtë shtetase.

**2.11** Në përfundim të hetimit Komisionit nuk i rezultuan problematika në lidhje me këtë pasuri.

### **3. Automjet tip “\*\*\*\*”, blerë në vitin 2015**

**3.1** Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar automjet tip “\*\*\*\*”, me targë AA \*\*\*, blerë më 21.2.2015, në vlerën 5,000 euro. Si burim për blerjen e këtij automjeti kanë shërbyer kursimet nga paga e subjektit si prokuror dhe e bashkëshortes së tij si punonjëse e Bashkisë Vlorë.

**3.2** Subjekti ka paraqitur kontratë shitblerjeje automjeti nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 21.2.2015, nënshkruar ndërmjet palës shitëse K. Z. dhe palës blerëse D. Tafili, të një automjeti tip “\*\*\*\*”, vit prodhimi 2004, kundrejt vlerës 5,000 euro, shumë e cila është shlyer tërësisht jashtë zyrës noteriale.

**3.3** DPSHTRR-ja konfirmon<sup>22</sup> automjetin me targë AA \*\*\* në pronësi të subjektit. Edhe nga hetimi administrativ pranë Komisionit, DPSHTRR-ja<sup>23</sup> bën me dije se subjekti edhe aktualisht ka të regjistruar automjetin me targë AA \*\*\*.

**3.4** Referuar përgjigjes së ardhur nga DPSHTRR-ja, konstatohet se subjekti ka bërë deklaram të saktë në lidhje me këtë automjet. Për shkak se subjekti ka deklaruar si burim blerjeje të automjetit kursimet nga pagat, si dhe duke parë kohën e blerjes (shkurt 2015), atij iu kërkua të specifikonte burimin financiar të blerjes së automjetit tip “\*\*\*\*”, me targë AA \*\*\*, në vlerën 5,000 euro, blerë në datën 21.2.2015.

**3.5** Në përgjigje të pyetësorit nr. \*\*\*, subjekti ka deklaruar se: *“Automjeti tip “\*\*\*\*”, me targë AA \*\*\*, është blerë në vlerën 5,000 euro, sipas kontratës së shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., lidhur në datën 21.2.2015. Fillimisht, burimi financiar i blerjes së automjetit kanë qenë kursimet familjare në gjendje cash, ku është pakësuar përkohësisht gjendja cash në vlerën 600,000 lekë, si dhe të ardhurat nga paga ime dhe e bashkëshortes K.T gjatë vitit 2015. Në vijim, është tërhequr nga llogaria bankare depozitë pranë BKT-së shuma prej 300,000 lekësh, me qëllim ripërtëritjen e gjendjes cash. Ju sqaroj se deri në datën 31.12.2015, gjendja cash është barazuar në vlerën e saj fillestare përpara blerjes së automjetit. Për ripërtëritjen e gjendjes cash ka shërbyer shuma 300,000 lekë e tërhequr nga llogaria bankare depozitë pranë*

<sup>21</sup> Shihni përgjigjen e pyetësorit nr. \*\*\* dhe shkresën bashkëlidhur me lëndë “Kthim përgjigje”, nr. \*\*\* prot., datë 7.6.2023, dërguar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në vijim të kërkesës për verifikim, drejtuar kësaj Prokurorie.

<sup>22</sup> Shihni shkresat nr. \*\*\* prot., datë 17.7.2017 dhe nr. \*\*\* prot., datë 28.2.2019, të DPSHTRR-së.

<sup>23</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.9.2021, të DPSHTRR-së, në përgjigje të kërkesës së Komisionit.

*BKT-së, si dhe të ardhurat nga paga ime dhe e bashkëshortes K.T gjatë vitit 2015, në funksion të blerjes së automjetit tip “\*\*\*24”.*

**3.6** Subjekti nuk e ka deklaruar burimin e blerjes së këtij automjeti në DPV-në e vitit 2015, e aq më pak përdorimin e gjendjes *cash* të atij viti apo të vitit të mëparshëm (2014). Sipas subjektit, kursimet nga pagat barasvlerësohen me kursimet *cash*.

**3.7** Komisioni i kërkoi subjektit të provojë me dokumentacion provues (vërtetim nga Prokuroria) mospasjen e konfliktit të interesit duke vërtetuar se nuk ka pasur në ndjekje dhe shqyrtim ndonjë çështje me shtetasin K.Z, shitës i automjetit tip “\*\*\*”, blerë nga subjekti në vitin 2015. Në përgjigje të pyetësorit nr. \*\*\*, subjekti ka deklaruar<sup>25</sup> se gjatë ushtrimit të detyrës si prokuror në Prokurorinë e Juridiksionit të Përgjithshëm pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë nuk ka pasur asnjë çështje në hetim me këtë shtetas.

**3.8** Komisioni hartoi analizën financiare të mundësisë së blerjes së automjetit tip “\*\*\*”, blerë në vitin 2015 me kursimet nga pagat e subjektit dhe bashkëshortes dhe nga analiza financiare rezultoi se ata nuk kishin burime të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e këtij automjeti në datën 21.2.2015, si dhe për mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës.

**3.9** Në përfundim të hetimit Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti dhe bashkëshortja kishin pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme për blerjen e pasurisë automjet në vitin 2015 dhe mbulimin e shpenzimeve të periudhës në vlerën -263,832 lekë.

**3.10** Sa më sipër, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat e tij për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

**3.11** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një analizë financiare lidhur me mundësitë e blerjes së automjetit tip “\*\*\*”, me targë AA \*\*\*, duke pretenduar se ai dhe bashkëshortja kishin burime të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e automjetit në datën 21.2.2015, si dhe për mbulimin e shpenzimeve të periudhës.

**3.12** Gjithashtu, subjekti sqaroi se për blerjen e automjetit tip “\*\*\*”, në vlerën 688,250 lekë janë përdorur kursimet nga gjendja *cash* të mbartura nga viti 2014. Sipas subjektit, këto kurse nuk janë marrë parasysh nga Komisioni në analizën financiare të mundësisë së blerjes së automjetit.

**3.13** Faktikisht, Komisioni në këtë analizë financiare e kishte marrë në konsideratë pakësimin e gjendjes *cash* të vitit 2014. Kjo përfshihet në zërin “Ndryshim likuiditeti 31.12.2014 – 21.2.2015”, por në këtë zë përfshihet ndryshimi i gjithë likuiditeteve (bankë dhe *cash*) ndërmjet këtyre dy datave dhe këtu hyn edhe mbyllja e një *overdraftit* që subjekti kishte në llogarinë e tij të pagës në vlerën -307,609 lekë, të mbyllur në datën 21.1.2015. Vlerësohet si e pamundur ndarja e të ardhurave që shkojnë për shlyerjen e *overdraftit* dhe atyre që shkojnë për blerjen e automjetit dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera, prandaj të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortes së tij (300,749 lekë), si dhe zvogëlimi i kurseve *cash* (600,000 lekë) së bashku, nuk mjaftonin për blerjen e automjetit, shlyerjen e *overdraftit* dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera deri në datën 21.2.2015.

<sup>24</sup> Bashkëlidhur vërtetimi për ekstraktet e nxjerra nga arkivi, datë 8.6.2023, me nr. \*\*\* rep., lëshuar nga notere S.S. H.

<sup>25</sup> Shihni përgjigjen e pyetësorit nr. \*\*\* dhe shkresën bashkëlidhur me lëndë “Kthim përgjigje”, nr. \*\*\*\* prot., datë 7.6.2023, dërguar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në vijim të kërkesës për verifikim, drejtuar kësaj Prokurorie.



**3.14** Komisioni hartoi edhe një herë analizën financiare pas rishikimit të të ardhurave totale<sup>26</sup> për të parë mundësinë e subjektit për krijimin e pasurisë automjet tip “\*\*\*\*” në datën 21.2.2015.

**Analiza e mundësisë së blerjes së automjetit tip “\*\*\*\*”, me targë AA \*\*\*, në v. 2015.**

<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera</b>
Të ardhura subjekti 1.1.2015 – 21.2.2015	222,455
Të ardhura bashkëshortja e subjektit 1.1.2015 – 21.2.2015	78,294
<b>Të ardhura totale 1.1.2015 – 21.2.2015</b>	<b>300,749</b>
Shpenzime jetese 1.1.2015 – 21.2.2015	149,517
Shpenzime arsimimi fëmijët 1.1.2015 – 21.2.2015	32,000
<b>Shpenzime totale 1.1.2015 – 21.2.2015</b>	<b>181,517</b>
Blerje automjeti tip “****”, AA *** - 5,000 euro - 21.2.2015	688,250
Ndryshim likuiditeti 31.12.2014 – 21.2.2015	-286,186
<b>Pamundësia financiare</b>	<b>-282,832</b>

**3.15** Nga analiza financiare rezulton se subjekti dhe bashkëshortja nuk kishin burime të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e automjetit tip “\*\*\*\*” me datë 21.2.2015, si dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës.

**3.16** Në përfundim, Komisioni vlerësoi se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë, të pamjaftueshëm dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurisë automjet në vitin 2015, në vlerën 688,250 lekë.

#### **4. Llogari bankare në BKT, Vlorë**

**4.1** Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar llogari bankare pranë BKT-së, dega Vlorë, me burim kursime nga paga e subjektit dhe bashkëshortes dhe nga KEMP-i i të birit. Vlera në llogari: 1,804,000 lekë. Pjesa takuese: 50%.

**4.2** Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 24.1.2017, lëshuar nga BKT-ja për znj. K.T, e cila është kliente e bankës dhe ka të depozituar shumë 1,804,000 lekë; si dhe kontratën e depozitës bankare, nënshkruar në datën 25.10.2016 pranë kësaj banke nga znj. K.T, për shumë 1,804,000 lekë, me afat 6-12 muaj.

**4.3** BKT-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.7.2017<sup>27</sup>, dhe me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.10.2021<sup>28</sup>, ka konfirmuar në emër të bashkëshortes së subjektit K. T depozitën me vlerë 1,804,000 lekë.

**4.4** Nga informacioni i mbërritur nga institucionet bankare<sup>29</sup> Komisioni konstaton që burimi fillestar i kësaj llogarie është depozita e krijuar në datën 27.8.2009, në llogarinë në euro me nr. \*\*\*, në ProCredit Bank, në emër të bashkëshortes së subjektit K.T, në shumë 5,000 euro.

**4.5** Subjekti deklaron në përgjigje të pyetësorit të dytë që burimi i kësaj depozite janë kursimet familjare në gjendje *cash* të vitit 2008 dhe 2009 së bashku. Në DPV-në e vitit 2009, subjekti nuk e ka deklaruar krijimin e depozitës në vlerën 5,000 euro në ProCredit Bank dhe as nuk ka deklaruar pakësim të kursimeve *cash* të vitit 2008. Si rrjedhim, Komisioni analizoi mundësinë e subjektit për krijimin e kësaj depozite me të ardhurat e vitit 2009 deri në datën e krijimit të depozitës, 27.8.2009.

**4.6** Nga analiza financiare rezultoi se subjekti dhe bashkëshortja nuk kishin të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e depozitës në ProCredit Bank në shumë 5,000 euro, në

<sup>26</sup> Shihni trajtimin e çështjes së të ardhurave nga KEMP në pikën 9 të këtij vendimi.

<sup>27</sup> Shihni dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>28</sup> Shihni hetimin e Komisionit.

<sup>29</sup> Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 8.10.2021, nga ProCredit Bank.

datën 27.8.2009, si dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës duke rezultuar me një pamundësi financiare në vlerën -167,438 lekë.

**4.7** Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti deklaroi se gjatë vitit 2009 është çelur depozita në valutën euro pranë ProCredit Bank, në emër të bashkëshortes K.T në vlerën 5,000 euro dhe për çeljen e kësaj llogarie me datë 28.8.2009 kanë shërbyer kursimet në gjendje *cash* të mbartura nga viti 2008 (600,000 lekë), si dhe një pjesë e kursimeve të krijuara gjatë vitit 2009. Më pas, sipas subjektit, janë kursyer 700,000 lekë dhe totali i gjendjes *cash* në fund të vitit ka qenë 700,000 lekë.

**4.8** Gjithashtu, subjekti pretendon se duhen zbritur shpenzimet e udhëtimit për udhëtimet e punës ku shpenzimet kanë qenë të mbuluara nga organizatorët për të dhe bashkëshorten. Ndërkohë, ky pretendim i subjektit vlerësohet si i pabazuar nga Komisioni, meqë ai nuk e dokumentoi kryerjen e shpenzimeve.

**4.9** Komisioni hartoi edhe një herë analizën financiare pas rishikimit të të ardhurave totale<sup>30</sup> për të parë mundësinë e subjektit për krijimin e depozitës në vlerën 5,000 euro pranë ProCredit Bank, datë 27.8.2009.

**Analiza e mundësisë së krijimit të depozitës 5,000 euro – datë 27.8.2009.**

<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera</b>
Të ardhura subjekti 1.1.2009 – 27.8.2009	783,581
Të ardhura bashkëshortja e subjektit 1.1.2009 – 27.8.2009	239,684
<b>Të ardhura totale 1.1.2009 – 27.8.2009</b>	<b>1,023,265</b>
Shpenzime jetese 1.1.2009 – 27.8.2009	364,320
Shpenzime mobilimi 1.1.2009 – 27.8.2009	100,000
Shpenzime udhëtimi 1.1.2009 – 27.8.2009	105,621
Shpenzime arsimimi fëmijët 1.1.2009 – 27.8.2009	24,000
<b>Shpenzime totale 1.1.2009 – 27.8.2009</b>	<b>593,941</b>
Ndryshim likuiditeti 31.12.2008 – 27.8.2009	666,362
<b>Pamundësia financiare</b>	<b>-237,038</b>

**4.10** Nga analiza financiare rezultoi se subjekti dhe bashkëshortja nuk kishin burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e depozitës në ProCredit Bank, në datën 27.8.2009, si dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës duke rezultuar me një pamundësi financiare në vlerën -237,038 lekë.

**4.11** Komisioni vlerësoi se subjekti në shpjegimet e tij nuk arriti të përmbyste barrën e provës së lënë në rezultatet e hetimit për shkak se: (a) në DPV-në e vitit 2009, subjekti nuk ka deklaruar pakësimin e kursimeve *cash* nga viti i mëparshëm; (b) në DPV-në e vitit 2009, subjekti nuk e deklaroi fare krijimin e depozitës në vlerën 5,000 euro pranë ProCredit Bank; (c) të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortes deri në datën 27.8.2009 janë të pamjaftueshme për krijimin e depozitës dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës.

**4.12** Nga informacioni i mbërritur nga institucionet bankare Komisioni konstatoi që në datën 11.3.2010 derdhet shuma 5,000 euro në llogarinë në euro nr. \*\*\*, në ProCredit Bank, në emër të bashkëshortes së subjektit K.T. Kjo depozitë i shtohet depozitës së mëparshme të maturuar tashmë në vlerën 5,202.5 euro, duke arritur një vlerë prej 10,296.06 euro në fund të vitit 2010.

<sup>30</sup> Shihni trajtimin e çështjes së të ardhurave nga KEMP në pikën 9 të këtij vendimi.

**4.13** Subjekti deklaroi në përgjigje të pyetësorit të dytë se burimi i kësaj depozite janë kursimet familjare vjetore në shumën 850,000 lekë, të deklaruar në deklaratën periodike përkatëse. Subjekti e ka deklaruar depozitën në ProCredit Bank në shumën 5,000 euro, në DPV-në e vitit 2010. Komisioni analizoi mundësinë e subjektit për krijimin e kësaj depozite me të ardhurat e vitit 2010 deri në datën e krijimit të depozitës 12.3.2010, nga ku rezultoi se subjekti dhe bashkëshortja nuk kishin të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e depozitës në ProCredit Bank, në shumën 5,000 euro, në datën 11.3.2010, si dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës dhe shtimin e pasurive duke rezultuar me një pamundësi financiare në vlerën -20,718 lekë.

**4.14** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti deklaroi se në DPV-në e vitit 2010 ka deklaruar kursime familjare në vlerën 850,000 lekë dhe pakësimin e gjendjes *cash* në vlerën 1,200 euro për blerje automjeti dhe 5,000 euro për çelje llogarie bankare depozitë. Sipas tij, me termin “Pakësim të gjendjes *cash*” i është referuar gjendjes *cash* të disponueshme gjatë vitit 2010. Në këtë kuptim, sipas subjektit, gjendja *cash* e mbartur nga viti 2009 (700,000 lekë) ka shërbyer fillimisht për blerjen e automjetit (166,572 lekë) dhe, në vijim, së bashku me kursimet vjetore për krijimin e llogarisë bankare depozitë (5,000 euro). Më pas, sipas tij, gjendja *cash* është shtuar gjatë vitit me kursimet familjare me vlerën 850,000 lekë, duke shkuar në fund të vitit një gjendje prej 700,000 lekësh.

**4.15** Rezulton se ky qëndrim i subjektit në përgjigje të rezultateve të hetimit bie në kundërshtim me qëndrimin e tij në përgjigje të pyetësorit nr. \*\*\*, në të cilin pretendonte se në fund të vitit 2009 dhe 2010 gjendja e kursimeve *cash* ishte 0 (zero), ndërkohë kursimet familjare vjetore në shumën 850,000 lekë përbënin burimin e krijimit të automjetit dhe depozitës në ProCredit Bank.

**4.16** Komisioni hartoi edhe një herë analizën financiare pas rishikimit të të ardhurave totale<sup>31</sup> për të parë mundësinë e subjektit për krijimin e depozitës në vlerën 5,000 euro pranë ProCredit Bank në datën 12.3.2010 si më poshtë:

**Analiza e mundësisë së krijimit të depozitës 5,000 euro – datë 12.3.2010**

<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera</b>
Të ardhura subjekti 1.1.2010 – 12.3.2010	304,010
Të ardhura bashkëshortja e subjektit 1.1.2010 – 12.3.2010	69,217
<b>Të ardhura totale 1.1.2010 – 12.3.2010</b>	<b>373,227</b>
Shpenzime jetese 1.1.2010 – 12.3.2010	113,850
Shpenzime arsimimi fëmijët 1.1.2010 – 12.3.2010	30,000
<b>Shpenzime totale 1.1.2010 – 12.3.2010</b>	<b>143,850</b>
Blerje automjeti tip “****”, VL *** – 1,200 euro – 2.3.2010	166,572
Ndryshim likuiditeti 31.12.2009 – 12.3.2010	109,623
<b>Pamundësia financiare</b>	<b>-46,818</b>

**4.17** Nga analiza financiare rezulton se subjekti dhe bashkëshortja nuk kishin burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e depozitës në ProCredit Bank, në datën 11.3.2010, shtimin e pasurive të tjera, si dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës, duke rezultuar me një pamundësi financiare në vlerën -46,181 lekë.

**4.18** Komisioni vlerësoi se subjekti në shpjegimet e tij nuk arriti të përmbyste barrën e provës së lënë në rezultatet e hetimit për shkak se: (a) në DPV-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar shumë qartë që depozita në ProCredit Bank në vlerën 5,000 euro ka si burim kursimet familjare me burim pagat e deklaruesit dhe të bashkëshortes; (b) në DPV-në e vitit 2010, subjekti nuk e

<sup>31</sup> Shihni trajtimin e çështjes së të ardhurave nga KEMP në pikën 9 të këtij vendimi.

deklaron pakësimin e gjendjes *cash* si burim për krijimin e depozitës në vlerën 5,000 euro pranë ProCredit Bank; (c) të ardhurat e subjektit dhe të bashkëshortes deri në datën 11.3.2010 janë të pamjaftueshme për krijimin e depozitës, blerjen e automjetit dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës.

**4.19** Vlera e maturuar e kësaj llogarie në shumën 10,292 euro tërhiqet nga bashkëshortja e subjektit K.T në datën 19.9.2011 dhe depozitohet në llogarinë në emrin e saj në BKT<sup>32</sup> me nr. \*\*\*. Në datën 3.4.2013, vlera e depozitës së maturuar në BKT, në shumën 10,102.69 euro, këmbëhet nga znj. K.T në shumën 1,411,345.79 lekë dhe kalon në një llogari tjetër depozite të saj në BKT me nr. \*\*\*. Kjo vlerë i bashkohet depozitës së krijuar në datën 5.4.2012, në shumën 600,000 lekë.

**4.20** Në fund të viti 2013, gjendja e depozitës arrin vlerën 2,295,906.56 lekë.

**4.21** Në fund të vitit 2014, gjendja e depozitës arrin vlerën 2,300,000 lekë.

**4.22** Në fund të vitit 2015, gjendja e depozitës arrin vlerën 2,000,000 lekë pas tërheqjeve të bëra në këtë vit.

**4.23** Në fund të vitit 2016, gjendja e depozitës arrin vlerën 1,804,000 lekë pas tërheqjeve të bëra në këtë vit.

**4.24** Lidhur me mundësinë e krijimit të depozitës prej 600,000 lekësh në datën 5.4.2012 nga bashkëshortja e subjektit, në përgjigje të pyetësorit nr. \*\*\* subjekti deklaroi se kursimet vjetore të deklaruara në DPV-në e vitit 2012, në shumën 600,000 lekë, faktikisht janë depozituar në llogarinë bankare depozite në BKT. Ndërkohë, në DPV-në e vitit 2012 subjekti nuk deklaroi depozitën në BKT, por vetëm kursime familjare në lekë *cash* të krijuara gjatë vitit 2012 në shumën 600,000 lekë.

**4.25** Komisioni analizoi mundësinë e subjektit dhe bashkëshortes për krijimin e kësaj depozite në shumën 600,000 lekë me të ardhurat e vitit 2012 deri në datën (5.4.2012) e krijimit të depozitës si më poshtë:

**4.26** Nga analiza financiare rezultoi se subjekti dhe bashkëshortja nuk kishin të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e depozitës në BKT, në shumën 600,000 lekë, në datën 5.4.2012, si dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës, duke rezultuar me një pamundësi financiare në vlerën -345,762 lekë.

**4.27** Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti deklaroi se Komisioni, në mënyrë të gabuar, nuk ka përfshirë në llogaritjen e mundësisë së krijimit të depozitës gjendjen *cash* të mbartur nga viti 2011, duke qenë se gjendja *cash* në vlerën 1,400,000 lekë ka shërbyer efektivisht si burim për krijimin e llogarisë bankare depozite pranë BKT-së.

**4.28** Kjo bie në kundërshtim me deklarin e bërë nga subjekti në DPV-në e vitit 2012. Aty subjekti ka deklaruar qartësisht: “Kursime familjare në lekë *cash* të krijuara gjatë vitit 2012 – 600,000 lekë. Pasuri e përbashkët me bashkëshorten”. Prandaj pretendimi i subjektit në parashtrimet e tij se depozita në BKT u krijua me kursimet *cash* të vitit të mëparshëm duket e pabazuar.

**4.29** Komisioni hartoi edhe një herë analizën financiare pas rishikimit të të ardhurave totale<sup>33</sup> për të parë mundësinë e subjektit për krijimin e depozitës në vlerën 5,000 euro, në ProCredit Bank, me datë 11.3.2010, si më poshtë:

<sup>32</sup> Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 15.10.2021, nga BKT-ja.

<sup>33</sup> Shihni trajtimin e çështjes së të ardhurave nga KEMP në pikën 9 të këtij vendimi.

**Analiza e mundësisë së krijimit të depozitës 600,000 lekë – datë 5.4.2012.**

<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera</b>
Të ardhura subjekti 1.1.2012 – 5.4.2012	340,528
Të ardhura bashkëshortja e subjektit 1.1.2012 – 5.4.2012	128,959
<b>Të ardhura totale 1.1.2012 – 5.4.2012</b>	<b>469,487</b>
Shpenzime jetese 1.1.2012 – 5.4.2012	139,548
Shpenzime arsimimi fëmijët 1.1.2012 – 5.4.2012	30,000
<b>Shpenzime totale 1.1.2012 – 5.4.2012</b>	<b>169,548</b>
Ndryshim likuiditeti 31.12.2011 – 5.4.2012	669,401
<b>Pamundësia financiare</b>	<b>-369,462</b>

**4.30** Nga analiza financiare rezulton se subjekti dhe bashkëshortja nuk kishin burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e depozitës në ProCredit Bank, në datën 5.4.2012, shtimin e likuiditeteve të tjera, si dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës duke rezultuar me një pamundësi financiare në vlerën -369,462 lekë.

**4.31** Komisioni vlerësoi se subjekti në parashtrimet e tij nuk arriti të përmbyste barrën e provës së lënë në rezultatet e hetimit për shkak se pavarësisht sqarimeve të tij: (a) në DPV-në e vitit 2012 subjekti ka deklaruar kursime *cash* të krijuara gjatë vitit 2012; (b) në DPV-në e vitit 2012, subjekti nuk e deklaroi fare krijimin e depozitës në vlerën 600,000 lekë në BKT; (c) të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortes deri në datën 5.4.2012 janë të pamjaftueshme për krijimin e depozitës dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës.

**4.32** Nga analizimi i gjitha depozitave të krijuara ndër vite, të cilat finalizohen me gjendjen e mbetur të depozitës në fund të vitit 2016 në vlerën 1,804,000 lekë, duket se nuk vërtetohet mundësia financiare e subjektit dhe bashkëshortes së tij për krijimin e tyre dhe përballimin e shpenzimeve të tjera në periudhat përkatëse.

**4.33** Në përfundim të hetimit Komisioni arriti në konkluzionet si vijon:

- Subjekti nuk i ka deklaruar depozitat në DPV-të e viteve të krijimit të tyre dhe as ndryshimet e tyre ndër vite.
- Subjekti ka rezultuar me një pamjaftueshmëri financiare totale prej 533,917 lekësh për krijimin e këtyre depozitave ndër vite e, si rrjedhim, edhe të gjendjes përfundimtare të depozitës në vlerën 1,804,000 lekë, të deklaruar në deklaratën *Vetting*.

**4.34** Sa më sipër, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat e tij për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

**4.35** Pas shqyrtimit të shpjegimeve përfundimtare, Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte të kundërtën e konstatimeve, duke u gjendur në kushte pamjaftueshmërie totale të burimeve të ligjshme në vlerën 653,31,7 lekë (237,038 + 46,818 + 369,462) për krijimin e depozitave: 5,000 euro në datën 27.8.2009; 5,000 euro në datën 11.3.2010; dhe 600,000 lekë në datën 5.4.2012, si dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës dhe shtimin e pasurive, sipas përcaktimeve të shkronjës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

## **5. Gjendje *cash* e deklaruar ndër vite.**

**5.1** Subjekti nuk deklaroi kursime *cash* në deklaratën e pasurisë *Vetting*, ndërkohë ka deklaruar gjendje apo kursime *cash* nga viti 2004 deri në vitin 2016 në DPV-të përkatëse, si më poshtë:

- Në DPV-në e vitit 2004 ka deklaruar: “Gjendje cash 1,000,000 lekë, 1 janar – 31 dhjetor 2004”.
- Në DPV-në e vitit 2005 ka deklaruar: “Dorian dhe K.T, kursime familjare 1,000,000 lekë”.
- Në DPV-në e vitit 2006 ka deklaruar: “Kursime familjare 800,000 lekë”.
- Në DPV-në e vitit 2007 ka deklaruar: “Pakësuar gjendja cash për blerjen e apartamentit të lartpërmendur – 2,800,000 lekë. Gjendja deri më 31.12.2007 është 0 (zero)”. Në këtë DPV ka deklaruar edhe kursime familjare në vlerën 800,000 lekë.
- Në DPV-në e vitit 2008 ka deklaruar: “Kursime familjare 600,000 lekë”.
- Në DPV-në e vitit 2009 ka deklaruar: “Kursime familjare 700,000 lekë”.
- Në DPV-në e vitit 2010 ka deklaruar: “Kursime familjare me burim pagat e deklaruesit dhe të bashkëshortes 8,500,000 (tetëqind e pesëdhjetë mijë)<sup>34</sup> lekë, të konvertuara në 6,500 euro. Nga këto kursime, në datën 12.8.2010 është krijuar një depozitë në ProCredit Bank me afat 3-mujor 5,000 euro dhe në muajin mars të vitit 2010 janë pakësuar për blerjen e një automjeti “\*\*\*\*” me targë VL \*\*\*\* 1,200 euro”.
- Në DPV-në e vitit 2011 ka deklaruar: “Kursime familjare me burim pagat e deklaruesit dhe të bashkëshortes 700,000 lekë”.
- Në DPV-në e vitit 2012 ka deklaruar: “Kursime familjare në lekë cash të krijuara gjatë vitit 600,000 lekë. Pasuri e përbashkët me bashkëshorten”.
- Në DPV-në e vitit 2013 ka deklaruar: “Kursime familjare në lekë cash të krijuara gjatë vitit 400,000 lekë. Pasuri e përbashkët me bashkëshorten”.
- Në DPV-në e vitit 2014 ka deklaruar: “Kursime familjare në lekë cash të krijuara gjatë vitit 2014 500,000 lekë. Pasuri e përbashkët me bashkëshorten”.
- Në DPV-në e vitit 2015 ka deklaruar: “Kursime familjare në lekë cash të krijuara gjatë vitit 2015 300,000 lekë”.
- Në DPV-në e vitit 2016 ka deklaruar: “Shtim pasurie nga të ardhurat si P. F. K.T dhe kursime familjare 700,000 lekë”.

**5.2** Lidhur me deklarinimin e kursimeve cash në DPV-në e vitit 2007, konstatohet se në faqen 3 të kësaj deklarate subjekti ka plotësuar rubrikën në lidhje me pasurinë e paluajtshme apartament banimi, blerë në vlerën 4,000,000 lekë, sipas kontratës noteriale të vitit 2007, ndërsa në një faqe tjetër (faqe e shtuar), pas faqes nr. \*\*\*, në datën 30.10.2008, subjekti ka plotësuar përsëri pasurinë e paluajtshme apartament banimi, por në këtë faqe, duke specifikuar edhe burimin e blerjes, konkretisht: “Pakësuar gjendja cash në shumën 2.8 milionë lekë + 9,000 dollarë huamarrje nga vëllai me banim në Amerikë + kursimet vjetore. Pakësuar gjendja cash për blerjen e apartamentit të lartpërmendur 2,800,000 lekë. Gjendja deri më 31.12.2007 është 0 (zero)”. Ndërkohë, në faqen 8 të po kësaj deklarate, tek rubrika e personit të lidhur/bashkëshortes së subjektit, deklarohet kursime familjare 800,000 lekë, duke shkaktuar paqartësi për shkak të deklarinimit në vlerën 0 (zero) lekë, në datën 31.12.2007, si rezultat i pakësimit të gjendjes cash për blerjen e apartamentit.

**5.3** Subjekti është pyetur në lidhje me këto konstatime që të sqarojë kohën, mënyrën dhe arsyen e dorëzimit të faqes së deklaratës periodike, që mban datën 30.10.2008, si dhe të sqarojë mospërputhjen e deklarinimit të kursimeve familjare/cash ndërmjet deklarinimit në faqen nr. \*\*\* dhe deklarinimit në faqen e shtuar në datën 30.10.2008.

---

<sup>34</sup> Në analizën financiare është konsideruar shifra e shkruar me fjalë në kllapa, pra 850,000 lekë dhe jo 8,500,000 lekë.

**5.4** Në përgjigje të pyetësorit nr. \*\*\*, subjekti sqaron se ka dorëzuar rregullisht DPV-në e vitit 2007 pranë ILDKPKI-së, sipas afatit të caktuar ligjor, në datën 10.3.2008. Në kuadër të kontrollit të dokumentacionit të dorëzuar, i është kërkuar nga inspektorati përkatës plotësimi i faqes shtesë, pas faqes nr. \*\*\* të deklaratës periodike, për arsye të përshkrimit më të detajuar të shtimeve dhe pakësimeve që kishin ndodhur në pasuri për vitin 2007. Për këtë arsye, në faqen shtesë të plotësuar pas faqes nr. \*\*\* të DPV-së së vitit 2007 është specifikuar edhe burimi i të ardhurave për blerjen e pasurisë së paluajtshme apartament banimi në qytetin e Vlorës, të blerë në datën 19.11.2007, sipas kërkesës së vetë Inspektoratit. Kjo faqe shtesë është dorëzuar rregullisht pranë ILDKPKI-së, në datën 30.10.2008.

**5.5** Lidhur me deklarin në faqen nr. \*\*\* të DPV-së së vitit 2007, subjekti ka sqaruar se shuma prej 800,000 lekësh në gjendje *cash* është e njëjta shumë e deklaruar në kursimet familjare sipas DPV-së së vitit 2006. Për vitin 2007 nuk ka pasur shtesë në gjendjen financiare të kursimeve familjare, prandaj ka deklaruar shumën e mbartur, që është shtuar në kursimet familjare të vitit 2006. Kjo shumë korrespondon me vlerën 800,000 lekë, të kursyera nga të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes K.T gjatë vitit 2006, ku së bashku me kursimet familjare në gjendje *cash* të kursyera në vitet e mëparshme ka përbërë shumën totale prej 2,800,000 lekësh, që ka shërbyer si burim për blerjen e pasurisë së paluajtshme apartament banimi në vitin 2007. Pra, shuma e deklaruar në DPV-në e vitit 2007 është plotësisht në përputhje me vlerën totale të kursimeve familjare në gjendje *cash*, nga viti 2004 deri në vitin 2007.

**5.6** ILDKPKI-ja, në përgjigje<sup>35</sup> të kërkesës së Komisionit, ka vënë në dispozicion kopje të procesverbalit të datës 30.10.2008, ku subjekti i deklarimit Dorjan Tafilaj ka plotësuar faqen e aseteve në DPV-në e vitit 2007, ku ka sqaruar se ka pakësuar gjendjen *cash* dhe përdorur për blerjen e apartamentit.

**5.7** Subjektit i është kërkuar të saktësojë gjendjen *cash* në banesë në datën 31 dhjetor të çdo viti, si dhe shtesat dhe pakësimet e kësaj gjendjeje për secilin vit nga viti 2004 deri në vitin 2016.

**5.8** Në përgjigje të pyetësorit nr. \*\*\*, subjekti ka paraqitur gjendjen *cash* nga viti 2004 deri në vitin 2016, si dhe shpjegimet përkatëse për shtesat dhe pakësimet e gjendjes *cash* për secilin vit, duke deklaruar se *gjendja cash sipas tabelës së paraqitur mund të jetë objekt i ndryshimeve në vlerë, pasi ka kaluar një periudhë relativisht e gjatë nga shtimet dhe pakësimet e ndodhura në pasuri*. Gjithashtu, subjekti sqaroi se nuk ka arritur të verifikojë plotësisht vërtetimet për depozitat bankare ndër vite dhe nëse në vijim do të lindë nevoja për sqarime të mëtejshme mbi gjendjen *cash* të deklaruar, do të ishte i gatshëm të paraqiste shpjegime dhe dokumentacion ligjor shtesë.

**5.9** Lidhur me ndryshimet e gjendjes *cash*, subjekti ka sqaruar: *“Gjendja cash në datën 31 dhjetor të vitit 2004 ka qenë 0 lekë, pasi shuma prej 1,000,000 lekësh më 31.12.2004, e deklaruar si kursime familjare në DPV-në e vitit 2004, është depozituar tërësisht në llogarinë bankare depozitë pranë bankës ISP Bank. Burimi i kësaj depozite kanë qenë kursimet familjare deri në vitin 2004. Prandaj dhe është plotësuar nga ana ime në DPV-në përkatëse vlera e gjendjes cash me burim kursimet familjare, në shumën 1,000,000 lekë.*

*Shtesa në gjendjen cash për vitin 2005 deri më 31.12.2005 ka si burim kursimet familjare për këtë vit kalendarik, në vlerën 1,000,000 lekë, si dhe shumën tjetër prej 1,000,000 lekësh të tërhequr nga depozita bankare pranë ISP Bank, të depozituar në vitin 2004. Me mbylljen e depozitës bankare përkatëse në vitin 2005, shuma totale e gjendjes cash deri në datën 31.12.2005 ka qenë 2,000,000 lekë.*

---

<sup>35</sup> Shihni përgjigjen nr. \*\*\* prot., datë 8.6.2023, të ILDKPKI-së.

*Shtesa në gjendjen cash për vitin 2006 ka si burim kursimet familjare të deklaruara gjatë vitit 2006, në shumën 800,000 lekë. Gjendje cash total 2,800,000 lekë.*

*Pakësimi i gjendjes cash për vitin 2007 është në shumën 2,800,000 lekë. Kjo gjendje cash ka shërbyer si burim për blerjen e pasurisë së paluajtshme apartament banimi në qytetin e Vlorës, në datën 19.11.2007.*

*Shtesë në gjendjen cash për vitin 2008, në shumën 600,000 lekë, me burim kursimet familjare deri në datën 31.12.2008.*

*Ju sqarohet se gjendja cash për vitin 2009 është pakësuar për arsye të krijimit të llogarisë bankare depozitë në ProCredit Bank dhe depozitimit të shumës prej 5,000 euro në vitin 2009. Si burim për depozitimin bankar kanë shërbyer kursimet familjare në gjendje cash të vitit 2008 dhe vitit 2009 së bashku. Saktësoj se shuma prej 700,000 lekësh, e deklaruar si kursime në gjendje cash në DPV-në e vitit 2009, ka përfshirë edhe kursimet familjare të vitit 2008, të cilat kanë qenë në shumën 600,000 lekë. Pra, në total kursimet familjare në gjendje cash deri në vitin 2007<sup>36</sup> kanë qenë 700,000 lekë, të cilat janë konvertuar në valutën euro dhe janë depozituar në llogarinë bankare depozitë.*

*Gjendja cash për vitin 2010 ka qenë 0 lekë. Kursimet familjare vjetore në shumën 850,000 lekë, të deklaruara në deklaratën periodike përkatëse, kanë shërbyer si burim për krijimin e llogarisë së re bankare depozitë pranë ProCredit Bank, në shumën 5,000 euro, si dhe për blerjen e automjetit “\*\*\*”, me vlerë 1,200 euro.*

*Shtesë në gjendjen cash për vitin 2011, në vlerën 700,000 lekë, me burim kursimet familjare për këtë vit kalendarik.*

*Gjendja cash nuk ka pësuar ndryshime për vitin 2012, pasi shuma 600,000 lekë, e deklaruar si kursime vjetore në deklaratën periodike përkatëse, është depozituar në llogari bankare depozitë me vlerë 600,000 lekë pranë Bankës Kombëtare Tregtare.*

*Gjendja cash për vitin 2013 është shtuar në shumën 150,000 lekë, me burim kursimet familjare për këtë vit kalendarik. Sqarohet se nga shuma e deklaruar prej 400,000 lekësh si kursime familjare në deklaratën periodike, 250,000 lekë janë depozituar në llogarinë bankare depozitë pranë BKT-së, me gjendje 2,295,906 lekë deri në datën 31.12.2013.*

*Gjendja cash për vitin 2014 është shtuar në shumën 500,000 lekë, me burim kursimet familjare gjatë vitit 2014.*

*Gjendja cash për vitin 2015 është shtuar në shumën 300,000 lekë, me burim kursimet familjare gjatë vitit 2015. Bashkëlidhur kopje kontratë shitblerjeje automjeti nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., lidhur në datën 17.11.2017.*

*Gjendja cash për vitin 2016 është shtuar në shumën 700,000 lekë, me burim të ardhurat e bashkëshortes si P.F. K.T, NUIS \*\*\*, dhe kursimet familjare gatë vitit 2016”.*

**5.10** Komisioni krahasoi vlerat e deklaruara të kursimeve cash nga subjekti në DPV-të e viteve të ndryshme me vlerat e deklaruara nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. \*\*\*. Sqarimet e dhëna në përgjigje të pyetësorit nr. \*\*\* nga subjekti nuk përputhen me vlerat dhe mënyrën e deklarimit në DPV-të e viteve 2004 – 2016. Në disa raste subjekti pretendoi se vlerat e deklaruara në DPV si kursime në të vërtetë nuk janë shtesa por gjendje cash. Në raste të tjera, ai pretendoi se vlerat e deklaruara si kursime cash në fakt ishin gjendje të depozituara atë vit në bankë.

**5.11** Në analizën financiare, kursimet cash janë përfshirë sipas deklarimit të subjektit në deklaratat periodike vjetore. Deklarimet e subjektit me shprehjen “Gjendje e kursimeve cash” janë konsideruar si gjendje dhe jo shtesë. Ndërkohë, deklarimet e subjektit me shprehjen

---

<sup>36</sup> Referuar përgjigjes së pyetësorit nr. \*\*\* për këtë pikë, duket se subjekti ka shkruar gabim vitin 2007 në vend të vitit 2009.



“Kursime cash/kursime familjare” janë konsideruar në analizën financiare si shtim kursimesh cash.

**5.12** Komisioni i kërkoi subjektit të sqarojë arsyen e mosdeklarimit të kursimeve cash në deklaratën *Vetting*, ndërkohë që sipas sqarimit të dhënë më parë në përgjigje të pyetësorit nr. 2, gjendja progresive e kursimeve cash në fund të vitit 2016 ishte në shumën 2,350,000 lekë.

**5.13** Subjekti, në përgjigjen e pyetësorit nr. \*\*\*, deklaroi: “*Ju sqaroj se mungesa e deklarimit nga ana ime të gjendjes cash në fund të vitit 2016 në deklaratën *Vetting* ka qenë një keqkuptim jo i qëllimshëm mbi mënyrën e plotësimit të deklaratës, pasi gjendja e kursimeve cash është deklaruar rregullisht në deklaratat periodike vjetore deri në vitin 2016... Në asnjë rrethanë nuk ka qenë qëllimi im deklarimi i pasaktë i kursimeve në gjendje cash në deklaratën *Vetting*, duke pasur parasysh se kam deklaruar rregullisht burimet e ligjshme të të ardhurave familjare ndër vite”.*

**5.14** Në analizë të deklarimit të vitit 2007, subjekti ka deklaruar pakësim të gjendjes cash (të vlerës 2,800,000 lekë) dhe deklarim të gjendjes cash përsëri atë vit, në vlerën 800,000 lekë. Në faqen (e shtuar më 30.10.2008) e DPV-së së vitit 2007, subjekti ka sqaruar se *gjendja deri më 31.12.2007 është 0 (zero)*. Referuar edhe sqarimit të bërë në procesverbalin e sipërcituar, i sjellë nga ILDKPKI-ja, Komisioni nuk bëri pjesë të analizës vlerën 800,000 lekë, të deklaruar kursime cash për vitin 2007.

**5.15** Lidhur me mundësinë e subjektit dhe bashkëshortes për krijimin e gjendjeve të kursimeve cash ndër vite, referojuni analizës financiare të viteve 2004 – 2016.

**5.16** Në përfundim të hetimit, Komisioni arriti në konkluzionin si vijon:

- Subjekti nuk ka deklaruar saktë gjendjen cash në deklaratat periodike vjetore deri në deklaratën *Vetting*. Ai duket se ka konfuzuar dhe barazuar në deklarim ndryshimin/gjendjen e likuiditeteve cash me ato në bankë.
- Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* kursime cash, ndërkohë që ka deklaruar shtesë të kursimeve familjare deri në DPV-në e vitit 2016.

**5.17** Sa më sipër, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat e tij për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga ana e Komisionit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**5.18** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka paraqitur argumentet e tij në lidhje me mënyrën e konceptimit të ndryshimit të gjendjes cash, duke theksuar se vlerat objekt ndryshimi të kësaj gjendjeje kanë qenë në çdo rast të individualizuara dhe konkrete, duke pretenduar se shtimi i gjendjes cash është përcaktuar rregullisht dhe shpenzimet për të cilat ka shërbyer pakësimi i kësaj gjendjeje kanë qenë të dokumentuara plotësisht gjatë procesit të rivlerësimit. Subjekti deklaroi: “*Siç kam shpjeguar në analizat financiare vjetore, Komisioni ka kryer një përlllogaritje të gabuar të gjendjes cash, pasi nuk ka marrë në konsideratë përdorimin e gjendjes cash në shpenzime për blerjen e automjeteve, çeljen e llogarive bankare, si dhe shlyerjen e detyrimeve ndër vite.*

*Konstatohet se shpjegimet e dhëna nga ana ime në përgjigjet e pyetësorit nr. \*\*\* kanë rezultuar pjesërisht jo të plota. Prej Komisionit më janë kërkuar shpjegime të detajuara për ndryshimet në gjendjen cash që kanë ndodhur përpara një kohe relativisht të gjatë. Në mungesë të dokumenteve statement nga bankat nuk ka qenë e mundur për mua të kujtoja dhe të paraqisja shpjegime tërësisht të plota dhe të detajuara mbi veprimet bankare dhe ndryshimet në gjendjen cash sipas afatit të kërkuar nga Komisioni.*

*Ndërsa lidhur me mungesën e deklaramit nga ana ime të gjendjes cash në deklaratën Vetting, ka qenë një keqkuptim jo i qëllimshëm nga ana ime mbi mënyrën e duhur të plotësimit të kësaj deklarate.*

*Në përgjigje të pyetësorit nr. \*\*\*, të datës 12.6.2023, kam parashikuar rezervën se vlera e gjendjes cash të pasqyruar prej meje në atë kohë mund të pësonte ndryshime, pikërisht për shkak të mënyrës si unë kam konceptuar ndryshimin e gjendjes cash ndër vite, të lidhur ngushtësisht me shpenzimet e individualizuara të familjes time”.*

**5.19** Në vazhdim, subjekti paraqet në formë tabele gjendjet e kursimeve cash në fund të secilit vit. Më pas ai shpjegon: *“Sipas analizave financiare, për çdo vit deklarami kam shpjeguar mënyrën si kam konceptuar ndryshimin e gjendjes cash dhe veçanërisht pakësimin e saj në raport të drejtë me shpenzimet dhe çeljen e llogarive bankare, si dhe shlyerjen e detyrimeve bankare nga unë dhe bashkëshortja. Në të gjitha rastet dhe për çdo vit të deklaramit kam paraqitur argumentet e mia lidhur me këtë mënyrë të konceptimit të ndryshimit të gjendjes cash. Theksoj se vlerat objekt ndryshimi të gjendjes cash kanë qenë në çdo rast të mirë të individualizuara dhe konkrete. Ndërsa shtimi i gjendjes cash është referuar në deklaramet periodike vjetore në formën e kursimeve familjare dhe është përcaktuar rregullisht. Shpenzimet për të cilat ka shërbyer pakësimi i gjendjes cash kanë qenë të dokumentuara plotësisht gjatë procesit të rivlerësimit dhe është analizuar nga ana ime përdorimi konkret i gjendjes së disponueshme për të gjitha ndryshimet përkatëse”.*

### **Vlerësimi i Komisionit**

**5.20** Subjekti, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ka ndryshuar qëndrimin e tij lidhur me kursimet cash të viteve 2009 – 2016, si më poshtë vijon:

- Në vitin 2009, ndryshe nga pyetësori, deklaroi se në fund të vitit kishte 700,000 lekë kursime cash dhe jo zero lekë. Gjithashtu, pretendon se gjendja cash e zotëruar në fund të vitit 2008 (600,000 lekë) ka shërbyer për krijimin e depozitës 5,000 euro në datën 28.8.2009.
- Në vitin 2010, ndryshe nga pyetësori, deklaroi se në fund të vitit kishte 700,000 lekë kursime cash dhe jo zero lekë. Gjithashtu pretendon se gjendja cash e zotëruar në fund të vitit 2009 (700,000 lekë) ka shërbyer për blerjen e automjetit 1,200 euro dhe më pas krijimin e depozitës 5,000 euro në datën 5.4.2010. Ndërkohë, në DPV dhe në pyetësor kishte deklaruar se automjetin dhe depozitën i krijoi si pasuri me burim kursimet familjare vjetore dhe gjendja cash ka qenë 0 (zero).
- Në vitin 2011, ndryshe nga pyetësori, deklaroi se në fund të vitit kishte 1,400,000 lekë kursime cash dhe jo 700,000 lekë.
- Në vitin 2012, ndryshe nga pyetësori, deklaroi se në fund të vitit kishte 1,400,000 lekë kursime cash dhe jo 700,000 lekë. Subjekti pretendoi se me gjendjen cash të vitit 2011 ka krijuar depozitën 600,000 lekë në BKT, ndërkohë që në pyetësor kishte deklaruar se e vetmja shtesë kursimesh vjetore kishte shkuar për krijimin e depozitës.
- Në vitin 2013, ndryshe nga pyetësori, deklaroi se në fund të vitit kishte 1,800,000 lekë kursime cash dhe jo 850,000 lekë. Subjekti deklaroi se janë shtuar kursimet cash me vlerën 400,000 lekë, ndërkohë që në pyetësor ai kishte deklaruar se gjendja cash është shtuar vetëm me shumën 150,000 lekë sepse pjesa tjetër (250,000 lekë) ishte depozituar në BKT.
- Në vitin 2014, ndryshe nga pyetësori, deklaroi se në fund të vitit kishte 2,300,000 lekë kursime cash dhe jo 1,350,000 lekë.
- Në vitin 2015, ndryshe nga pyetësori, deklaroi se në fund të vitit kishte 1,500,000 lekë kursime cash dhe jo 1,650,000 lekë. Subjekti pretendoi se automjeti i blerë në shkurt të vitit 2015 ka pasur si burim gjendjen cash (2,300,000 lekë) nga viti i mëparshëm. Ndërkohë, në përgjigje pyetësori kishte deklaruar se nga gjendja cash e vitit paraardhës janë përdorur

vetëm 600,000 lekë, si dhe të ardhurat e vitit dhe kjo ishte marrë parasysh në analizën financiare për mundësinë e blerjes së automjetit. Gjithashtu, në shpjegimet e tij, subjekti pretendoi se këtë vit kursimet *cash* janë pakësuar edhe për pagesën e detyrimeve të kredive ekzistuese në shumën 705,000 lekë, ndërkohë që këtë gjë nuk e kishte deklaruar kurrë më parë.

- Në vitin 2016, ndryshe nga pyetësi, deklaroi se në fund të vitit kishte 2,200,000 lekë kursime *cash* dhe jo 2,350,000 lekë.

**5.21** Me pretendimet e reja që subjekti solli në përgjigje të rezultateve të hetimit, ai solli një variant të tretë të gjendjes së vlerësuar të kursimeve *cash* në fund të secilit vit. Më poshtë janë paraqitur gjendjet e kursimeve *cash* në tri mënyrat e deklaruara nga subjekti:

Viti	Gjendje <i>cash</i> (deklarimet periodike)	Gjendje <i>cash</i> (pyetësi nr. 2)	Gjendje <i>cash</i> (prapësime)
2003		0	0
2004	1,000,000	0	1,000,000
2005	2,000,000	2,000,000	2,000,000
2006	2,800,000	2,800,000	2,800,000
2007	0	0	0
2008	600,000	600,000	600,000
2009	1,300,000	0	700,000
2010	1,300,000	0	700,000
2011	2,000,000	700,000	1,400,000
2012	2,600,000	700,000	1,400,000
2013	3,000,000	850,000	1,800,000
2014	3,500,000	1,350,000	2,300,000
2015	3,800,000	1,650,000	1,500,000
2016	4,500,000	2,350,000	2,200,000

**5.22** Komisioni konstatoi se subjekti dhe personi i lidhur, në cilësinë e personit që mbart detyrimin për deklarimin e pasurive dhe interesave privatë, nuk kanë deklaruar saktë gjendjet e kursimeve *Cash* dhe/apo shtesat/pakësimet e tyre gjatë viteve si dhe në deklaratën *Vetting*.

**5.23** Gjithashtu, sipas analizës financiare të hartuar duke u bazuar në deklarimet periodike vjetore, rezultoi se në fund të vitit 2016 gjendja progresive e kursimeve *Cash* arrin në vlerën 4,500,000 lekë. Ndërkohë që, subjekti i rivlerësimit në përgjigje të rezultateve të hetimit, deklaroi se, në fund të vitit 2016 ka patur gjendje të kursimeve *Cash* vlerën prej 2,200,000 lekë. Kjo vlerë është më e madhe se vlera 1,500,000 lekë, pragu limit i shumës së lejuar për tu mbajtur e deklaruar gjendje në *cash* jashtë sistemit bankar (në shtëpi). Kjo sipas ligjit 9049/2003, i ndryshuar me ligjin nr. 45/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar”.

**5.24** I pyetur gjatë seancës dëgjimore për këtë fakt subjekti deklaroi se këtë shumë e mbante për ta përdorur në rast nevojë ekzistenciale për shkak të situatave të ndodhura (sulmeve me armë të bëra për shkak të detyrës).

**5.25** Në shqyrtimin përfundimtar të deklarimeve të bëra nga subjekti mbi shtesat/pakësimet dhe gjendjet e likuiditeteve *cash* ndër vite, Komisioni vlerësoi se ai ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë, duke mos u gjendur në kushtet e gërmës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

## 6. Detyrimet financiare

**6.1** Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar detyrime financiare: tri kredi bankare të pashlyera.

- Kredi bankare në BKT, dega Vlorë, në shumën 840,000 lekë, marrë në datën 18.11.2013, me datë maturimi 18.5.2017. Kësti mujor: 25,000 lekë. Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer deri në datën e fillimit të rivlerësimit 140.000 lekë (kjo kredi bankare është trajtuar në pikën 2 të këtij vendimi).
- Kredi bankare në BKT, dega Vlorë, në shumën 700,000 lekë, marrë në datën 10.6.2016. Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer deri në datën e fillimit të rivlerësimit 700,000 lekë.

BKT-ja vërteton dhe konfirmon se shtetasja K.T ka përfituar në datën 10.6.2016 kredi konsumatore në shumën 700,000 lekë, e siguruar me bllokim shume pranë kësaj banke. Dorëzanës i kredisë është bashkëshorti i saj, subjekti i rivlerësimit.

*Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e BKT-së.*

- Kredi bankare në Credins Bank, dega Vlorë, në shumën 500,000 lekë, marrë në datën 29.7.2016, me këst mujor 20,000 lekë. *Overdraft* në shumën 300,000 lekë në Credins Bank, marrë në datën 25.4.2016. Shuma e detyrimit financiar (kredisë dhe *overdraft*-it) që ka mbetur e pashlyer ka qenë 700,940 lekë. Credins Bank vërteton dhe konfirmon<sup>37</sup> se subjekti ka përfituar *overdraft* në shumën 300,000 lekë dhe kredi në shumën 500,000 lekë. Bashkëshortja e subjektit K.T është në cilësinë e dorëzanesës për kredinë e marrë nga subjekti.

*Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e Credins Bank.*

**6.2** Megjithatë, subjekti është pyetur në lidhje me arsyet e marrjes së këtyre kredive dhe përdorimin e tyre, i cili në përgjigje të pyetësorit<sup>38</sup> ka deklaruar se: "...kreditë e marra nga unë dhe bashkëshortja ime K.T prej vitit 2013 deri në vitin 2016 përkojnë në kohë me disa ngjarje që kanë rrezikuar rëndë integritetin tim personal dhe profesional, si dhe kanë dëmtuar drejtpërdrejt familjen time, duke krijuar vështirësi financiare për përballimin e shpenzimeve familjare. Konkretisht i referohem sulmeve të organizuara nga një bandë kriminale në qytetin e Vlorës, që për arsye presioni për shkak të detyrës, në datën 23.6.2013 kanë shkatërruar plotësisht me eksploziv automjetin tip "\*\*\*" në pronësinë time, si dhe më datën 18.11.2014 kanë goditur dhe i kanë bërë atentat djalit tim E. T, i cili qëndronte në automjet dhe është plagosur lehtë, duke i grabitur automjetin tip "\*\*\*\*" me targë AA \*\*\* në pronësinë time.

*Prokuroria e Përgjithshme, në datën 30.3.2015 ka vendosur emërimin tim në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë në një distancë prej 250 km nga vendbanimi im në qytetin e Vlorës. Pavarësisht sulmeve dhe vështirësive në kryerjen e detyrës, kam vijuar të përmbush misionin e prokurorit me përkushtim.*

*Si pasojë e rrethanave të sipërpërmendura, rrjedhimisht në periudhën 2013 – 2016 janë shtuar në mënyrë progresive shpenzimet familjare për sigurimin e transportit, qëndrimin dhe mbulimin të shpenzimeve të jetesës në tërësi. Për përballimin e këtyre shpenzimeve të shtuara, duke mos dashur të pakësonim gjendjen cash të disponueshme në rast nevojë, unë dhe bashkëshortja ime K.T kemi marrë kreditë bankare të referuara. Shumat e përfituara nga kreditë, përveç rasteve të specifikuara më poshtë, nuk janë përdorur për shpenzime të veçuara konkrete, por janë përdorur në vazhdimësi për mbulimin e shpenzimeve të jetesës, qëndrimin, transportin dhe akomodimin tim në qytetin e Korçës, si dhe shpenzimet e tjera familjare".*

<sup>37</sup> Përkatësisht me shkresat e datave 30.1.2017 dhe 1.8.2017.

<sup>38</sup> Shihni përgjigjen e pyetësorit nr. \*\*\*.

**6.3** Në përfundim të hetimit, Komisioni arriti në konkluzionin se nuk u konstatuan problematika lidhur me detyrimet e deklaruara nga subjekti.

## **ÇËSHTJE TË TJERA**

### **7. Automjet tip “\*\*\*\*”, blerë në vitin 2010**

**7.1** Në DPV-në e vitit 2010, subjekti deklaroi: *“Kursime familjare me burim pagat e deklaruesit dhe të bashkëshortes – 850,000 (tetëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, të konvertuara në 6,500 euro. Nga këto kursime, në datën 12.8.2010 është krijuar një depozitë në ProCredit Bank me afat 3 mujor – 5,000 euro. Këto kursime në muajin mars të vitit 2010 janë pakësuar për blerjen e një automjeti tip “\*\*\*\*” me targë VL \*\*\* – 1,200 euro”.*

**7.2** Në DPV-në e vitit 2013, subjekti deklaroi: *“...Qëllimi i kredisë blerje automjeti pas shkatërrimit me eksploziv të automjetit të deklaruar në deklaratimet e mëparshme. Automjeti i mëparshëm i tipit “\*\*\*\*” është shkatërruar me eksploziv në datën 23.6.2013”.*

**7.3** Subjekti, lidhur me këtë pasuri, ka paraqitur pranë ILDKPKI-së<sup>39</sup>:

- vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2013, nga Drejtoria e Policisë Qarku Vlorë, me anë të të cilit vërtetohet se është shpërthyer nëpërmjet eksplozivit të detonuar me fitil automjeti tip “\*\*\*\*” me targë VL \*\*\*\* , në pronësi të shtetasit Dorjan Tafilaj;
- vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2014, nga DRSHTRR-ja Vlorë, me të cilin vërtetohet se automjeti tip “\*\*\*\*”, me targë VL \*\*\* , është hequr nga qarkullimi përfundimisht në datën 28.1.2014.

**7.4** DPSHTRR-ja, me shkresat nr. \*\*\* prot., datë 17.7.2017 dhe nr. \*\*\* prot., datë 28.2.2019, drejtuar ILDKPKI-së, informon se z. Dorjan D Tafilaj ka pasur në pronësi mjetin me targë VL \*\*\* dhe aktualisht e ka me statusin e çregjistrimit të përhershëm, me datë veprimi 28.1.2014.

**7.5** DPSHTRR-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 1.10.2021, drejtuar Komisionit, informon se z. Dorjan D Tafilaj ka pasur të regjistruar automjetin me targë VL \*\*\* . Nga dosja e mjetit rezultoi një kontratë shitblerjeje me nr. \*\*\* rep., datë 2.3.2010, e përkthyer dhe noterizuar nga noteri Y.M. Në këtë kontratë, pala shitëse është \*\*\*, H/Gjermani dhe pala blerëse është subjekti Dorian Tafili, Vlorë, Shqipëri. Bëhet fjalë për automjetin tip “\*\*\*\*” me çmim blerjeje 1,200 euro. Mjeti është zhdoganuar nga importuesi individual, shtetasi E. B., në janar të vitit 2009.

**7.6** Lidhur me burimin e krijimit të pasurisë, subjekti ka deklaruar në DPV-në e vitit 2010 se si burim i blerjes së automjetit kanë shërbyer kursimet familjare me burim pagat e deklaruesit dhe të bashkëshortes.

**7.7** Komisioni analizoi mundësinë e subjektit dhe të bashkëshortes për krijimin e kësaj pasurie në vlerën 1,200 euro me të ardhurat e vitit 2010 deri në datën e kontratës së shitblerjes 2.3.2010. Nga analiza financiare rezultoi se subjekti dhe bashkëshortja nuk kishin të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e automjetit tip “\*\*\*\*” në vlerën 1,200 euro, në datën 2.3.2010, si dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës, duke rezultuar në një pamundësi financiare në vlerën -30,527 lekë.

**7.8** Në përfundim të hetimit, Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti dhe bashkëshortja e tij kishin pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme për blerjen e pasurisë automjet tip “\*\*\*\*” në vitin 2010 dhe mbulimin e shpenzimeve të periudhës në vlerën -30,527 lekë.

---

<sup>39</sup> Shihni dosjen e ILDKPKI-së.

**7.9** Sa më sipër, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat e tij për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga ana e Komisionit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

**7.10** Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit për paraqitjen e argumenteve të nevojshme për mundësinë financiare të ligjshme për blerjen e këtij automjeti në vitin 2010 është trajtuar në pikat 4.14 dhe 4.15 të këtij vendimi.

**7.11** Komisioni hartoi edhe një herë analizën financiare pas rishikimit të të ardhurave totale<sup>40</sup> për të parë mundësinë e subjektit për krijimin e depozitës në vlerën 5,000 euro pranë ProCredit Bank, në datën 12.3.2010, si më poshtë:

**Analiza e mundësisë së blerjes së automjetit tip “\*\*\*\*”, me targë VL \*\*\*, në vlerën 1,200 euro, në vitin 2010.**

<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera</b>
Të ardhura subjekti 1.1.2010 – 2.3.2010	204,678
Të ardhura bashkëshortja e subjektit 1.1.2010 – 2.3.2010	68,957
<b>Të ardhura totale 1.1.2010 – 2.3.2010</b>	<b>273,635</b>
Shpenzime jetese 1.1.2010 – 2.3.2010	91,080
Shpenzime arsimimi fëmijët 1.1.2010 – 2.3.2010	20,000
<b>Shpenzime totale 1.1.2010 – 2.3.2010</b>	<b>111,080</b>
Blerje automjet tip “****” VL *** D – 1,200 euro, datë 2.3.2010	166,572
Ndryshim likuiditeti 31.12.2009 – 2.3.2010	52,610
<b>Pamundësia financiare</b>	<b>-56,627</b>

**7.12** Nga analiza financiare rezulton se subjekti dhe bashkëshortja e tij nuk kishin burime të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e automjetit tip “\*\*\*\*” në datën 2.3.2010, shtimin e likuiditeteve, si dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës, duke rezultuar me një pamundësi financiare në vlerën -56,627 lekë.

**7.13** Komisioni vlerësoi se subjekti në shpjegimet e tij nuk arriti të përmbyste barrën e provës së lënë në rezultatet e hetimit, për shkak se: (a) në DPV-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar shumë qartë që automjeti tip “\*\*\*\*” në vlerën 1,200 euro ka si burim kursimet familjare me burim pagat e deklaruesit dhe të bashkëshortes; (b) në DPV-në e vitit 2010, subjekti nuk e deklaroi pakësimin e gjendjes *cash* si burim për blerjen e automjetit tip “\*\*\*\*”; (c) të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortes deri në datën 2.3.2010 janë të pamjaftueshme për blerjen e automjetit, shtimin e likuiditeteve dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës.

**7.14** Sa më sipër, Komisioni vlerësoi se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë.

## **8. Në lidhje me adresat e deklaruara të subjektit të rivlerësimit**

**8.1** Subjektit i është kërkuar të vërtetojë me dokumentacion adresat e banimit në të cilat ka qenë i regjistruar pranë Drejtorisë së Gjendjes Civile për periudhën 2000 – 2016.

**8.2** Lidhur me adresat e banimit për periudhën 2000 – 2016, në përgjigje të pyetësorit nr. \*\*\*, subjekti ka sqaruar se ka paraqitur pranë Komisionit shpjegimet e veta të dokumentuara tërësore nëpërmjet përgjigjes së pyetësorit standard, përkatësisht përgjigjen e pyetjes nr. \*\*\*, dorëzuar në datën 19.2.2021 pranë Komisionit, së bashku me dokumentacionin provues.

<sup>40</sup> Shihni trajtimin e çështjes së të ardhurave nga KEMP në pikën 9 të këtij vendimi.

**8.3** Për dokumentimin e mëtejshëm të adresave të banimit të tij dhe të familjes, subjekti i është drejtuar Zyrës së Gjendjes Civile Vlorë, institucion i cili ka lëshuar certifikatat familjare për vitet 1975, 2001, 2003, 2004 dhe 2005.

**8.4** Subjekti ka deklaruar se, për sa është në dijeninë e tij, duke qenë se ka kaluar një kohë e gjatë nga data e ndryshimit të vendbanimit, adresat e vendbanimit janë deklaruar pranë Zyrës së Gjendjes Civile Vlorë dhe ndryshimi i vendbanimit është pasqyruar në Regjistrin Themeltar në mënyrë të standardizuar sipas procedurës administrative përkatëse të Gjendjes Civile<sup>41</sup>.

**8.5** Gjithashtu, Komisioni i është drejtuar<sup>42</sup> edhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, ku i ka kërkuar kopje të dokumentacionit që lidhet me regjistrimin e adresave të subjektit të rivlerësimit. Në përgjigjen<sup>43</sup> e saj, DPGJC-ja ka informuar se shtetasi Dorjan Tafilaj rezultoi i regjistruar banor në Bashkinë Vlorë, Rajoni nr. \*\*\*. Për periudhën e kërkuar, 2000 – 2016, të dhënat e vendbanimit për shtetasin Dorjan Tafilaj rezultojnë: Lagjja “\*\*\*”, Vlorë. DPGJC-ja ka vënë në dispozicion fletë të regjistrave themeltarë të regjistrimit të popullsisë së viteve 1974, sipas referencave përkatëse.

**8.6** Ndërsa subjekti është pyetur<sup>44</sup> edhe për mospasjen e konfliktit të interesit me qiradhënësit ku ai ka jetuar përgjatë viteve 2000 – 2004 dhe 2004 – 2008, përkatësisht shtetasit V.A dhe A. Ll.R. Në përgjigje të pyetësorit nr. \*\*\*, subjekti ka deklaruar<sup>45</sup> se gjatë ushtrimit të detyrës si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë nuk ka pasur asnjë çështje në hetim me palë shtetasit A.Ll.R dhe V.A.

**8.7** Sa më sipër, nuk u konstatuan problematika në lidhje me adresat e deklaruara të subjektit ndër vite.

## **9. Analiza financiare**

**9.1** Analiza financiare është e ndarë në dy pjesë. Pjesa e parë përfshin periudhën 1998 – 2003, e cila është bërë në bllok për subjektin për shkak se ai ka deklaruar për herë të parë në vitin 2003 pranë ILDKPKI-së. Të ardhurat e para të dokumentuara për subjektin janë në vitin 1998 nga puna e tij si oficer i policisë gjyqësore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

**9.2** Pjesa tjetër e analizës është bërë për periudhën 2004 – 2016, në të cilën subjekti është deklarues pranë ILDKPKI-së, prandaj edhe analiza financiare është bërë vit pas viti për këtë hark kohor.

**9.3** Në përfundim të hetimit administrativ, nga analiza financiare rezultoi se subjekti dhe bashkëshortja kishin një pamundësi financiare totale prej -3,971,988 lekësh për periudhën 1998 – 2016.

**9.4** Për sa më sipër, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat e tij për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga ana e Komisionit lidhur me analizën financiare, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

## **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**9.5** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti kundërshtoi analizën financiare lidhur me rezultatin financiar të periudhës 1998 – 2003. Ai pretendoi se burim për depozitat e krijuara në këtë periudhë ka qenë edhe shuma 1,500,000 lekë, dhënë nga babai i tij deri në vitin 2003.

<sup>41</sup> Bashkëlidhur subjekti ka sjellë certifikatat familjare, të lëshuara në datën 19.9.2023 nga Zyra e Gjendjes Civile Vlorë. Gjendja familjare më 9.1.1975; gjendja familjare më 27.4.2001; gjendja familjare më 14.7.2003; gjendja familjare më 20.2.2004; gjendja familjare më 11.2.2005.

<sup>42</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.9.2023.

<sup>43</sup> Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 21.9.2023.

<sup>44</sup> Në pyetësorin nr. \*\*\* subjektit i është kërkuar dokumentacion provues për mospasjen e konfliktit me qiradhënësit.

<sup>45</sup> Shihni përgjigjen e pyetësorit nr. \*\*\* dhe shkresën bashkëlidhur, me lëndë “Kthim përgjigjeje”, me nr. \*\*\* prot., datë 7.6.2023, dërguar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në vijim të kërkesës për verifikim, drejtuar kësaj Prokurorie.

Komisioni nuk e gjeti të bazuar pretendimin e subjektit dhe nuk përfshiu tek të ardhurat e kësaj periudhe vlerën 1,500,000 lekë, për shkak se ky ishte një pretendim i paraqitur vetëm në përgjigje të rezultateve të hetimit. Subjekti gjatë hetimit administrativ ishte përgjigjur se burim i këtyre depozitave kanë qenë të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes të deklaruara më parë në deklaratimet periodike (kjo çështje është trajtuar edhe më sipër në pikën 1 të këtij vendimi).

**9.6** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti pretendoi se vetëm depozita në vlerën 660,000 lekë ka qenë e krijuar me të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes dhe mbyllja e saj në vitin 2004 ka shërbyer për shtimin e kursimeve *cash* në këtë vit. Gjithashtu, ai pretendoi se depozita e krijuar tek Intesa Sanpaolo Bank është mbyllur në vitin 2004 dhe jo në vitin 2005.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**9.7** Me këtë pretendim, subjekti bie në kundërshtim me deklaratimet e tij në përgjigje të pyetësorit, për faktin se ai e mohonte ekzistencën e kursimeve *cash* në vitin 2004. Ndërkohë në parashtrime përpiket të arsyejojë dhe shpjegojë burimet e krijimit të këtyre kursimeve në vitin 2004. Gjithashtu, ai bie në kundërshtim me deklaratimet e tij në përgjigje të pyetësorit edhe lidhur me kohën e mbylljes së depozitës tek Intesa Sanpaolo Bank. Ndryshe nga pyetësi, në parashtrime tashmë ai pretendon mbylljen e saj në vitin 2004 në mënyrë që të sigurojë burime për shtimin e kursimeve *cash* në këtë vit. Sidoqoftë, varianti hipotetik i mbylljes së depozitës tek Intesa Sanpaolo Bank në vitin 2004 do të rëndonte situatën financiare të subjektit (kjo çështje është trajtuar edhe më sipër në pikën 1 të këtij vendimi).

**9.8** Sa më sipër, Komisioni i gjeti të pabazuar këto pretendime të subjektit dhe nuk i bëri ato pjesë të analizës financiare.

**9.9** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti pretendoi se për shkak të bashkëjetesës me prindërit e tij për periudhën nëntor 2004 – nëntor 2007 duhet t'i zbriteshin shpenzimet e jetesës për zërin e ushqimeve dhe pijeve joalkoolike. Sipas tij, këto shpenzime i ishin mbuluar në atë kohë nga prindërit dhe, për këtë arsye, duhet t'i zbriten në analizën financiare.

**9.10** Subjekti nuk kishte pretenduar më parë zbritjen e këtyre shpenzimeve dhe as ndonjë ndihmë financiare nga prindërit gjatë bashkëjetesës me ta, prandaj Komisioni vlerëson të mos ndryshojë standardin e të këtyre shpenzimeve sipas ILDKPKI-së.

**9.11** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti pretendoi zbritjen e shpenzimeve të udhëtimit për disa udhëtime për të dhe bashkëshorten, të cilat sipas tij janë mbuluar nga organizatorët. Këtë pretendim subjekti nuk e provon me dokumentacion, prandaj Komisioni nuk e reflektoi atë në analizën financiare.

**9.12** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka ndryshuar qëndrimin e tij lidhur me gjendjen dhe ndryshimet e kursimeve *cash* ndër vite<sup>46</sup>. Deklarimet e tij në kohë janë kontradiktore dhe jo bindëse. Në këtë mënyrë, ai përpiket të rregullojë rezultatin financiar të disa viteve apo të justifikojë krijimin e disa pasurive (apartament, depozita dhe automjete).

**9.13** Referuar edhe qëndrimit të Kolegjit<sup>47</sup>, Komisioni vlerësoi se pretendimet e reja në lidhje me gjendjen *cash*, të ndryshuara nga të mëparshmet, nuk mund konsiderohen dhe të reflektohen në analizën financiare. Gjendja e likuiditeteve *cash* apo kursimet e shtuara/pakësuara kësaj gjendjeje mund të provohen vetëm nëpërmjet deklaratave periodike vjetore të kohës, si të vetmet dokumente që mund ta provojnë atë, kjo referuar përcaktimeve të ligjit nr. 9049/2003 dhe formularit të deklaratimit të interesave privatë.

**9.14** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti pretendoi se për shkak të mosdhënies nga shteti të ndonjë dëmshpërblimi për atentatet që i janë bërë atij dhe pasurisë së tij (automjete)

<sup>46</sup> Shihni pikën 5 të këtij vendimi.

<sup>47</sup> Shihni vendimin nr. 9, datë 15.3.2023, të Kolegjit.



në vitet 2013 dhe 2014, nuk duhej që kostoja e automjeteve të përfshihej në analizën financiare të këtyre viteve.

**9.15** Komisioni vlerëson se ky pretendim i subjektit është i pabazuar për shkak se, pavarësisht ngjarjeve të ndodhura në dëm të subjektit, në të vërtetë ai i ka krijuar ato pasuri duke shpenzuar për to dhe këto shpenzime/investime nuk mund të mos jenë pjesë e analizës financiare të viteve përkatëse.

**9.16** Në analizën financiare të rezultateve të hetimit ishin përfshirë të ardhurat e pretenduara nga Komisioni Epror Mjekësor Parësor (KEMP) për vitet 2003 – 2013 nga djali i subjektit, sipas vërtetimit nga Bashkia Vlorë, të sjellë nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. \*\*\*. Këto të ardhura u morën me rezervë ligjore në analizën financiare si të ardhura të ligjshme, pavarësisht se dokumentacioni vërtetues nuk ishte në formën e kërkuar nga ligji, për shkak të mungesës së nënshkrimit nga ana e titullarit të institucionit. Për këtë fakt, subjektit të rivlerësimit iu kërkua që në përgjigje të rezultateve të hetimit ta sjellë këtë vërtetim në formën e kërkuar nga ligji.

**9.17** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti nuk e solli dokumentin - vërtetim në formën e kërkuar nga ligji e, për këtë arsye, Komisioni përfundimisht nuk bëri pjesë të analizës financiare të ardhurat e pretenduara nga Komisioni Epror Mjekësor Parësor (KEMP) për vitet 2003 – 2013. Në analizën financiare u përfshi si e ardhur vetëm vlera e vitit 2014, e cila vërtetohet si e përfituar nga *statementi* bankar tek Intesa Sanpaolo Bank.

**9.18** Komisioni hartoi edhe një herë analizën financiare pas rishikimit të të ardhurave totale të periudhës 1998 – 2016<sup>48</sup>, paraqitur në tabelën si më poshtë:

---

<sup>48</sup> Shihni trajtimin e çështjes së të ardhurave nga KEMP në pikat 9.15 dhe 9.16 të këtij vendimi.

SUBJEKTI I RIVLERESIMIT: DORJAN D. TAFILAJ																
PERSHKRIMI	1998 - 2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	TOTAL	
<b>PASURI</b>	<b>2,602,342</b>	<b>-453,489</b>	<b>-137,728</b>	<b>832,139</b>	<b>1,180,126</b>	<b>607,050</b>	<b>1,360,299</b>	<b>971,139</b>	<b>717,544</b>	<b>1,191,997</b>	<b>1,144,689</b>	<b>485,422</b>	<b>1,015,982</b>	<b>207,478</b>	<b>5,694,822</b>	
Apartament 86 m2, L. ****, Vlore - 4,000,000 leke - 50% - 2007					4,000,000										4,000,000	
Automjet Volkswagen Golf **** - 1,200€ - 2010								166,572							166,572	
Automjet Mercedes Benz **** - 6,000 € - 50% - 2013											840,000				840,000	
Automjet Ford Focus **** - 5,000 € - 50% - 2015													688,250		688,250	
<b>Ndryshim ne likuiditet</b>	<b>2,602,342</b>	<b>-453,489</b>	<b>-137,728</b>	<b>832,139</b>	<b>-2,819,874</b>	<b>607,050</b>	<b>1,360,299</b>	<b>804,567</b>	<b>717,544</b>	<b>1,191,997</b>	<b>304,689</b>	<b>485,422</b>	<b>327,732</b>	<b>207,478</b>		
<b>DETYRIME</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>820,000</b>	<b>465,000</b>	<b>-544,999</b>	<b>537,961</b>	<b>1,277,961</b>	
Kredi BKT - 840,000 leke - 2013 - b/shortja											820,000	-240,000	-239,999	-180,000	160,001	
Kredi BKT - 105,000 leke - 2014 - b/shortja												105,000	-105,000		0	
Kredi BKT - 100,000 leke - 2014 - b/shortja												100,000	-100,000		0	
Kredi BKT - 500,000 leke - 2014 - b/shortja												500,000	-500,000		0	
Kredi BKT - 400,000 leke - 2015 - b/shortja													400,000	-400,000	0	
Kredi BKT - 700,000 leke - 2016 - b/shortja														700,000	700,000	
Kredi Credins Bank - 500,000 leke - 2016 - subjekti														417,961	417,961	
<b>PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)</b>	<b>2,602,342</b>	<b>-453,489</b>	<b>-137,728</b>	<b>832,139</b>	<b>1,180,126</b>	<b>607,050</b>	<b>1,360,299</b>	<b>971,139</b>	<b>717,544</b>	<b>1,191,997</b>	<b>324,689</b>	<b>20,422</b>	<b>1,560,981</b>	<b>-330,483</b>	<b>4,416,861</b>	
<b>TE ARDHURA dokumentuar</b>	<b>2,970,971</b>	<b>1,118,135</b>	<b>1,248,843</b>	<b>1,206,346</b>	<b>1,998,265</b>	<b>1,544,735</b>	<b>1,596,758</b>	<b>1,566,753</b>	<b>1,514,391</b>	<b>1,436,260</b>	<b>1,670,594</b>	<b>1,821,254</b>	<b>1,828,304</b>	<b>2,543,650</b>	<b>24,065,259</b>	
Te ardhura nga puna subjekti	2,970,971	896,675	962,247	943,978	957,214	1,196,880	1,234,024	1,194,246	1,134,639	1,044,780	1,237,362	1,200,863	1,344,155	1,098,970	17,417,004	
Te ardhura nga puna bashkeshortja		221,460	286,596	262,368	293,781	347,855	362,734	372,507	379,752	391,480	433,232	464,391	484,149	1,444,680	5,744,985	
Te ardhura nga KEMP djali i subjektit												156,000			156,000	
Te ardhura nga dhurimi i vellait te subjektit - 9,000\$ - 2007					747,270										747,270	
<b>SHPENZIME</b>	<b>1,915,747</b>	<b>1,925,257</b>	<b>500,814</b>	<b>561,413</b>	<b>657,480</b>	<b>774,621</b>	<b>968,978</b>	<b>706,480</b>	<b>761,480</b>	<b>870,692</b>	<b>723,786</b>	<b>1,240,461</b>	<b>1,257,439</b>	<b>1,293,087</b>	<b>14,157,736</b>	
Shpenzime jetese	1,639,747	281,892	328,671	438,228	546,480	546,480	546,480	546,480	546,480	558,192	564,096	879,992	897,104	940,368	9,260,690	
Shpenzime qiraje , Vlore	276,000	72,000	72,000	72,000	66,000										558,000	
Shpenzime interesi dhe komisione per kredi Credins Bank - 2016														19,237	19,237	
Shpenzime interesi dhe komisione per kredi BKT											4,690	58,119	45,390	28,522	136,720	
Shpenzime arsimimi per femijet		18,000	45,000	45,000	45,000	43,000	64,000	100,000	100,000	118,000	155,000	166,000	136,000	80,000	1,115,000	
Shpenzime mobilimi						110,000	150,000	60,000	115,000	45,000					480,000	
Shpenzime mjekesore												136,350			136,350	
Shpenzuar shuma e tehequr nga mbyllja e depozitave ne 2004		1,553,365													1,553,365	
Shpenzim per likuidim detyrimi shtetasit B. L. - 2016														207,375	207,375	
Shpenzime udhetimi		0	55,143	6,185	0	75,141	208,498	0	0	149,500	0	0	178,945	17,585	690,998	
<b>Analiza dokumentuar</b>	<b>-1,547,118</b>	<b>-353,634</b>	<b>885,757</b>	<b>-187,206</b>	<b>160,659</b>	<b>163,064</b>	<b>-732,519</b>	<b>-110,866</b>	<b>35,367</b>	<b>-626,429</b>	<b>622,119</b>	<b>560,371</b>	<b>-990,116</b>	<b>1,581,045</b>	<b>1,007,612</b>	
															<b>Pamundesia financiare totale</b>	<b>-4,547,888</b>
<b>Gjendje CASH (sipas deklarimeve periodike)</b>	<b>0</b>	<b>1,000,000</b>	<b>2,000,000</b>	<b>2,800,000</b>	<b>0</b>	<b>600,000</b>	<b>1,300,000</b>	<b>1,300,000</b>	<b>2,000,000</b>	<b>2,600,000</b>	<b>3,000,000</b>	<b>3,500,000</b>	<b>3,800,000</b>	<b>4,500,000</b>		
<b>LIKUIDITETE NË FUND TË VITIT</b>	<b>2,602,342</b>	<b>2,148,854</b>	<b>2,011,126</b>	<b>2,843,265</b>	<b>23,391</b>	<b>630,441</b>	<b>1,990,739</b>	<b>2,795,306</b>	<b>3,512,851</b>	<b>4,704,848</b>	<b>5,009,537</b>	<b>5,494,959</b>	<b>5,822,690</b>	<b>6,030,168</b>		

**9.19** Nga analiza financiare rezultoi se subjekti dhe bashkëshortja i tij kanë pamundësi financiare totale prej -4,547,888 lekësh për shtimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, shtimin e likuiditeteve, si dhe mbulimin e shpenzimeve për periudhën e rivlerësimit.

## **10. METODOLOGJIA**

### **Metodologjia e përdorur nga Komisioni për analizën financiare**

**10.1** Gjatë kësaj analize, Komisioni është bazuar në:

**a. Gjendjet e likuiditeteve** të subjektit dhe bashkëshortes, të nxjerra nga dokumentet bankare të kërkuara nga BKT, Raiffeisen Bank, Credins Bank, Tirana Bank, Intesa Sanpaolo Bank, Alpha Bank, ProCredit Bank, si dhe gjendjet *cash* të deklaruara nga subjekti.

#### **b. Të ardhurat e ligjshme, ku përfshihen:**

- i) të ardhurat nga pagat e subjektit si OPGJ në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë (1998 – 2000), prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë (2000 – 2015), prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë (2015 – 2016), si dhe prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier (2016);
- ii) të ardhurat nga paga e bashkëshortes së subjektit tek Bashkia Vlorë (2004 – 2016), shoqëria “\*\*\*\*” (2015 – 2016), si dhe të ardhura nga aktiviteti privat si person fizik “\*\*\*\*” (2016);
- iii) të ardhura nga huadhënia/dhurimi i bërë subjektit nga vëllai i tij për blerjen e apartamentit (2007).

#### **c. Shpenzimet, ku përfshihen:**

- i) Shpenzimet e jetesës bazuar në shpenzimet mujore për konsum sipas madhësisë së familjes, (anketa e buxhetit të familjes nga INSTAT);
- ii) Shpenzimet për shkollimin e fëmijëve sipas deklaramit të subjektit në përgjigje të pyetësorit dhe dokumenteve provuese të institucioneve arsimore;
- iii) Shpenzimet e interesit dhe komisione, si dhe për shlyerje principali për kreditë e marra në BKT dhe Credins Bank sipas vërtetimeve dhe *statement*-eve bankare përkatëse (2013 – 2016);
- iv) Shpenzimet e qirasë në qytetin e Vlorës sipas deklaramit të subjektit në përgjigje të pyetësorit standard (2000 – 2007);
- v) Shpenzimet e mobilimit sipas deklaramit të subjektit në përgjigje të pyetësorit (2008 – 2012);
- vi) Shpenzimet mjekësore sipas deklaramit të subjektit në përgjigje të pyetësorit dhe dokumenteve provuese (2014);
- vii) Shpenzimi i shumës së tërhequr nga mbyllja e llogarive të depozitave në vitin 2004. Nga depozitat ekzistuese në fund të vitit 2003 janë mbyllur në vitin 2004 depozita në vlerë totale 1,553,365 lekë. Kjo vlerë është përfshirë si shpenzim në analizën financiare, meqë edhe pasi u pyet subjekti, ai nuk u përgjigj për çfarë u përdorën vlerat e tërhequra. Gjithashtu, ai nuk e deklaroi këtë vlerë si burim për shtim pasurie të luajtshme/të paluajtshme apo shtim likuiditeti tjetër (*cash*/bankë). Edhe në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti pretendon se nuk e ka përdorur vlerën e tërhequr nga depozitat për shpenzimet e jetesës;
- viii) Shpenzimet e udhëtimit për të cilat janë marrë të dhëna nga sistemi TIMS. Për përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit është zbatuar vendimi nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019, i Kolegjit të Posaçëm të Apelit. Nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet e udhëtimit kur subjekti/bashkëshorti ka deklaruar e dokumentuar udhëtime për qëllime pune dhe ato për të cilat është dokumentuar qëndrim pranë njerëzve të afërm;

- ix) Shpenzimet e qirasë në Vlorë (1999 – 2010) sipas deklarimit të subjektit në përgjigje të pyetësorit standard;
- x) Shpenzimet për blerje pjesë këmbimi automjeti (2016) sipas deklarimit të subjektit në përgjigje të pyetësorit nr. \*\*\*.

**ç. Vlerat e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, bazuar në kontratat e sipërmarrjeve/shitblerjeve të këtyre pasurive<sup>49</sup>**

**Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit**

**11.** Në fund të procesit të rivlerësimit, rezultoi se subjekti dhe personat e tij të lidhur kishin një pamundësi financiare totale në vlerën -4,547,888 lekë për periudhën 1998 – 2016, si dhe ishin në pamundësi financiare për:

- krijimin e depozitave deri në vitin 2003, me një pamundësi financiare në vlerën -1,553,365 lekë;
- krijimin e pasurisë apartament në Vlorë në vitin 2007, me një pamundësi financiare në vlerën -440,963 lekë;
- krijimin e pasurisë automjet tip “\*\*\*\*” në vitin 2010, me një pamundësi financiare në vlerën -56,627 lekë;
- krijimin e pasurisë automjet tip “\*\*\*\*” në vitin 2015, me një pamundësi financiare në vlerën -282,832 lekë;
- krijimin dhe shtesat e depozitave në vitet 2009, 2010 dhe 2012, me një pamundësi financiare totale në vlerën -653,317 lekë.

**11.1** Referuar analizës financiare, Komisioni, në vlerësimin e çështjes në lidhje me kriterin e pasurisë, bazuar në prova, fakte dhe bindjen e brendshme, çmoi se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm dhe të pasaktë për pasuritë e krijuara, si dhe nuk justifikoi me burime të ligjshme krijimin e tyre, duke u gjendur në kushtet e përcaktuara të shkronjave “a” dhe “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

**B. KONTROLLI I FIGURËS**

**12.** Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK), institucioni kompetent për kontrollin e figurës, pas verifikimit të deklarimeve të subjektit dhe të dhënave të tjera, me qëllim përcaktimin nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me krimin e organizuar, në përmbushje të ushtrimit të funksioneve sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, i ndryshuar, pasi ka kryer të gjitha procedurat për kontrollin në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 4 dhe neneve 37 dhe 38 të ligjit nr. 84/2016, ka paraqitur pranë Komisionit raportin përfundimtar (klasifikuar “Sekret”) me nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, ku rezulton se:

- Formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në përputhje me ligjin nr. 84/2016.
- Subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës.
- Për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose persona të dyshuar të kimit të organizuar.
- Konstatohet se subjekti i rivlerësimit Dorjan Tafilaj është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

<sup>49</sup> Shihni kontratat e shitjeve për pasuritë e paluajtshme, në dosjen e ILDKPKI-së.

- Për pastërtinë e figurës, nuk ka pasur të dhëna e dyshime bazuar në raportin e AKSIK-së.

**12.1** Komisioni i kërkoi<sup>50</sup> AKSIK-së përditësimin dhe deklasifikimin e raportit të figurës për subjektin e rivlerësimit.

**12.2** AKSIK-ja ka përcjellë njoftimin<sup>51</sup>, ku vendosi<sup>52</sup> të deklasifikojë pjesërisht raportin e përcjellë<sup>53</sup> në Komision dhe me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 6.11.2023, ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Dorjan Tafilaj, në të cilin citohet: *“Gjatë periudhës në të cilën z. Tafilaj ushtronte detyrën si prokuror, dyshohet se ka ushtruar ndikim të paligjshëm në një çështje penale. Institucionet verifikuese e kanë përmendur z. Tafilaj në një informacion që i është përcjellë Prokurorisë së Përgjithshme. Në lidhje me këtë rast, i është kërkuar informacion Prokurorisë së Përgjithshme, për të cilën nuk ka akoma përgjigje. Institucionet verifikuese e kanë përmendur z. Dorjan D. Tafilaj edhe në një informacion tjetër të vitit 2007.*

*Në vlerësim të të dhënave që disponohen për subjektin e rivlerësimit rezulton se:*

*1. Situata pasqyron korrupsionin në vetë sistemin e drejtësisë, ku për rastin në fjalë disponohen informacione për përfshirje në veprime korruptive të një prokurori. Kjo veprimtari e paligjshme i përmbahet përcaktimit të pikës 8 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, ku përfshihen veprat penale të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale “Krimi i organizuar, trafikimi dhe korrupsioni”.*

*2. Bazuar në nenin 38 të ligjit nr. 84/2016, ligjvënësi i është referuar kontakteve të papërshtatshme që mund të ketë subjekti i rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Nisur nga qëllimi dhe fryma e ligjit, ku procesi i rivlerësimit përfshin kontrollin tërësor të prokurorëve dhe gjyqtarëve, duke filluar nga vetë subjekti e më pas duke zbuluar ose identifikuar lidhjet e subjektit me krimin e organizuar, më së pari subjekti i rivlerësimit është vetë subjekt i kontrollit të ligjit dhe i përfshirjes ose jo në krimin e organizuar.*

*3. Si rrethanë lehtësuese, bazuar në parashikimet e bëra në aneksin “Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe i prokurorëve”, neni DH “Kontrolli i figurës”, pika 2, që përcakton si periudhë të rivlerësimit për kontrollin e figurës datën 1.1.2012, mund të merret parasysh fakti se të dhënat e sipërcituara si veprimtaria e dyshuar si korrupsion dhe abuzim me detyrën nga subjekti i rivlerësimit i përket një periudhe përpara këtij afati.*

*4. Në këndvështrimin e përgjithshëm të kontrollit të pastërtisë së figurës së një subjekti rivlerësimi, në rastin tonë, në cilësinë e prokurorit, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier, çdo dyshim i arsyeshëm për kryerje ose moskryerje të veprimeve në kundërshtim me ligjin, në mospërmbyllje të rregullt të detyrës dhe kur këto veprime ose mosveprime sjellin përfitime materiale ose jomateriale, të padrejta për atë vetë si funksionar publik, apo për persona të lidhur me të, duke dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit apo të personave të tjerë, vlerësojmë se cenohet pastërtia e figurës së subjektit në fjalë dhe shkalla e besueshmërisë së tij.*

*Në përfundim, Grupi i Punës, nisur nga të dhënat e siguruara nga autoritetet verifikuese, ndryshon konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit, nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës në papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit Dorjan D Tafilaj”.*

<sup>50</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.5.2023.

<sup>51</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.11.2023.

<sup>52</sup> Me vendimin nr. \*\*\*, datë 7.11.2023, të KDZH-së.

<sup>53</sup> Raportin e GP-së nr. \*\*\*, datë 6.11.2017, me lëndë “Dërgohet raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit z. Dorjan Tafilaj”, klasifikuar “Sekret”.

**12.3** Pavarësisht sa më sipër, Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetit të subjektit të rivlerësimit, përfshirë edhe verifikimin e informacioneve të dërguara nga agjencitë ligjzbatuese.

**12.4** Në përfundim të hetimit administrativ, referuar vlerësimit fillestar, si dhe atij të deklasifikuar të vitit 2023, Komisioni arriti në konkluzionin se për subjektin Dorjan Tafilaj nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

**12.5** Subjekti i rivlerësimit është i përshtatshëm për vijimin e ushtrimit të detyrës së tij si prokuror.

### **Vlerësimi përfundimtar i Komisionit për kontrollin e figurës**

**13.** Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit, z. Dorjan Tafilaj, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

## **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

**14.** Raporti për vlerësimin e aftësive profesionale është përgatitur bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**14.1** Ky raport i ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit:

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;
- c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale;
- ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

**14.2** Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e formularit të vetëdeklarimit, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti, pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të dhënave nga burimet arkivore.

**14.3** Subjekti i rivlerësimit, për 10 vitet e fundit, rezulton se:

- Në periudhën shkurt 2000 – mars 2015 ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë (përfshirë pozicionin e drejtuesit të komanduar dhe zv/drejtuesit).
- Në periudhën mars 2015 – nëntor 2016 ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.
- Në periudhën nëntor 2016 e në vazhdim ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

### **15. Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit**

**Dokumenti nr. 1** – Akti ligjor “Kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. \*\*\*/\*\*\*”, me të pandehur A. A., akuzuar për kryerje të veprave penale “Vrasje me paramendim”, mbetur në tentativë dhe “Mbajtje pa leje e armëve luftarake në mjedise publike”, të parashikuara nga nenet 78/1-22 e 278/5 të Kodit Penal.

**Dokumenti nr. 2** – Diskutimi përfundimtar në përfundim të gjykimit të çështjes penale, me të pandehur K. Gj., akuzuar për veprat penale “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor me

pasojë vdekjen e një personi”, “Drejtimit i mjetit në gjendje të dehur” dhe “Largim nga vendi i aksidentit”, të parashikuara nga nenet 290/3, 291 e 273 të Kodit Penal.

**Dokumenti nr. 3** – Vendim pushimi i procedimit penal nr. \*\*\*/\*\*\* i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në ngarkim të shtetasit E. A.

## **16. Përshkrimi i 5 dosjeve penale të përzgjedhura me short**

**Dosja nr. 1** – Kallëzimi penal nr. \*\*\*/\*\*\* i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me datë vendimi 7.1.2014.

**Dosja nr. 2** – Procedimi penal nr. \*\*\*/\*\*\* i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, regjistruar për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal. Akti ligjor “Vendim për pushimin e procedimit penal”, datë 17.7.2014.

**Dosja nr. 3** – Procedimi penal nr. \*\*\*/\*\*\* i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, regjistruar për veprën penale “Prerje e paligjshme e pyjeve”, parashikuar nga neni 205 i Kodit Penal. Akti ligjor “Vendim për pushimin e procedimit penal”, datë 2.12.2015.

**Dosja nr. 4** – Procedimi penal nr. \*\*\*/\*\*\* i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, regjistruar për veprën penale “Plagosje e lehtë me dashje”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 89 e 25 të Kodit Penal, në ngarkim të të pandehurve M. Ç., E. Ç. dhe E.B. Akti ligjor “Kërkesë për gjykimin e çështjes penale”.

**Dosja nr. 5** – Procedimi penal nr. \*\*\*/\*\*\* i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, regjistruar për veprat penale “Plagosje e rëndë me dashje” dhe “Mbajtje pa leje e armëve luftarake”, të parashikuara nga nenet 88/1 e 278/2 të Kodit Penal, në ngarkim të të pandehurit K. H. Akti ligjor “Kërkesë për gjykimin e çështjes penale”.

## **17. Të dhënat arkivore (ankesat dhe masat disiplinore, vlerësimet)**

**17.1** Nga verifikimi në arkivin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë rezulton që ndaj subjektit të rivlerësimit, prokurorit Dorjan Tafilaj, nuk janë dhënë masa disiplinore.

**17.2** Mbi bazën e kërkesës për informacion, dërguar nga Komisioni, u është kërkuar informacion strukturave përkatëse të Prokurorisë së Përgjithshme dhe të gjitha prokurorive pranë shkallës së parë dhe janë administruar përgjigjet e shkresave, ku ka rezultuar:

- Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2020, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka konfirmuar se është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*/\*\*\*, mbi bazën e kallëzimit të shtetasit D. H., mbrojtës i të pandehurit L. P., i cili ka pretenduar se nga ana e prokurorit të çështjes D. Tafilaj janë ndryshuar aktet e fashikullit lidhur me ndryshimin e akuzës ndaj të pandehurit L. P., duke kërkuar ndjekje penale për veprat penale “Zhdukje ose humbje e fashikullit” dhe “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, të parashikuara nga nenet 313/a e 319/a të Kodit Penal. Pas hetimeve të kryera ka rezultuar se pretendimet nuk qëndronin dhe procedimi penal është pushuar në datën 17.7.2006.
- Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.2.2020, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë ka konfirmuar se është regjistruar kallëzimi penal nr. \*\*\*/\*\*\*, mbi bazën e kallëzimit të shtetasve Xh. e F. K. Kallëzuesit kanë pretenduar se prokurori i çështjes penale nr. \*\*\*/\*\*\* të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, D. Tafilaj, nuk kishte kryer hetime të gjithanshme në lidhje me identifikimin dhe marrjen në përgjegjësi penale të të gjithë bashkëpunëtorëve në krim. Në lidhje me veprimtarinë e prokurorit gjatë hetimit të kësaj çështjeje penale, kallëzuesit kanë kërkuar fillimin e procedimit për kryerje të veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Prokurori në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, pasi ka verifikuar aktet, ka

konkluduar se nuk rezultonin elemente të figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, duke vendosur mosfillimin e procedimit penal në datën 31.7.2018. Vendimi i mosfillimit është lënë në fuqi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë me vendimin nr. \*\*\*, datë 21.1.2019.

**17.3** Nga të dhënat e administruara nga Prokuroria e Përgjithshme rezulton se ndaj prokurorit Dorjan Tafilaj nuk janë depozituar ankesa.

**17.4** Subjekti i rivlerësimit, prokurori Dorjan Tafilaj, për vitet kalendarike 2014, 2015 dhe 2016 ka të arkivuara në drejtorinë ekonomike dhe të burimeve njerëzore, në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, vlerësimet e punës të kryera nga Prokurori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 42 të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe urdhrin nr. 221, datë 19.11.2012 “Për miratimin e rregullores për sistemin e vlerësimit të punës dhe aftësive profesionale dhe morale të prokurorëve”, si vijon:

- vlerësimi “shumë mirë”, dokumentuar me aktin e lëshuar nga Prokurori i Përgjithshëm për vitin 2015;
- vlerësimi “mirë”, dokumentuar me aktin e lëshuar nga Prokurori i Përgjithshëm për vitin 2016.

#### **ANALIZA E GJETJEVE<sup>54</sup>**

**18.** Bazuar në aktet e dorëzuara dhe në dosjet e shortuara, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, prokurori Dorjan Tafilaj, shfaq aftësi në pasqyrimin e rrethanave të faktit dhe analizën e provave në përputhje me bazën ligjore të aplikueshme. Aktet e përpiluara prej tij paraqiten të qarta dhe të kuptueshme. Respektohen rregullat e drejtshkrimit dhe niveli i arsytimit është në përputhje me standardin e procesit të rregullt ligjor. Konstatohet se subjekti Dorjan Tafilaj ka treguar aftësi në organizimin efektiv të kohës së punës, duke kryer detyrat e ngarkuara me efikasitet.

**19.** Subjekti i rivlerësimit, në rastin e vendimmarrjes mbi mosfillimin e procedimit penal, rezulton të ketë argumentuar mungesën e elementeve të veprës penale. Në procedimet penale për të cilat është vendosur pushimi i hetimeve, është realizuar drejtimi i hetimeve të kryera nga policia gjyqësore, duke argumentuar vendimmarrjen për pushimin e procedimit penal. Subjekti i rivlerësimit ka shfaqur aftësitë e nevojshme edhe mbi kontrollin e hetimeve të kryera nga policia gjyqësore për të mbështetur akuzën në çështjet me të pandehur të dërguar për gjykim.

**20.** Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Dorjan Tafilaj dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

**21.** Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Dorjan Tafilaj, si dhe nuk rezultojnë të dhëna që flasin për mënyrën e komunikimit ndërpersonal të subjektit me pjesëmarrësit në proces.

#### **Konkluzion i Komisionit**

**22.** Sa më sipër, në lidhje me tri dokumentet ligjore të përzgjedhura dhe pesë dosjet e shortuara, nuk u konstatuan problematika.

---

<sup>54</sup> Bazuar në kriteret ligjore të parashikuara nga nenet 73-76 të ligjit nr. 96/2016.



## DENONCIMET

**23.** Për subjektin e rivlerësimit janë paraqitur në total 11 denoncime. Nga këto, një denoncim është i përsëritur dy herë dhe gjithsej rezultojnë 10 denoncime të trajtuara për subjektin Dorjan Tafilaj.

### **23.1 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 20.9.2019, i shtetasit A.Gj**

Ky shtetas ka denoncuar disa subjekte rivlerësimi, ndër to edhe subjektin e rivlerësimit Dorian Tafilaj. Ai përmend shumë emra gjyqtarësh për dhënie vendimi të padrejtë për çështjen që ai ankohet, për shkak se shitja e ndërtesave për të cilën bëhet fjalë në vendim, është e përjashtuar nga pagesa e TVSH-së. Sipas tij, shoqëria “\*\*\*” ka vepruar në kundërshtim me ligjin dhe për këtë ai paraqet përgjigje të DPT-së për rastin në fjalë.

Ai denoncon arrestimin dhe dënimin e tij të padrejtë në të dyja shkallët e gjyqësorit. Evidentohet se denoncuesi ka qenë kryetar i degës së Tatim-Taksave Vlorë. Krahas dokumenteve të tjera të sjella nga denoncuesi, bashkëlidhur denoncimit gjenden dokumentet: kërkesa për gjykimin e procedimit penal nr. \*\*\*, datë 1.2.2001 dhe diskutimi përfundimtar i datës 13.6.2003, i prokurorit Dorjan Tafilaj. Në kërkesën për gjykimin e procedimit penal nr. \*\*\* bëhet fjalë për një kallëzim të shtetasve S. Sh. dhe M. K. në ngarkim të shtetasit A. Gj. (denoncuesit), për veprën penale “Marrja e mitës” dy herë, parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal. Në diskutimin përfundimtar, prokurori ka kërkuar deklarinim fajtor të të pandehurit A.Gj. për veprën penale “Marrja e mitës” nga ana e shtetasit S. Sh. dhe dënimin e tij sipas nenit 260 të Kodit Penal me 4 vjet burgim dhe pushimin e çështjes për të pandehurin A. Gj. për veprën penale “Marrja e mitës” nga ana e shtetasit M. K.

Nga provat e administruara dhe të shqyrtuara ka rezultuar se i pandehuri A. Gj., i ngarkuar me funksion shtetëror gjatë ushtrimit të detyrës, ka marrë shpërblime në shuma të konsiderueshme monetare nga shtetasi S. Sh., me qëllim të shprehur për të kryer ekzekutimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 4.7.2000, të Gjykatës së Apelit Vlorë, veprim i cili lidhet me funksionin e tij si kryetar i degës së Tatim-Taksave Vlorë. Në përfundim, prokurori ka dalë në konkluzionin se i pandehuri e ka kryer me dashje direkte dhe me qëllim të posaçëm veprën penale “Marrja e mitës”, parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal.

Nga verifikimi i dokumenteve të prokurorit të çështjes (kërkesë për gjykim dhe diskutim përfundimtar), si dhe referuar edhe dokumenteve të tjera bashkëlidhur këtij denoncimi, nuk u evidentuan shkelje procedurale nga ana e subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, në drejtim të kryerjes së veprimeve hetimore.

### **23.2 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 25.9.2019, i shtetasit A.H**

Ky denoncim është përcjellë nga Institucioni i Komisionerit Publik dhe adresohet për subjektin e rivlerësimit dhe për gjyqtarin T. B. Gjithashtu, nga një përgjigje e SHÇBA-së duket se denoncuesi ka paraqitur ankesë më parë edhe për një oficer të policisë gjyqësore, E. M. dhe për një punonjës të Komisarariatit të Policisë Fier, të cilët i ka denoncuar për kryerje veprimesh arbitrare gjatë paraqitjes për kontroll në banesën e vëllait të denoncuesit, të quajtur P. B. Ky i fundit ishte i dyshuar në lidhje me ngjarjen e datës 16.2.2019 në fshatin \*\*\*, ku është qëlluar me armë zjarri në drejtim të shtetasit K. H.

Komisariati i Policisë Fier ka referuar materialet procedurale të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ndaj të dyshuarit P. B., dyshuar për kryerjen e veprave penale “Vrasje me dashje e mbetur në tentativë” dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyes dhe i municionit”, të parashikuara nga nenet 76, 22 dhe 278/1 të Kodit Penal, i cili ka qëlluar mbi shtetasin K. H., i cili ka qenë në makinën e tij duke udhëtuar edhe me persona të tjerë. Pas

kryerjes së veprimeve të para hetimore, oficeri i policisë gjyqësore ka kërkuar që materialet t'i kalojnë për veprime të mëtejshme Prokurorisë.

Të gjitha dokumentet e tjera bashkëlidhur denoncimit flasin për kryerje veprimesh hetimore në një kohë të shpejtë dhe me efikasitet nga ana e prokurorit Dorjan Tafilaj, me gjithë kërkesën për zgjatje hetimesh të datës 17.5.2019. Kështu, urdhri i regjistrimit penal është i datës 19.2.2019 dhe njoftimi për përfundimin e hetimeve për procedimin penal mban datën 23.7.2019, duke pasur parasysh këtu edhe faktin se i dyshuari P. B. ka qenë i shpallur në kërkim policor (nga data 16.2.2019 deri më 26.2.2019). Në këtë dokument dhe në kërkesën për dërgimin në gjyq të datës 31.7.2019, prokurori ka kërkuar gjykimin e të pandehurit P. B. për kryerjen e veprave penale “Kanosje në bashkëpunim” dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyesë dhe i municionit”, të parashikuara nga nenet 84-25 dhe 278/1 të Kodit Penal.

Sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit në cilësinë e prokurorit të çështjes nuk ka kryer shkelje procedurale gjatë hetimit të kësaj çështjeje dhe nuk kishte *indicie* për hetim të mëtejshëm.

### **23.3 Denoncimet e përsëritura të shtetasit Th.Ç, nr. \*\*\* prot., datë 25.9.2019 dhe nr. \*\*\* prot., datë 1.10.2019**

Këto denoncime janë përcjellë nga Institucioni i Komisionerit Publik dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit dhe adresohet për shumë subjekte rivlerësi, ndër to edhe për subjektin e rivlerësimit. Ai ankohet se ka 10 vite që kërkon drejtësi dhe nuk e ka gjetur atë nga gjyqtarë e prokurorë të korrumpuar. Ai liston disa emra subjektsh-gjyqtarë, por liston edhe emrin e prokurorit Dorian Tafilaj, për të cilin pretendon se ka pushuar një çështje penale mashtrimi me shumë të madhe eurosh, duke dalë hapur në mbrojtje të palës tjetër. Bashkëlidhur kërkesës së tij me shkrim, denoncuesi ka sjellë një sërë dokumentesh ligjore, duke filluar me një kallëzim penal, me të cilin i drejtohet Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier për të kallëzuar shtetasin B.T., duke marrë shkas nga padia që i ka ngritur denoncuesit motra e të kallëzuarit B. T., me objekt “Lirim e dorëzim të një sipërfaqeje toke (1,460 m<sup>2</sup>)”, për të cilin denoncuesi pretendon se ia ka shlyer detyrimin për këtë sipërfaqe toke shtetasit B. T. Në vitin 2006, kallëzuesi ka rënë dakord me shtetasin B. T. për të blerë një tokë arë me sip. 11,00 m<sup>2</sup>, ku ai e siguroi që ishte pronar i vetëm dhe kishte dokumentacion të rregullt ligjor. Pasi ranë dakord për blerjen e tokës, bënë marrëveshje verbale që shlyerja e detyrimeve financiare të bëhej me këste, sipas të ardhurave që do të kishte kallëzuesi pas investimit që do të bënte në këtë tokë. Kallëzuesi bashkë me kushëririn e tij ka filluar investimet në vitet 2006 – 2008, ku ka ndërtuar një magazinë rreth 600 m<sup>2</sup> dhe një zyrë prej druri.

Shtetasi B. T., pasi pa që kallëzuesi po punonte, i kërkoi të likuidonte një këst. Kallëzuesi ka aplikuar për kredi bankare, e cila sapo i është aprovuar, ka shkuar tek noteri dhe ka lidhur kontratën e shitblerjes së tokës (2,000 m<sup>2</sup> në vlerën 874,000 lekë), që edhe banka të justifikonte dhënien e kredisë për blerjen e tokës për biznes. Këtë shitje shtetasi B. T. e ka bërë pa i bashkëlidhur kontratës hartën treguese të vendndodhjes së pronës. Me çeljen e kredisë, kallëzuesi i jep 5,100,000 lekë në mirëbesim, shumë më tepër se vlera e kontratës së lidhur. Në vitin 2011, kallëzuesit i aprovohet një kredi tjetër prej 5,800,000 lekësh për kryerje punimesh për biznesin dhe vetëm në këtë moment nga ekspertët e bankës kallëzuesi e kupton se toka e shitur nuk ishte në pozicionin që kallëzuesi kishte investuar, por shumë metra më poshtë (ishte kënetë). Megjithatë, i kallëzuari i kishte premtuar se, kur të bënte shitjen përfundimtare të së gjithë sipërfaqes së premtuar, do ta përfshinte edhe tokën ku kishte investuar, por i kishte thënë se kishte një konflikt me motrën A. B. dhe se duhej t'i jepte asaj një sasi parash. Pastaj, kallëzuesi i kishte kaluar dy herë nga 10,000 euro nëpërmjet bankës në llogari të të kallëzuarit B. T., me qëllim përfundimin e shitjes. Ndërsa i kallëzuari B. T. ka pretenduar se shtetasi Th.Ç

dhe ai njiheshin prej kohësh dhe se kishin marrëdhënie miqësie. Ky i fundit i ka kërkuar 6,000 m<sup>2</sup> tokë me qira shtetasit B. T. kundrejt pagesës prej 10,000 lekësh në muaj për vitin 2007 – 2008. Por, pak para mbarimit të afatit të kontratës së qirasë, denoncuesi ka shfaqur interes për blerjen e kësaj toke, ku pas negociatash është rënë dakord në fillim për një sipërfaqe prej 2,000 m<sup>2</sup> tokë. Pastaj, ai shtynte afatin e realizimit të shitjes me pretekstin e marrjes së kredisë, ku do i shlyente vlerën e tokës dhe borxhin e akumuluar deri në 4,500,000 lekë, ku i kallëzuarit pretendon se ia kishte dhënë për të blerë mall për ushtrimin e aktivitetit të tij tregtar. Pas realizimit të shitjes së 2,000 m<sup>2</sup> tokë, janë nënshkruar edhe dy kontrata qiraje, në total tri kontrata qiraje, që për asnjërin nuk ka paguar qoftë një muaj të vetëm, duke i mashtruar se pas zhbllokimit do të paguante vlerën e blerjes së tokës. Ndërsa motra e të kallëzuarit A. B. pretendon se nuk ka bërë marrëveshje me shtetasin Th. Ç. dhe se kontratën e ka bërë para shume vitesh dhe kërkon lirim e dorëzim sipërfaqeje toke nga kallëzuesi, tokë e cila është kompensuar nga vëllai i saj B. T. kundrejt detyrimit që ai kishte ndaj saj. Ajo deklaron gjithashtu se para disa viteve i kishte dhënë 60 milionë lekë borxh shtetasit Th. Ç (me dokument huaje), ku ajo pretendon se nuk ia kishte kthyer ende.

Sa më sipër, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier, me prokuror D. Tafilaj, në datën 10.7.2017 ka arsyetuar se marrëdhënia midis palëve është një marrëdhënie tipike juridiko-civile. Mungesa e shlyerjes së detyrimit kontraktual, edhe në qoftë se nuk është përmbushur, nuk çon në konsumimin e veprës penale “Mashtrim”, pasi nuk vërtetohet në asnjë moment fakti se i kallëzuarit me dashje dhe nëpërmjet gënjeshtërisë apo shpërdorimit të besimit ka vjedhur pasurinë e kallëzuesit Th. Ç. Në këto kushte, prokuroria ka çmuar se shtetasi B. T. nuk ka konsumuar elementet e veprës penale “Mashtrim”, parashikuar nga neni 243/2 i Kodit Penal dhe ka pushuar procedimin penal nr. \*\*\*/\*\*\*.

Këtë vendim e ka ankimuar kallëzuesi (denoncuesi), ku Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka pranuar kërkesën, duke i lënë detyra specifike prokurorit në drejtim të një hetimi më të plotë të procedimit penal. Edhe Gjykata e Apelit Vlorë (pas ankimit nga ana e prokurorit dhe të të kallëzuarit) me vendimin nr. \*\*\*, datë 16.5.2018, ka lënë në fuqi vendimin e sipërcituar me qëllim kryerjen e veprimeve hetimore të mëtejshme, ku në varësi të rezultatit të tyre prokuroria të mund vlerësojë ekzistencën ose jo të elementeve të veprës penale të mashtrimit apo të ndonjë veprë tjetër penale.

Në vështrim të vendimit të subjektit të rivlerësimit për pushimin e procedimit penal të datës 10.7.2017, duket se të dyja palët në proces (kallëzuesi dhe i kallëzuarit) kanë ankesa në mospërmbushje detyrimesh ndërmjet njëri-tjetrit, por të një natyre të ndryshme nga njëri-tjetri. Kështu, nëse kallëzuesi-denoncuesi pretendon mospërmbushje detyrimi për përfundimin e procesit të shitjes së tokës me sipërfaqe 11,000 m<sup>2</sup>, përkundrazi, i kallëzuarit pretendon mospërmbushje shlyerjeje detyrimi të qirave sipas tri kontratash qiraje për një sipërfaqe toke 6,000 m<sup>2</sup> dhe shlyerje borxhesh të akumuluar nga paratë e dhëna kallëzuesit për qëllime tregtie. Prokurori i çështjes duhej të kishte ballafaquar të dy shtetasit së bashku, për të kuptuar natyrën e konfliktit ndërmjet tyre dhe se çfarë veprimesh hetimore ishin të domosdoshme për t'u kryer.

Si përfundim, konstatohet se prokurori i çështjes duhej të kryente disa veprime procedurale, që të mund të sqaronin më mirë rrethanat e çështjes.

Sa më sipër, për efekt të arsyetimit të vendimit, për sa i përket aspektit procedural të tij, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe asaj të Apelit, subjektit të rivlerësimit iu kërkuan sqarime në lidhje me ecurinë e këtij procesi në drejtim të kryerjes së veprimeve hetimore shtesë të përcaktuara nga Gjykata.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar se: “Në lidhje me procedimin penal nr. \*\*\*, viti 2017, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, mbi bazën e kallëzimit të bërë nga shtetasi Th.Ç, ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*, datë 23.2.2017, për veprën penale “Mashtrimi”, të parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal. Kallëzuesi Th.Ç ka pretenduar se shtetasi B.T e ka mashtruar në lidhje me vendndodhjen dhe pronësinë e 4,000 m<sup>2</sup> tokë. Në lidhje me këtë procedim, në datën 10.7.2017 nga ana ime është vendosur pushimi i çështjes, duke vlerësuar se të gjitha aktet e administruara në dosje konfirmonin mungesën e veprës penale, të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal, në mbështetje të nenit 328, shkronja “b” e Kodit të Procedurës Penale.

Me vendimin nr. \*\*\*, datë 12.2.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, në bazë të ankimit të kallëzuesit Th. Ç., është vendosur kthimi i akteve prokurorit dhe vazhdimi i hetimeve për këtë procedim. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. \*\*\*, datë 16.5.2018, të Gjykatës së Apelit Vlorë. Në datën 28.5.2019, pas veprimeve hetimore të kryera në zbatim të detyrave të lëna në vendimin nr. \*\*\*, datë 12.2.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, është kërkuar pushimi i këtij procedimi penal në bazë të nenit 328/1/a dhe të nenit 329/1/a të Kodit të Procedurës Penale, pasi mungonin elementet e veprës penale, të parashikuara nga neni 143 i Kodit Penal, pasi ndodhemi para një mosmarrëveshjeje tipike juridiko-civile.

Me vendimin nr. \*\*\*, datë 5.3.2020, të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier është vendosur rrëzimi i kërkesës së prokurorit për pushimin e çështjes dhe kthimin e akteve prokurorit dhe vazhdimin e hetimeve të mëtejshme për këtë procedim. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. \*\*\*, datë 21.7.2020, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Në datën 18.12.2020, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\* për veprën penale të parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, në bazë të kallëzimit të shtetasit Th. Ç., i cili pretendon se shtetasi B. T. ka falsifikuar firmat në kontratën e shitjes me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 20.6.2000, me anë të së cilës ka blerë pronën nga nëna e tij A. T. Ky procedim është bashkuar me procedimin penal nr. \*\*\*/\*\*\*. Në datën 2.9.2021, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\* për veprën penale të parashikuar nga neni 305 i Kodit Penal, në bazë të kallëzimit të shtetasit B. T., i cili pretendon se kallëzimet e bëra nga shtetasi Th. Ç. janë të rreme. Ky procedim është bashkuar me procedimin penal nr. \*\*\*/\*\*\*. Organi i prokurorisë ka kryer veprime hetimore në bazë të detyrave të lëna nga gjykata, si dhe në lidhje me 2 procedimet e tjera të përmendura më sipër.

Ky procedim penal është ende në hetim për shkak të kompleksitetit që kanë këto procedime, që janë bashkuar në një procedim të vetëm (\*\*\*/\*\*\*). Lidhur me procedimin penal që është ndjekur nga ana ime, kam vlerësuar se të gjitha mosmarrëveshjet e palëve kanë qenë të natyrës civile.

Vepra penale e mashtrimit ka një dallim shumë delikat nga një mosmarrëveshje ose detyrim i natyrës civile. Elementi themelor i kësaj vepre penale, që bën edhe dallimin midis marrëdhënies civile dhe veprës penale, është elementi subjektiv. Konkretisht, si element i anës subjektive, nga ana e organit procedues duhet të vërtetohet se subjekti i kallëzuar me dashje nëpërmjet gënjeshtërisë ose shpërdorimit të besimit i ka vjedhur pasurinë subjektivit tjetër, në rastin në shqyrtim kallëzuesit.

Si në vendimin e pushimit të çështjes, ashtu edhe më pas, në kërkesën për pushimin e çështjes nga ana e organit procedues, është pasqyruar se nuk vërehen elemente të veprës penale “Mashtrimi” nga ana e shtetasit B.T.

Pretendimet e kallëzuesit nuk provohen në asnjë rast nga veprimtaria hetimore e kryer në kuadër të këtij procedimi penal. Pretendimi se shitja e pasurisë është kryer pa u shoqëruar me

hartën treguese nuk qëndron, sepse nga aktet rezulton se kontrata është e shoqëruar me hartën treguese.

*Pretendimi se shitja e pasurisë me nr. \*\*\* nuk përputhet me pronën konkrete, për të cilën kanë rënë në marrëveshje palët, nuk është i vërtetë, sepse nga harta treguese duket qartë se prona është vendosur sipas përcaktimeve në kontratë. Pretendimi tjetër se kallëzuesi ka rënë në dijeni nga ekspertët vlerësues të bankës se nuk i është shitur prona sipas përcaktimeve në kontratë nuk qëndron, sepse rezulton së ekspertët vlerësues të bankës nuk kanë bërë ndonjë vlerësim të kësaj pasurie me nr. \*\*\*.*

*Midis të tjerave është kryer edhe ballafaqimi i datës 22.11.2018 midis shtetasve Th. Ç. dhe B.T, si dhe janë administruar disa vendime civile të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, me palë ndërgjyqëse Th. Ç. e B. T., të cilat kanë lidhje me faktet e kallëzuara në këtë procedim penal.*

*Për sa më sipër, arrihet në konkluzionin se mungojnë elementet e veprës penale të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal, sepse mungon objekti dhe ana subjektive e kësaj vepre penale. Konkretisht nuk konstatohet asnjë vjedhje e pasurisë nëpërmjet gënjeshtërisë ose shpërdorimit të besimit në dëm të shtetasit Th. Ç.*

*Për sa i përket kërkesës së Komisionit se duhet të evidentohen saktësisht pretendimet e palëve, ky moment është zgjidhur jo vetëm me veprimet e kryera nga ana ime të përshkruara më lart, por edhe nëpërmjet hetimeve të procedimit penal nr. \*\*\* për veprën penale të parashikuar nga neni 305 i Kodit Penal, ku kallëzuesi B. T. ka paraqitur një kallëzim të shoqëruar me material kallëzues dhe pretendon se kallëzimi i shtetasit Th. Ç. kundër tij është i rremë. Të gjitha kallëzimet e palëve janë duke u hetuar në një procedim të vetëm, pasi janë bashkuar sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale. Nga aktet evidentohet se shtetasi Th. Ç. ka paraqitur disa padi civile kundër shtetasit B. T. Për këto padi civile janë dhënë edhe vendimet gjyqësore përkatëse, ku rezulton se shtetasi Th. Ç. i ka trajtuar edhe në gjykimet civile pretendimet e parashtruar në kallëzimin penal dhe këto pretendime i janë rrëzuar nga ana e gjykatave civile. Bashkëlidhur subjekti ka vënë në dispozicion dokumente provuese<sup>55</sup>”.*

### **Vlerësimi i Komisionit**

Në lidhje me shpjegimet e subjektit për denoncimin e shtetasit Th. Ç., vërehet se gjykata e ka kthyer dy herë kërkesën e subjektit të rivlerësimit për pushimin e procedimit penal në lidhje me kërkesën e tij drejtuar Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm të Shkallës së Parë Fier dhe Gjykata e Apelit Vlorë e ka lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë në lidhje me rrëzimin e kërkesës së prokurorit për pushim procedimi, duke lënë detyra konkrete me kërkesë për hetim të plotë. Aktualisht, referuar bashkimit të procedimeve penale në një të vetëm (\*\*\*/\*\*), konstatohet se konflikti ndërmjet shtetasve Th. Ç. dhe B. T. nuk ka marrë zgjidhje, çka do të thotë se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer hetime të plota dhe të gjithanshme. Pavarësisht kompleksitetit të çështjes ndërmjet dy palëve (duke qenë se palët janë edhe në lidhje krushqie me njëra-tjetrën), të cilat e kallëzojnë dhe akuzojnë njëra-tjetrën (për kallëzim të rremë) në mënyrë të vazhdueshme, prapëseprapë shpjegimet e subjektit nuk ishin të mjaftueshme në drejtim të shterimit të të gjitha veprimeve hetimore për ndjekjen e çështjes në ngarkim të dy shtetasve të sipërcituar. Megjithatë, kjo mangësi në kryerje veprimesh hetimore nuk përbën

<sup>55</sup> Urdhri i regjistrimit të procedimit penal nr. \*\*\*/\*\*\*; vendimi i pushimit datë 10.7.2017; vendimi nr. \*\*\*, datë 12.2.2018, i Gjykatës së Shkallës së Parë Fier; kërkesa e datës 28.5.2019 për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*/\*\*\*; vendimi nr. \*\*\*, datë 5.3.2020, i Gjykatës së Shkallës së Parë Fier; urdhri i regjistrimit të procedimit penal nr. \*\*\*/\*\*\*; procesverbal ballafaqimi i datës 22.11.2018 midis shtetasve Th. Ç. dhe B.T.; vendimi civil nr. \*\*\*, datë 5.1.2018, i Gjykatës së Shkallës së Parë Fier; vendimi civil nr. \*\*\*, datë 6.9.2019, i Gjykatës së Shkallës së Parë Fier; vendimi civil nr. \*\*\*, datë 3.3.2020, i Gjykatës së Shkallës së Parë Fier; vendimi civil nr. \*\*\*, datë 19.2.2021, i Gjykatës së Shkallës së Parë Fier; vendimi civil nr. \*\*\*, datë 6.2.2023, i Gjykatës së Shkallës së Parë Fier; vendim i prokurorit për bashkimin e procedimeve penale nr. \*\*\*, datë 25.4.2021 dhe nr. 1428, datë 18.12.2020; vendim i prokurorit për bashkimin e procedimeve penale nr. \*\*\*, datë 25.4.2021 dhe nr. \*\*\*, datë 2.9.2021.

problematikë thelbësore, e cila të mund të çonte në penalizimin e subjektit lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale.

#### **23.4 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 9.11.2018, i shtetasit E.M**

Ky shtetas u është drejtuar edhe disa institucioneve të tjera, ku ankohet për mospërbushjen e detyrimit ligjor nga ana e organit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier në lidhje me kërkesat e përsëritura dhe kërkon inspektimin e veprimeve dhe mosveprimeve procedurale të organit të prokurorisë. Ankuesi tregon ngjarjen që i ka ndodhur në datën 21.4.2018, kur i kanë vendosur lëndë shpërthyesë në autoveturën e tij, por për fatin e mirë të tij ka shpëtuar. Është informuar se prokurori i caktuar për hetimin e çështjes është z. Dorjan Tafilaj, por në lidhje me mbështetjen që organi i prokurorisë duhej t'i jepte si i dëmtuar nga kjo ngjarje e ndodhur, ankuesi thotë se nuk rezultoi asnjë rezultat në lidhje me identifikimin dhe vënien përpara drejtësisë të autorëve të atentatit me eksploziv të shkaktuar ndaj tij, si dhe ankohet se organi i prokurorisë nuk i ka dhënë vërtetimin dhe nuk e kanë ndihmuar që të kthejë targat e makinës së dëmtuar. Përfundimisht, ankuesi kërkon interesimin nga ana jonë në lidhje me rastin e paraqitur dhe bërjen të mundur të kërkesave sipas citimeve në kërkesat e protokolluara<sup>56</sup> në sekretarinë e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, në datat 4 qershor dhe 9 tetor të vitit 2018, si dhe inspektimin e rastit referuar për ankim dhe marrjen e masave disiplinore përkatëse.

Në kërkesat e ankuesit, baza ligjore e cituar ka të bëjë me detyrimin e organit të akuzës për plotësimin e kërkesave materiale, në rastin konkret kthimin e sendeve të sekuestruara: autoveturë e dëmtuar dhe aparat telefonik. Në referim të neneve 190, 217 dhe 218 të Kodit të Procedurës Penale thuhet se: *“Provat materiale mund t’u kthehen personave që u përkasin edhe para mbarimit të procedimit, kur nuk dëmtohet zgjidhja e çështjes; Kur nuk është e nevojshme mbajtja e sekuestros për qëllime prove, sendet e sekuestruara i kthehen atij që i takojnë edhe para se të merret vendimi përfundimtar; Gjykata vendos kthimin e sendeve të sekuestruara kur nuk ka dyshim për përkatësinë e tyre; Gjatë hetimeve paraprake, kthimi i sendeve të sekuestruara urdhërohet nga prokurori. Kundër urdhrit të prokurorit të interesuarit mund të bëjnë ankim në gjykatë”*.

Siç shihet, kërkesa drejtuar prokurorit mban datën 9.10.2018 dhe ankimi drejtuar institucionit tonë mban datën 9.11.2018, që do të thotë se, në rast mospërbushjeje të kësaj kërkesë, është parashikuar mundësia e ankimit nga ana e ankuesit. Në këto kushte, Komisioni nuk mund të hetonte më tej në adresë të subjektit të rivlerësimit.

#### **23.5 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 19.2.2019, i shtetasve Xh. dhe F. K**

Këta shtetas i janë drejtuar Komisionit dhe ankohen për prokurorin Dorjan Tafilaj, duke thënë se ai nuk ka bërë një hetim të plotë e të gjithanshëm në lidhje me ngjarjen e ndodhur në maj të vitit 2017, ku u kanë vjedhur një sasi parash (10 milionë lekë) dhe një automjet. Në lidhje me këtë ngjarje, ata pohojnë se prokuroria ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*/\*\* në ngarkim të personave R. L. dhe Xh. M. për veprën penale “Vjedhje me pasoja të rënda”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 134/3 i Kodit Penal. Denoncuesit ankohen se prokurori nuk ka vënë para përgjegjësisë penale të gjithë personat (kryesisht shtetasen B. M. dhe shtetas të tjerë) që kanë bashkëpunuar si në vjedhjen e shumës prej 10 milionë lekësh në automjet, si dhe për vjedhjen me thyerje të banesës. Gjithashtu, denoncuesit në cilësinë e viktimës në procesin penal pretendojnë se prokurori nuk u ka kthyer përgjigje konform nenit 110 të Kodit të Procedurës Penale kërkesave të argumentuara të avokatëve përfaqësues të tyre, si rrjedhojë e

<sup>56</sup> Bashkëlidhur ankuesi ka sjellë kërkesat e protokolluara në sekretarinë e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier të datave 4.6.2018 dhe 9.10.2018 dhe vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 3.7.2018.

disa përgjimeve të administruara në dosjen hetimore, duke bërë që prokurori të kryejë shkelje procedurale, ka zvarritur në mënyrë të qëllimshme përfundimin e çështjes etj.

Denoncuesit e mbyllin denoncimin e tyre, duke thënë se: “Prokurori D. Tafilaj, në kundërshtim me detyrën e tij, ka komunikuar me ne të dëmtuarit duke na dërguar mesazhe në datat xxxx2018”.

Bashkëlidhur denoncimit, denoncuesit kanë sjellë 9 faqe përgjime të transkriptuara, kopje të relacionit të OPGJ-së P. D. “Për kryerjen e veprimeve në lidhje me procedimin penal nr. \*\*\*/\*\*\*”, kopje të vendimit datë 25.5.2018 “Për marrjen e të dhënave kompjuterike”, procesverbal i transkriptimit të përgjimeve telefonike të shtetases B. M. në lidhje me procedimin penal nr. \*\*\*/\*\*\*, si dhe pamje të vendit të ngjarjes.

Nga hetimi u konstatua se ky rast është bërë publik nëpërmjet emisionit investigativ “\*\*\*”, të datës 23.10.2018, në \*\*\*. Në lidhje me shkeljet e mundshme procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni u fokusua tek përgjimet (9 faqe të sjella nga denoncuesit), tek pamjet dhe bisedat e regjistruara në emisionin “\*\*\*”, si dhe në arsyetimin e bërë në relacionin e OPGJ-së P. D. “Për kryerjen e veprimeve në lidhje me procedimin penal nr. \*\*\*/\*\*\*”.

Nga përgjimet telefonike dhe ato me mesazh nuk rezultoi një bisedë apo komunikim i subjektit të rivlerësimit, që të mund të përbente një *indicie* për hetim të mëtejshëm në adresë të subjektit në drejtim të implikimit të tij për sa i përket etikës së një magjistrati.

Për pretendimin se prokurori nuk ka vënë para përgjegjësisë penale të gjithë personat, kryesisht shtetasen B. M., Komisioni vlerësoi se duke parë faktet dhe rrethanat e çështjes, ajo shtetase mund të ngarkohej me përgjegjësi penale për një vepër tjetër penale dhe jo për atë të vjedhjes, kryer në bashkëpunim, ku viktimat (denoncuesit) ishin të interesuar. Në këtë kuptim, nuk legjitimohet interesi i tyre insistues për sa i përket zgjidhjes së çështjes, duke përfshirë edhe këtë shtetase në procedimin penal të filluar për veprën penale “Vjedhje”.

Referuar edhe sugjerimit të ONM-së, Komisioni iu drejtua Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, ku i kërkoi dosjen e procedimi penal nr. \*\*\*, viti 2017, për veprën penale “Vjedhje me pasoja të rënda”, si dhe informacion lidhur me ecurinë e mundshme të kësaj çështjeje në shkallët e gjyqësorit, të ndjekur nga prokurori Dorjan Tafilaj.

Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.10.2023, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier ka kthyer përgjigje, duke vënë në dispozicion kopje të njëzues me origjinalin të akteve të procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2017.

Nga aktet bashkëlidhur u informuam se procedimi penal i referohet kallëzimit penal të bërë nga shtetasi Xh. K, njëri prej dy viktimave të faktit penal, ai i vjedhjes së ndodhur në datën 29.5.2017 ndaj shtetasve Xh. e F. K të sasisë së parave të tyre prej 10 milionë lekësh, të ndodhura brenda automjetit të tyre, vjedhjes së automjetit dhe një kopjeje të çelësit të automjetit. Prokuror i çështjes është caktuar subjekti i rivlerësimit. Prokurori duket se ka kryer veprimet hetimore të nevojshme, duke urdhëruar edhe regjistrimin e emrave të personave që u atribuohet vepra penale (R. L. dhe Xh. M.) “Vjedhje me pasoja të rënda”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 134/3-25 i Kodit Penal.

Sipas kallëzimit penal të bërë nga denoncuesit Xh. e F. K në adresë të prokurorit D. Tafilaj, për të cilin kërkohet ndjekjen penale të tij për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, me pretendimin se i janë drejtuar emisionit investigativ “\*\*\*” në \*\*\* dhe, pas transmetimit të këtij emisioni, kanë përshtypjen se prokurori nuk do të kryejë hetim të paanshëm. Ata gjithashtu kanë pretenduar se prokurori nuk ka pranuar kërkesat e tyre për kryerje veprimesh hetimore, duke mos u kthyer përgjigje për kërkesat e bëra. Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e

prokurorit të çështjes, është zëvendësuar<sup>57</sup> me një prokuror tjetër. Ai duket se ka dhënë pëlqimin për heqje dorë nga hetimi që po kryhej në kuadër të procedimit penal të filluar në vitin 2017, duke argumentuar se kjo kërkesë ishte në vijim të presioneve të pandërprera nga ana e viktimave dhe avokatëve të tyre, me të vetmin qëllim, imponimin në vendimmarrjen e tij në këtë procedim penal.

Sa më sipër, në përfundim të shqyrtimit edhe të dy fashikujve të procedimit penal nr. \*\*\*/\*\*, Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit në cilësinë e prokurorit të çështjes nuk ka kryer shkelje procedurale gjatë hetimit të saj.

### **23.6 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 11.12.2017, i shtetasit J.M**

Ky shtetas në formularin e denoncimit të tij për subjektin e rivlerësimit ka sqaruar se arsyet shpjeguese janë bërë me shkrim dore në shkresën bashkëlidhur, e cila është një ankesë me të cilën ankuesi ankohet për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë në lidhje me vendimin nr. \*\*, datë 25.4.2005 dhe për Gjykatën e Apelit Korçë, me gjyqtare E. P., e cila ka bllokuar dyer dhe dritare të shtëpisë dhe automjetin fuoristradë për rreth 3 vjet e gjysmë. Ankuesi ankohet edhe për subjekte të tjera dhe shton se është ankuar edhe në prokurori 10 herë dhe nuk ka gjetur zgjidhje.

Krahas dokumenteve që ankuesi ka sjellë (vendime gjyqësore të viteve 2005 dhe 2006), bashkëlidhur gjendet ankimi i datës 15.12.2015 drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë nga ana e ankuesit J. M, i cili kundërshton vendimin e pushimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, datë 24.11.2015, për procedimin penal nr. \*\*, viti 2014, në lidhje me veprat penale “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Dhunimi i banesës”. Ankuesi sqaron se vetëm disa ditë pas paraqitjes së këtij kallëzimi, Prokuroria kishte vendosur mosfillimin e hetimit për këtë kallëzim dhe Gjykata, me vendimin nr. \*\*, datë 14.4.2014, kishte vendosur prishjen e vendimit të mosfillimit dhe detyrimin e Prokurorisë të regjistronte procedimin dhe të kryente hetime të plota. Prokuroria, sipas ankuesit, e kishte mbajtur çështjen një vit dhe në datën 24.11.2015 kishte vendosur pushimin e çështjes. Kallëzuesi (ankuesi), duke mos qenë dakord, e ka ankimuar në Gjykatë këtë vendim të prokurorit, i cili sipas tij nuk ka kryer detyrat e tij funksionale dhe procedurale, duke mos zbatuar një vendim gjykate dhe detyrat e lëna prej saj.

Ndërsa gjendet bashkëlidhur ankimit të shtetasit J. M edhe vendimi i mosfillimit të procedimit të çështjes me nr. kallëzimi \*\*\*/\*\*, i prokurorit z. Dorjan Tafilaj, aktet e të cilit bëjnë fjalë për veprën penale “Vetëgjyqësia”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal. Fakti penal i referohet kallëzimit të ankuesit J. M, i cili ka konflikt pronësie me vëllain e tij K. M, ku, ky i fundit nëpërmjet zyrës përmbartimore Korçë ka mundur ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të vitit 2004 për lirim e dorëzim sendi dhe, konkretisht, sipas vendimit të prokurorit, vëllai i ankuesit ka vendosur disa llamarina, duke bllokuar automjetin e kallëzuesit (ankuesit) në oborrin e banesës. Ky mjet ka qenë i bllokuar, pasi dalja e automjetit është bllokuar me llamarina. Për këtë arsye, kallëzuesi ka paraqitur kallëzim penal ndaj vëllait të tij K. M për veprën penale “Vetëgjyqësia”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal. Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka argumentuar se i kallëzuar (vëllai i ankuesit) nuk ka kryer veprime për të shmangur rrugën ligjore. Përkundrazi, prokurori e orienton kallëzuesin që mosmarrëveshjen në lidhje me bllokimin e automjetit ta zgjidhë në rrugë administrative e gjyqësore.

---

<sup>57</sup> Shihni vendimin e datës 8.11.2018 të zëvendësimit të prokurorit, të nënshkruar nga kryetari i Prokurorisë së Rrethit Fier.



Në këto kushte, duke mos u gjendur para veprës penale “Vetëgjyqësia” apo ndonjë vepre tjetër penale, prokurori ka çmuar se fakti i referuar nga ankuesi nuk parashikohet nga ligji si veprë penale dhe, për këtë shkak, procedimi penal nuk mund të fillojë.

Nisur nga fakti se ky konflikt ishte shumë i kahershëm, subjektit të rivlerësimit iu kërkuan shpjegime në lidhje me ecurinë e kësaj çështjeje, si dhe statusin e saj të tanishëm.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar se: *“Për çështjen me kallëzues shtetasin J.M, me objekt kallëzimi për veprën penale “Vetëgjyqësia”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal është vendosur mosfillimi i procedimit penal, me datë vendimi 14.6.2016.*

*Nga aktet rezulton e qartë se nuk plotësohen kriteret objektive të kësaj vepre penale. Vepra penale “Vetëgjyqësia” kërkon si element objektiv të saj ushtrimin e një të drejte nga personi që i përket e drejta ose që kujton se i përket, pa iu drejtuar organit kompetent shtetëror për vendosjen e të drejtës.*

*Në rastin konkret, veprimet e kallëzuara nga ana e shtetasit J.M kundër vëllait të tij K.M janë kryer tërësisht nga ana e organeve kompetente shtetërore dhe konkretisht nga Zyra Shtetërore Përmbartimore Korçë, e cila me procesverbalin e veprimeve përmbartimore gjatë ekzekutimit, datë 21.11.2014, ka ekzekutuar vendimin gjyqësor të formës së prerë nr. \*\*\*, datë 1.12.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, me objekt “Rivendosje në posedim mbi një punishte zdrukthëtari dhe mbi mjetet e punës ndodhur në të”.*

*Sipas dispozitivit të vendimit, rezulton se gjykata ka vendosur: pranimin e kërkesëpadisë të paditësve K. M. e K. M; detyrimin e të paditurit J.M të lirojë e të dorëzojë objektin e pushtuar arbitrarisht, punishte zdrukthëtari e ndodhur në fshatin H, para shtëpisë së paditësve... Pikërisht ky vendim është ekzekutuar nga ana e Zyrës Përmbartimore Korçë. Të gjitha veprimet që kallëzohen nga ana e shtetasit J.M janë kryer nga ana e Zyrës Shtetërore Përmbartimore dhe jo nga ana e të kallëzuarit K. M. Në këto rrethana nuk mund të regjistrohej procedim penal për veprën penale “Vetëgjyqësia” dhe, për këtë arsye, nga ana ime është vendosur mosfillimi i procedimit penal.*

*Në lidhje me ecurinë e kësaj çështjeje, ju informoj se në datën 15.10.2016 jam larguar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë, sepse jam komanduar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier (në muajin nëntor 2016 jam emëruar në këtë prokurori, ku ushtroj funksionet edhe aktualisht) dhe nuk jam në dijeni të ecurisë së këtij procedimi penal”.*

### **Vlerësimi i Komisionit**

Në lidhje me denoncimin e shtetasit J.M, subjekti i rivlerësimit dha shpjegime bindëse dhe të plota, duke argumentuar se veprimet e pretenduara si “vetëgjyqësi”, të kallëzuara nga ana e shtetasit J M (denoncuesit), janë kryer nga ana e Zyrës Shtetërore Përmbartimore dhe jo nga ana e të kallëzuarit K. M. Ndërsa, në lidhje me ecurinë e këtij procesi (konflikti), subjekti sqaroi se që në muajin nëntor 2016 është emëruar me detyrë prokuror pranë një prokurorie të një juridiksioni tjetër territorial e gjyqësor.

### **23.7 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 27.4.2018, i shtetasit A. M**

Ky shtetas bashkë me familjarët e tij kanë denoncuar edhe më parë subjekte të tjera rivlerësimi dhe me denoncimin e datës 27.4.2018 ai ankohet edhe për subjektin e rivlerësimit për zvarritje të procedimit penal jashtë afateve të përcaktuara në ligje të kallëzuesve A. M. e A. P., ndaj shtetas S. R. për veprën penale “Kallëzim i rremë”. Ankuesi thotë se dosja ka shkuar në prokurori që në datën 4.1.2018 dhe deri në datën 20.4.2018 nuk janë thirrur nga prokurori dhe personi i kallëzuar nuk gjendet nga prokurori, prandaj dhe kërkon të merren masa lidhur me veprimet dhe mosveprimet e tij.

Edhe më parë, shtetasi A. M. bashkë me familjarët e tij kanë denoncuar disa subjekte të tjera, për të cilët kanë paraqitur kallëzim penal dhe janë ankuar edhe pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në dhjetor të vitit 2017). Pas verifikimit të këtyre ankesave, KLD-ja ka dalë në konkluzionin se *...nga përmbajtja e kallëzimit nuk rezultonin të dhëna konkrete që materializonin pretendimet e tyre... etj.*

Ndërsa, lidhur me denoncimin konkret të shtetasit A. M ndaj subjektit të rivlerësimit vihet re se ky shtetas ankohet për subjektin e rivlerësimit, për faktin se ky i fundit nuk i ka thirrur brenda një afati kohor, që i përket periudhës 4.1.2018 – 20.4.2018, në lidhje me një kallëzim penal ndaj shtetases S. R., me të cilën vite më parë shtetasi A. M dhe familja e tij kanë pasur konflikte pronësie për një pronë të ndodhur në lagjen “\*\*\*\*” në qytetin e Fierit. Vepra penale për të cilën duket se kanë kallëzuar shtetasen S. R. është ajo “Kallëzim i rremë”.

Referuar pamjeve në internet nga emisioni investigativ “\*\*\*\*”, denoncuesi A. M tregon se ka vite që endet gjykatave për këtë konflikt pronësie. Por, për sa kohë kemi të bëjmë me një kallëzim penal (i cili nuk mund të jetë objekt hetimi nga ana jonë), që denoncuesi dhe familja e tij duket se kanë ushtruar ndaj një shtetaseje (S. R.), nuk mund të hetohet më tej për subjektin e rivlerësimit, për shkak se nuk referohen fakte e rrethana konkrete, të cilat të krijojnë bindjen se subjekti ka kryer shkelje ligjore në veprimtarinë e tij, në cilësinë e prokurorit të çështjes. Kjo sipas pikës 2 të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

### **23.8 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 14.7.2020, i shtetases R. K**

Kjo shtetase i është drejtuar Komisionit duke denoncuar prokurorin Dorjan Tafilaj. Ajo deklaron se vëllai i saj M. K. (i cili ka nënshkruar kërkesën drejtuar Komisionit) është pajisur me prokurë nga ana e saj dhe ka bërë kallëzim ndaj shtetasit A. H, me të cilin prej vitesh është në konflikt, pasi toka e përfutur me ligjin nr. 7501 dhe e kthyer nga AKKP-ja pretendohet se nuk është e familjes K, por e familjes H. Kjo çështje është hetuar për herë të parë me kërkesë të shtetasit A. H nga prokurori A. C. Në vendimin e këtij prokurori, AMTP-ja e familjes K u shpall e falsifikuar, ndërsa AMTP-ja prej 26,000 m<sup>2</sup> e familjes H u konsiderua e vlefshme (një dokument që i mungon firma, data, numri i aktit dhe elemente të tjera). Në vendimin me të cilin Prokuroria ka shpallur të falsifikuar AMTP-në e familjes K, është shprehur se prona i përket një tjetër familjeje, asaj të M. B, teksa ky shtetas nuk ekziston në regjistrin e gjendjes civile. Ankuesja thotë se është ndryshuar numri kadastral i pronës dhe në formularin nr. \*\*\* figurojnë emra të tjerë në vend të emrit të denoncueses, i cili sipas saj rezulton të jetë fshirë. Me arsyetimin se kjo çështje është hetuar një herë, prokurori D. Tafilaj ka kërkuar pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*/\*\*\*, duke injoruar provat e reja të vëna në dispozicion nga ankuesit, duke mos hetuar për 4 emrat që gjenden në formularin nr. \*\*\*, ku duket me sy të lirë ndërhyrja. Denoncuesja e mbyll denoncimin duke listuar dokumentet ku bazon ankesën e saj, ku gjendet edhe kërkesa e prokurorit D. Tafilaj për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, datë 4.12.2018, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, me arsyetimin se çështja penale duhet të pushohet, pasi është një çështje e hetuar nga organi i Prokurorisë dhe e gjykuar nga organi i drejtësisë, Gjykata. Kjo, sipas nenit 7 të Kodit të Procedurës Penale, ku ndalohet hetimi dhe gjykimi dy herë për të njëjtin fakt. Duket se subjekti i rivlerësimit ka vlerësuar drejt kërkesën për pushim procedimi penal, në përputhje me procedurën penale. Sa më sipër, nuk mund të hetohet më tej në lidhje me këtë denoncim.

### **23.9 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 13.1.2020, i shtetasit B. S.**

Ky shtetas ankohet se shtetasi R. Z., me profesion oficer i policisë gjyqësore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, në bashkëpunim me nënën e tij kanë sajuar një vendim KKP-je me nr. \*\*\* prot., datë 29.12.1994, lagjia “\*\*\*\*”, Fier. Me këtë vendim ata janë bërë pronarë të një sipërfaqeje prej 480 m<sup>2</sup> tokë truall. Brenda kësaj sipërfaqeje toke ndodhet shtëpia e ankuesit

B. S. me të gjitha dokumentet origjinale që ndodhen në të gjitha arkivat e shtetit shqiptar. Brenda kësaj sipërfaqeje ndodhen 120 m<sup>2</sup> të shpronësuara për efekt të ndërtimit të rrugës “\*\*\*\*”, Fier, ku kanë ndërtuar shtetasit, të cilët ankuesi i ka paditur në gjykatë, ku mbi 10 gjyqtarë të kësaj gjykate janë tërhequr, duke mos dhënë asnjë vendim për ta dhe, për këtë arsye, ankuesi thotë se i ka paditur penalisht në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier për falsifikim dokumentesh. Prokuroria pas një hetimi 3-4 vjeçar me mbi 1000 faqe hetim e ka bllokuar të gjithë praktikën se si janë bërë këta falsifikatorë të 480 m<sup>2</sup> tokë truall me vendimin nr. \*\*\* të KKP-së Fier, duke e cilësuar këtë vendim fals dhe M. Z falsifikatore me vendimet \*\*\* e \*\*\*, datë 9.1.2015. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me vendimin nr. \*\*\*, duke u shprehur se vendimi i KKP-së është fals dhe nuk ekziston në asnjë institucion i regjistruar. Prokurori Dorjan Tafilaj ka rrëzuar vendimet e Prokurorisë, si dhe vendimin e gjykatës. Ky prokuror, bashkë me OPGJ-në R.Z, kanë sajuar një tjetër dokument të KKPQ-së Fier, të cilit i kanë vendosur një numër, datë, firmë dhe vulë të vitit 1994, duke dhënë vendimin me nr. \*\*\*, Fier.

Ankuesi denoncon prokurorin D. Tafilaj, duke thënë se ai nuk është pyetur nga prokurori si palë paditëse e falsifikatorëve dhe se vendimi nr. \*\*\*, që ka dhënë prokurori, është i pabazuar në prova e fakte, por me këtë vendim tani i jep jo 480 m<sup>2</sup>, por 550 m<sup>2</sup> tokë truall. Ankuesi thotë se shtetasi R. Z është kushëriri i 4 gjyqtarëve me emrin Z dhe se ka fituar shumë prona në Fier e Lushnjë, por, për t’i shpëtuar drejtësisë dhe *Vetting*-ut, ai të gjitha dokumentet false që ka bërë vetë, ia ka hedhur nënës së tij 80-vjeçare.

Për ta sqaruar më tej këtë ankesë, Komisioni iu drejtua Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, ku i kërkoi dosje procedimi penal të ndjekur nga prokurori Dorjan Tafilaj për çështjen me palë shtetasit B.S, R dhe M. Z.

Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.9.2023, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier ka kthyer përgjigje, duke informuar se pranë kësaj prokurorie është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*, viti 2013, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Me vendimin e datës 26.12.2014 ka vendosur “Pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2013”. Ky vendim është ankimuar në gjykatë, e cila me vendimin nr. \*\*\*, datë 9.3.2017, ka vendosur pranimin e kërkesës për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*/\*\*\*.

Kundër vendimit nr. \*\*\*, datë 9.3.2017, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, është ushtruar ankim pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, e cila me vendimin nr. \*\*\*, datë 15.3.2018, ka vendosur prishjen e vendimit të datës 26.12.2014 të Prokurorisë së Rrethit Fier dhe urdhërimin e vazhdimin të hetimeve. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Fier ka vijuar hetimet dhe, në përfundim të veprimeve hetimore, në datën 20.5.2019, i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Fier me kërkesën për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*/\*\*\* për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”. Kjo kërkesë është pranuar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier me vendimin nr. \*\*\*, datë 11.9.2019, lënë në fuqi me vendimin nr. \*\*\*, datë 24.10.2019, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Nga dokumentacioni bashkëlidhur përgjigjes së Prokurorisë së Rrethit Fier evidentohet gjithashtu se nga viti 2013 deri në vitin 2017 prokurorë të kësaj çështjeje kanë qenë emra të tjerë pranë kësaj prokurorie. Ndërsa, në vitin 2017, Prokuroria e Rrethit Fier është përfaqësuar në gjykatë (shihni vendimin nr. \*\*\*, datë 9.3.2017) nga subjekti i rivlerësimit, i cili ka kërkuar pushimin e procedimit penal, duke arsyetuar në lidhje me nenin 66 të Kodit Penal (parashkrimin të ndjekjes penale e, për pasojë, pushimin e çështjes). Referuar pranimin të ankimit të shtetasit L. B., Gjykata e Apelit ka prishur vendimin e sipërcituar, duke urdhëruar vazhdimin e hetimeve në lidhje me këtë procedim. Prokuroria ka vijuar hetimet dhe i është drejtuar gjykatës me

kërkesën për pushim procedimi. Gjykata e Shkallës së Parë dhe ajo e Apelit e kanë pranuar këtë kërkesë.

Për sa më sipër, nuk u konstatuan shkelje procedurale në drejtim të kryerjes së veprimeve hetimore nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e prokurorit të çështjes për periudhën kur ai ka qenë prokuror i saj.

### **23.10 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 20.3.2018, i shtetases Dh.D**

Kjo shtetase, krahas denoncimit të saj për subjektin e rivlerësimit Dorjan Tafilaj dhe për një prokurore tjetër për të cilët ankohet, ka depozituar edhe një kopje të kallëzimit penal të datës 15.4.2010, paraqitur para Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë për shtetasit P.P, P.P etj.

Vendimi i mosfillimit të procedimit penal të datës 9.2.2012 për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Ndërtim pa leje”, parashikuar nga nenet 248 dhe 199/1 të Kodit Penal, me prokurore znj. S. L., ka të bëjë me kallëzimin e bërë nga denoncuesja në lidhje me faktin e ndodhur, ku vajza e Dh. D ka shkuar tek prona e vet dhe ka gjetur punëtorë, duke realizuar shpyllëzimin e të gjithë sipërfaqes së truallit (nr. \*\*\* pasurie, z. k. \*\*\*), në fshatin N, Vlorë. Ata kishin ndërtuar rrugë dhe mure rrethuese dhe prona ishte ndërprerë mospërmes. Kallëzuesja ka marrë informacion se punimet po kryheshin për llogari të shtetasit C. S. Pasi ka kontaktuar me të, ai ka sqaruar se punimet po kryheshin me leje të kryetarit të komunës, F.B. dhe se ka kontaktuar me pronarin e truallit A. Sh. Kallëzuesja ka kërkuar ndërprerjen e punimeve dhe ka shkuar në policinë ndërtimore të komunës, duke kërkuar ndërprerjen e punimeve në këtë zonë.

Në lidhje me këtë çështje është pyetur kallëzuesja në cilësinë e deklaruases dhe janë administruar procesverbal këqyrjeje dhe marrje dokumentesh që ajo ka paraqitur. Gjithashtu, nga ana e policisë gjyqësore është kryer këqyrja e vendit të ngjarjes dhe është shoqëruar me fotografi. Është pyetur kryeinspektori në inspektoratin e komunës. Prokuroria ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, me argumentimin se është konflikt i pastër pronësie dhe se mund t'i drejtohen gjykatës civile me kërkesën e pushimit të cenimit në pronësi etj. Kallëzuesja ka kërkuar shfuqizimin e vendimit të mësipërm dhe Prokuroria e Përgjithshme ka vendosur shfuqizimin e vendimit për mosfillimin e procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2011.

Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, me vendimin e datës 15.3.2013 ka vendosur pushimin e çështjes, pasi ka argumentuar se fakti i konstatuar nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Prokurori duket se ka dalë në këtë përfundim duke u mbështetur në aktin e ekspertimit datë 8.3.2013, në të cilin, ndër të tjera, thuhej se *punimet nuk plotësonin kushtet e një ndërtimi të mirëfilltë, mbasi nuk kanë lartësinë e nevojshme që kërkohet për një ndërtim... etj., duke mos plotësuar kushtet e urbanistikës*. Nga dokumentacioni bashkëlidhur denoncimit gjendet gjithashtu edhe kopje e kërkesës për gjykimin e çështjes së vitit 2015 kundër shtetasve P. P., K. J., M. I. dhe P. P., akuzuar për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, referuar procedimeve penale të mëparshme (të bashkuara), që kanë lidhje me denoncimin e ankueses Dh. Dajlani kundër shtetasve të sipërcituar, të cilët me veprimet e tyre kanë bërë që në pronën e saj dhe vajzave të saj të kryhen punime nga shtetas, të cilët nuk janë pronarë të asaj sipërfaqeje trualli. Në këtë kërkesë, prokuroria (prokurore E. H.) ka kërkuar gjykimin e çështjes me të pandehur shtetasit e sipërcituar në funksione shtetërore (drejtor, përgjegjës e specialist pranë ZVKKP-së Vlorë, si dhe përfaqësues ligjor), për veprat penale “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuara nga nenet 186/1 dhe 248 të Kodit Penal, në lidhje me falsifikimin dhe përdorimin e dokumentit “Planvendosje e pronës z. k. \*\*\*”, dokument i cili bashkëshoqëron vendimin nr. \*\*\*/\*\*\* të ZVKKP-së Vlorë, konfigurimi i së cilës nuk është i njëjtë me planvendosjen origjinale të hartuar nga ZVKKP-ja Vlorë.

## **Konstatimi i Komisionit**

Duket se edhe më parë Prokuroria e Përgjithshme ka shfuqizuar një vendim (mosfillim procedimi) të një prokurori tjetër, i cili ka kërkuar pushimin e procedimit penal për veprat penale “Ndërtimi i paligjshëm” dhe “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuara nga nenet 199/a dhe 248 të Kodit Penal, duke argumentuar se në lidhje me faktin e konstatuar nuk kemi të bëjmë me elemente të veprës penale “Ndërtim pa leje”, si dhe konflikti në fjalë është konflikt i pastër pronësie.

Ndërsa subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të caktuar të çështjes, për hetimin e kallëzimit penal në kuadër të procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2012, duket se nuk ka kryer veprimet hetimore të mjaftueshme në lidhje me plotësimin e kuadrit të plotë hetimor për veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal. Ai duket se i është referuar një akti ekspertimi të datës 8.3.2013, duke mos kryer veprime të tjera të nevojshme hetimore.

Me vendimin e vitit 2015 të një prokurori tjetër duket se çështja përfundimisht është kërkuar të gjykohet për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Falsifikimi i dokumenteve” në favor të interesave të kallëzueses.

Sa më sipër, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit në lidhje me moskryerjen e një hetimi të plotë e të gjithanshëm për çështjen në fjalë.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar se: *“Për procedimin penal nr. \*\*\*, të vitit 2012, fillimisht është vendosur mosfillimi i çështjes nga ana e prokurores S. L. për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a/2 i Kodit Penal.*

*Pas ankimit të shtetases kallëzuese Dh.D, nga ana e Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm është vendosur “Shfuqizimi i vendimit të mosfillimit”, duke u lënë si detyrë të hetohet për veprën penale të ndërtimit të paligjshëm. Nga përmbajtja e vendimit të shfuqizimit kuptohet se nuk është cenuar vendimmarrja e mosfillimit të çështjes për veprën penale të “Shpërdorimi i detyrës”. Nga hetimet e kryera për veprën penale të ndërtimit të paligjshëm, vlerësoj se nuk përmbushet asnjë kriter objektiv i kësaj vepre penale. Duke iu referuar Rregullores së Urbanistikës, të miratuar me vendimin nr. \*\*\*, datë 19.11.1998, në mbështetje të nenit 5 të ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, i ndryshuar, në pikat 115 e 116 të kësaj rregulloreje përcaktohet se: “Objekt ose ndërtim do të quhet çdo masë që formon vëllim ose sipërfaqe ndërtimore, e cila krijon hije dhe ngrihet në lartësi dhe gjithashtu me objekte do të përfshihen ndërtesa, mure rrethuese, ndërtime të përkohshme etj., që qëndrojnë në lartësi mbi 1.8 m”. Norma juridike e mësipërme ishte në fuqi në kohën e hetimit të çështjes penale. Nga përmbajtja e kësaj dispozite kuptohet qartësisht se objekti i pretenduar nga kallëzuesja si ndërtim pa leje nuk përmbush kriteret për t’u quajtur ndërtim në referencë të ligjit të urbanistikës. Objekti i kallëzuar ka të bëjë me hapjen ose rregullimin e një sheshi. Një objekt i tillë nuk formon vëllim, nuk krijon hije dhe nuk ngrihet në lartësi dhe gjithashtu nuk është ndërtesë, mur rrethues, ndërtim i përkohshëm në lartësi mbi 1.8 m. Të njëjtin konkluzion ka arritur edhe akti i ekspertimit teknik i kryer nga ana e organit procedues, sipas të cilit objekti nuk mund të quhet ndërtim sipas kritereve urbanistike.*

*Duke analizuar aktet e mësipërme, si dhe procesverbalin e këqyrjes së vendit të ngjarjes, të shoqëruar me tabelën fotografike, kam arritur në përfundimin se nuk mund të procedohet ndonjë person penalisht për veprën penale të ndërtimit të paligjshëm, në kushtet kur nuk kishte një ndërtim në kuptim të ligjit të urbanistikës dhe rregulloreve përkatëse. Për sa parashtrova, vlerësoj se vendimi i pushimit për këtë procedim penal është i bazuar në prova dhe në ligj”.*

## **Vlerësimi i Komisionit**

Në lidhje me denoncimin e shtetasës Dh. D., subjekti shpjegoi hapat proceduralë, që e kanë çuar atë në marrjen e vendimit për pushimin e procedimit penal në lidhje me veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm”. Komisioni i konsideroi këto shpjegime bindëse dhe të mjaftueshme.

## **Vlerësimi i Komisionit për aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit**

**24.** Në përfundim, në analizë të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, të denoncimeve të depozituara nga publiku dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe dokumentacionit të administruar, Komisioni vlerësoi se nëpërmjet shpjegimeve të paraqitura në përgjigje të rezultateve të hetimit dhe atyre të dhëna në seancë dëgjimore subjekti ka argumentuar dhe arsyetuar në mënyrë bindëse dhe në nivel ligjor mbi to. Nga shqyrtimi në tërësi i tyre nuk u evidentuan shkelje procedurale apo gabime serioze, që do të mund të ndikonin në kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit.

**25.** Në përfundim, Komisioni vlerësoi se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit Dorjan Tafilaj ka treguar cilësi të mira në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve dhe konsiderohet “i aftë”, duke arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në kuptim të shkronjës “c”, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

## **VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES**

**26.** Në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat, faktet dhe rrethanat që Komisioni disponon për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vlerësimit të figurës dhe vlerësimit profesional, si dhe në vlerësim tërësor të procedurave, arrin në përfundimin se:

### **a) Për vlerësimin e pasurisë**

Në vlerësimin e çështjes në tërësi, Komisioni, bazuar në provat e disponuara, si dhe në bindjen e brendshme, çmoi se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë dhe ka pamjaftueshmëri të burimeve financiare lidhur me pasuritë e krijuara prej tij dhe bashkëshortes, duke rezultuar me një mungesë burimesh të ligjshme prej -4,547,888 lekësh, duke u gjendur në kushtet e parashikuara të shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

Në rastin e subjektit të rivlerësimit Dorjan Tafilaj, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vërtetohen shkaqet që neni D i Aneksit të Kushtetutës i ka parashikuar të tilla që të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit, për shkak se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur pasuritë në mënyrë të pasaktë.

Mbështetur në konkluzionet e mësipërme, Komisioni çmoi se subjekti i rivlerësimit Dorjan Tafilaj nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

### **b) Për vlerësimin e figurës**

Trupi gjykues vlerësoi se, subjekti i rivlerësimit z. Dorjan Tafilaj ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të gërmës b, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

### **c) Për vlerësimin e aftësive profesionale**

Trupi gjykues vlerësoi se, në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit arriti nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas parashikimit të shkronjës “c”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

## **KONKLuzion Përfundimtar**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstatoi nga vlerësimi i kriterit të pasurisë, sipas paragrafit 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, dhe arriti në konkluzionin se, subjekti i rivlerësimit Dorjan Tafilaj ka arritur nivel të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, duke u gjendur në kushtet e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, referuar shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 58 dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Dorjan Tafilaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Fier.
2. Vendimi, i arsytuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 28.12.2023.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Genta TAFA (BUNGO)**  
Kryesuese

**Roland ILIA**  
Relator

**Suela ZHEGU**  
Anëtare

*Sekretare gjyqësore*  
*Amela Idrizi*